



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Psikologji me profile: “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”
“Universiteti i New York-ut” Tiranë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi

Prof. Asoc. Dr. Artemisi Shehu/ Dono

Nëntor / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Msc në Psikologji me profile: "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore dhe "Psikologji Ligjore"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Psikologji", me profile "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr.274, Datë 28.08.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semsetra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	4 PAE/ 1 PAK v.a. 2020-2021 5 PAE/ 1 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	3 Studentë v.a 2020-2021 6 Studentë v.a 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i "New York-ut" në Tiranë (UNYT), institucion jopublik i arsimit të lartë ka filluar veprimtarinë e tij mbështetur në Vendimin Nr. 397, Datë 15.08.2002 të Këshillit të Ministrave¹. Ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "New York University-Tirana" është riorganizuar dhe ka ndryshuar statusin dhe emërtimin sipas VKM Nr.448, datë 11.07.2012² për ndryshimin e emrit të UNYT. Universiteti i "New York-ut" në Tiranë është akredituar për herë të parë nga Bordi i Akreditimit me vendim Nr. 102, datë 10.11.2017 "Për Akreditimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i New York-ut në Tiranë"³. Riakreditimi i dytë bazohet në Vendimin e BA-së, Nr. 61, datë 18.12.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i New York-ut në Tiranë"⁴, me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite. Universiteti i "New York-ut" në Tiranë përbëhet nga 3 Fakultete: "Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore"; "Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës"; "Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit" si dhe "Institutin e Studimeve Europiane dhe Ballkanike"⁵. Njësia bazë që e ofron Masterin Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" është Departamenti i Psikologjisë që është pjesë e Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Programi është hapur me Urdhër Nr. 274, datë 28.08.2020⁶ të Bordit të Akreditimit. Programi i studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" realizohet me 120 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në gjuhën angleze, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Master i Shkencave në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore". Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është punimi i temës së diplomës. Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" për vitin akademik 2021 – 2022, është gjithsej 6 studentë.

¹ Vendim për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike "New York University-Tirana"

² Vendim për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të emërtimit të institucionit privat të arsimit të lartë "New York University-Tirana"

³ Vendimi për akreditimin periodik të Institucionit të arsimit të lartë Universiteti i New York-ut Tiranë.

⁴ Vendimi për akreditimin periodik të Institucionit të arsimit të lartë Universiteti New York Tiranë.

⁵ Evidenca 7. UNYT-Organigrama-2020.

⁶ Urdhër Nr.274, datë 2020- 08-28. Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Psikologji me profile Psikologji Klinike, Psikologji Shkollore dhe Psikologji Ligjore, Universiteti i New York-ut në Tiranë.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA GRUPI VLERSUES PRANË MASR NË KUADËR TË LICENSIMIT

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe mbështetur në Urdhrin Nr. 274. datë 28.08.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë⁷ për “Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i New York-ut, Tiranë, Grupi Vlersues pranë MASR jep vlerësim pozitiv me rekomandimet si më poshtë:

1. Universiteti i New York-ut në Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm lidhur me shtimin e numrit të personelit akademik me formim të mirëfilltë psikologjik në profilin shkollor dhe ligjor për t’u angazhuar në këtë program studimi.

Duke iu referuar këtij rekomandimi të dhënë nga Grupi Vlersues pranë MASR bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si Tabelës Përmbledhëse⁸, në të cilin gjenden të dhënat e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022, si dhe bazuar në CV-të⁹ e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi kemi evidenca në lidhje me ndryshimet e realizuara për të përmbushur rekomandimet e BA për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”. Bazuar në dokumentacionin që lidhet me CV-të e stafit akademik rezultojnë se nga 5 anëtare të stafit akademik më kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi me profile në psikologjik klinike, shkollore dhe ligjore, katër (4) janë me profil klinik (E. C.; B. L.; S. Dh., A. H.)¹⁰ ndërsa A. C., me profil edukim – organizacional. Referuar kualifikimit akademik dhe përvojave profesionale rezultojnë sërisht problematike çështja e mbulimit të profilit shkollor dhe ligjor me staf akademik, cili të ketë kualifikime dhe/ose përvojë profesionale në këto dy kontekste. Kjo me qëllim që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në MSc në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” të jetë në gjendje të njohë mirë terrenet profesionale të psikologut ligjor dhe shkollor dhe t’u përgjigjet drejt kërkesave të studentëve për njohuri të thelluara dhe zhvillim të kompetencave profesionale në këto dy kontekste pune të zgjedhura prej tyre. Duke iu referuar Europsy¹¹ por edhe APA-s¹² këto terrene ndryshojnë shumë nga njëri -tjetri si nga forma dhe përmbajtja, njohuritë, fusha e ekspertizës, dhe si e tillë konsiderohet një sfidë e madhe përmbledhja në një master të njohurive të thelluara në 3 profile të ndryshme profesionale përmes një masteri 2 vjeçarë, me 120

⁷ Urdhër Nr.274. datë 2020- 08-28. Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Psikologji me profile Psikologji Klinike, Psikologji Shkollore dhe Psikologji Ligjore, Universiteti i Neë York-ut në Tiranë

⁸ Evidenca 53. Tabela Përmbledhëse për ankesin e RVB.

⁹ Evidenca 54. UNYT CV of instructors of Psychology Deparmnet.

¹⁰ Evidence 79. UNYT List of Academic Registered as Practitioners of Clinical Psychology.

¹¹ European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec)

<https://www.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3> Which professions (Aksesuar më 30.09.2022)

¹² American Psychological Association (2022) Divisions of APA.

https://www.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706 (Aksesuar më 30.09.2022)

ECTS. Mbetet për t'u parë sesi institucioni do të menaxhojë kërkesat e tregut të punës për profesionist të kualifikuar të cilët do të jenë në gjendje të përmbushin kërkesat për licensim tek urdhri i psikologut dhe të pozicionit të punës që aspironjë. Duke u mbështetur në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009¹³, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluara. Profesioni i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Bazuar në sa më sipër, e njëjta praktikë duhet të ndiqet edhe në përzgjedhjen e stafit akademik që angazhohet për të zhvilluar njohuritë dhe kompetencat profesionale të studentëve që duan të profilizohen në fushën e psikologjisë klinike, shkollore apo ligjore sipas preferencave të tyre.

Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlerësimit të jashtëm gjykon se ky kusht përmbushet pjesërisht.

2. Universiteti i New York-ut në Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm lidhur me respektimin e ngarkesës dhe numrit të lëndëve për personel akademik, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit që GVJ kishte në dispozicion si lista tabelore e ngarkesës së stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në MSc në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022¹⁴ kemi një balancë në shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik konform statutit dhe rregullores së UNYT dhe ligjeve në fuqi¹⁵. Duke iu referuar këtij rekomandimi gjykojmë se ka pasur një përpjekje nga ana e institucionit për ta adresuar drejt zgjidhjes këtë çështje.

Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlerësimit të jashtëm gjykon se ky kusht përmbushet plotësisht.

3. Universiteti i New York-ut në Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm lidhur me titullarët e lëndëve, që duhet të jenë të kategorisë "Profesor".

Bazuar në evidencat që lidhen me syllabuset e lëndëve¹⁶ rezulton se titullari i lëndës dhe lektori i parë në pjesën më të madhe janë me gradën shkencore "Doktor i Shkencave". Në këtë master janë të angazhuar në mësimdhënie 6 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 5PAE/1 PAK, ndërsa përsa i përket gradave dhe titujve, kemi 1 anëtar me titull Prof. Asoc.Dr, 5 me gradën Dr. Duke iu

¹³ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

¹⁴ Evidenca 53. Tabela Përmbledhëse për ankesin e RVB.

¹⁵ Udhëzimi Nr 29, datë 10.09. 2018. Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/09/Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf> (Aksesuar më 30.09.2022).

¹⁶ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

referuar syllabuseve të lëndës rezulton se për të gjitha lëndët mësimore titullarët janë me gradën shkencore “Doktor”, edhe pse kemi një anëtar të stafit që i përket kategorisë Profesior (E. C.), nuk figuron si titullare te asnjëra prej lëndëve mësimore në Msc në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”.

Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlerësimit të jashtëm gjykon se ky kusht nuk përmbushet.

4. Universiteti i New York-ut në Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm lidhur me përfshirjen në planin mësimorë në mënyrë të detajuar të shpërndarjes së komponentëve mësimorë si leksione, seminar dhe veprimtari të tjera në bazë të krediteve përkatëse, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.

Mbështetur në të dhënat e shqyrtuara¹⁷ rezulton se janë ndërmarrë hapa në drejtim të përafrimit të programit të studimit duke qenë konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”¹⁸ dhe akteve nënligjore si VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”¹⁹; Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave²⁰, dhe Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021 i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018²¹ përsa i përket përfshirjes në planin mësimorë të komponentëve mësimorë sipas tipit të veprimtarisë në A- lëndë bazë 8 ECTS (6.67%), B- lëndë karakterizuese 66 ECTS (55%), C-lëndë ndërdisiplinare/integruese 16 ECTS (13%), D-lëndë plotësuese 12 ECTS (10%) dhe E-detyrime përmbylëse 18 ECTS (15%). Një ndarje të ngarkesës në leksione, seminar, dhe veprimtari të tjera formuese në bazë të krediteve përkatëse²², sipas ngarkesës javore të realizuar në auditore. Gjithsesi, mbetet e paqartë sesi janë të shpërndara në planin mësimor²³ orët e studimit individual të studentit jashtë auditorit, orët totale të praktikës profesionale dhe orët e studimit

¹⁷ Evidenca 9. UNYT Master in Psy- 3 Profiles final version.

¹⁸ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 30.09.2022).

¹⁹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlori.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 30.09.2022).

²⁰ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYjE8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZjEhMEE1Yjdi> (Aksesuar më 30.09.2022).

²¹ Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021. i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar. <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 30.09.2022).

²² Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²³ Evidenca 2. Vizita dy ditore në institucion. Plani mësimorë i programit Msc në Psikologji me profile Psikologji klinike, Psikologji Shkollore dhe Psikologji Ligjore, UNYT.

individual në auditor dhe jashtë auditorit në përgatitjen e temës së diplomës, emërtimi i lëndëve me zgjedhje sipas secilit profil.

Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se ky kusht përmbushet kryesisht.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, aplikuar nga Universiteti Jo Publik i “New York-ut” në Tiranë. Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi, Prof. Asoc. Dr. Artemisi Shehu/Dono, Msc. Muhamed Prezja (koordinatori teknik i ASCAL) nisi punën për realizimin e procesit të vlersimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin e “New York-ut” në Tiranë, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” mbi përmbushjen e standardeve. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin te përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale të studentëve.

Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit Master Shkencor; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit Master Shkencor; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit Master Shkencor. Vlerësimi i secilës fushë bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit

të studimit Master Shkencor në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”.

Universiteti i New York- ut është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.10.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/18 Prot, datë 31.10.2022. Universiteti i New York- ut, përcjell në ASCAL më datë 08.11.2022, me anë të shkresës me Nr. 431/2022 Prot, datë 03.11.2022, “Përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm”.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportin të paraqitura sipas fushave, shprehet si vijon:

- a) Komenti “*Profilet e Masterit Shkencor në Psikologji janë hapur në përputhje me standartet ndërkombëtare*”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Bazuar në dokumentacionin e dërguar pranë ASCAL është realizuar edhe vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve për këtë program studimi. Supozohet se institucioni njih mirë fushën e programit të studimit dhe gjithashtu programin e ofruar e mbulon me burimet e duhur për të justifikuar cilësinë e shërbimit. Pra, kjo nënkupton që stafi akademik i parashikuar për mbulimin e programit në tre profile të propozuara është në dispozicion dhe gjithashtu justifikon rolin me nivel kualifikimi akademik dhe kompetenca profesionale për secilin prej profileve. Kjo është pjesë e një procedure të nevojshme që në momentin e fillimit të procesit të licensimit pranë MASR dhe parashikohet të jetë përmbyllur pasi programi ka filluar veprimtarinë e tij në dy vite akademike aktivizimi të tij. ***Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.***

- b) Komenti “*Hartimi i Syllabus-eve është realizuar në përputhje me njohuritë e thelluara, kompetencat dhe aftësitë e duhura të profilit klinik aktiv dhe synon të njëjtën gjë me dy profilet “Ligjor” dhe “Shkollor”.*

Duke iu referuar këtij elementi kyç përse i përket cilësisë së një programi studimi, GVJ është ndalur mbi këtë aspekt dhe ka evidentuar çështje, ka bërë komente dhe dhënë rekomandime duke marrë si evidencë dokumentacionin e dërguar pranë ASCAL nga vet institucioni. Komentet tona janë mbështetur në evidenca, të cilat përgjatë gjithë raportit janë cituar për të ndjekur një gjuhë korrekte komunikimi midis palëve në këtë proces. GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës që lidhet me syllabuset, temat mësimore të trajtuara, literaturën e përdorur. Mbi bazën e këtyre elementëve janë bërë komente dhe sugjerime, të cilat janë përfshirë në raport në mënyrë të zgjeruar me qëllim transparencën në komunikimin e çështjeve që adresojmë. ***Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.***

- c) Komenti “*Stafi Akademik i angazhuar në programin e Masterit Shkencor në Psikologji zotëron kualifikimin e duhur për mësimdhënie cilësore dhe sipas standardeve ligjore në Arsimin e Lartë*”.

Bazuar këtij kriteri lidhur me stafin akademik, GVJ dëshiron të qartësojë se referuar kualifikimit të stafit për t'u angazhuar në mësimdhënie për profilin aktiv "Psikologji Klinike" stafi është me grandën shkencore Dr., kjo konform ligjeve përsa i përket mbulimit të procesit mësimor konform rregullave. Çështja që adresohet nga ana jonë si GVJ, lidhur me stafin akademik fokusohet te kualifikimi i pamjaftueshëm e anëtarëve të njësia bazë për të mbuluar profilet e tjera, të cilat janë pjesë e këtij masteri dhe për të cilat njësia duhet të marrë masa paraprakisht që të garantojë mbarvajtjen normale të tyre. Bashkë me komentet mbi draft- raportin, institucioni ka derguar edhe disa dokumentacione shoqëruese si Syllabuset e lëndëve për profilin "Psikologji Ligjore"²⁴ dhe "Psikologji Shkollore"²⁵, këto syllabuse janë hartuar nga të njëjtët anëtarë të stafit akademik që japin në profilin klinik²⁶, kjo sipas gjykimit tonë vështirëson marrjen e njohurive të thelluara për këto dy profile profesionale kur hartuesit e syllabuseve dhe implementuesit e tyre në auditor janë të një profili tjetër profesional. Gjithashtu, duke u bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",²⁷ dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"^{28, 29} në to përcaktohet qartë se titullarët/hartuesit e lëndëve mësimore duhet të jenë të kategorisë "Profesor". *Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.*

- Lidhur me komentin "Pika 3, referuar syllabuseve të lëndës rezulton se për të gjitha lëndët mësimore titullarët janë me grandën shkencore "Doktor", edhe pse kemi një anëtar të stafit që i përket kategorisë Profesor (E. C.), nuk figuron si titullare te asnjëra prej lëndëve mësimore në Msc në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore". – Dëshirojmë të theksojmë se lëndët e Internship dhe tezës së Diplomës që kanë shumë rëndësi i janë dhënë këtij titullari nga rëndësia e supervizimit bazuar në përvojën më të hershme në mësimdhënie në UNYT si dhe përzgjedhjes së studentëve për punimin e tezave.

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit lidhur me syllabuset e lëndëve shqip³⁰ dhe anglisht³¹ nuk evidentohet emri i lektorit E.C. në ndonjërin prej tyre. Ndërsa përsa i përket Intershipit, pjesë e Lëndëve Plotësuese³², gjykojmë se janë veprimtari, të cilat mund të mbulohen mjaft mirë nga cilido

²⁴ Hartimi i Draft-Raportit, dergimi në Institucion dhe komentet nga IAL. Dokumenti 2. Legal Psychology ALB.

²⁵ Hartimi i Draft-Raportit, dergimi në Institucion dhe komentet nga IAL. Dokumenti 4. School Psychology ALB.

²⁶ Evidence 79. UNYT List of Academic Registered as Practitioners of Clinical Psychology.

²⁷ Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri" https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-09-2022).

²⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 17-02-2022).

²⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&rcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZËNhMËEiYjdj> (Aksesuar më 17-02-2022).

³⁰ Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

³¹ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

³² Evidenca 70. UNYT Intership Guidelines. Msc.

anëtarë i stafit që mban edhe gradën shkencore Dr., mjafton të sigurohen institucione të mjaftueshme në fushën e profilit përkatës për realizimin e praktikës profesionale, konform dhe objektivave të përcaktuar në udhëzuesin e praktikës profesionale. Mentorimi në përgatitjen e tëmës së diplomës, pjesë e detyrimeve përmbyllëse është një punë krijuese e studentit nën monitorimin e një udhëheqësi shkencor, që studenti e zgjedh në mënyrë të lirë në varësi të fushës së tij të interesit dhe të problemit shkencor që zgjedh të hulumtojë. Gjykojmë se mund të duket arbitrare përcaktimi i supervisorit nga institucioni, duke kufizuar në këtë mënyrë të drejtën e studentit për zgjedhje të lirë në këtë drejtim me vetëm një opsion në dispozicion të tyre. Vlerësojmë gjykimin e institucionit për t'i dhënë rëndësi lëndës “Intership” por do të sugjerim shtim të përpjekjeve në këtë drejtim duke shtuar numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Kjo me qëllim që të ofrohen terrene pune ku psikologu klinik (profili aktiv) por edhe profilet e tjera shkollore, ligjore, të supervizohen nga figura profesionale në linjë me profilin në institucionet ku realizohet praktika, për të garantuar një klimë të qetë për realizimin e objektivave formative në këtë drejtim. *Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.*

- Lidhur me komentin “Sipas ligjit 80/2015 te Arsimit të Lartë, neni 59, pika 6 citon se: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”. UNYT, operon sipas kritereve ligjore ne fuqi, megjithatë, përpjekja e stafit për tituj akademikë apo edhe punësimin e profesorëve me tituj mbetet e vazhdueshme”*

Duke iu referuar komentit tuaj mbi ligjin duhet të kuptojmë diferencën midis atij që harton syllabusin dhe atij që e realizon atë. Duke iu referuar Ligjit 80/2015 te Arsimit të Lartë, neni 59, pika 3³³ shprehet - “Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar”.

Ndërsa duke iu referuar pikës 4 shprehet se - “Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar”.

Komentet e GVJ nuk kanë ndonjë kontestim me realizimin e ngarkesës në auditor nga stafi akademik por kometnet lidhen posacërisht me problematikën në hartimin e syllabuseve nga personel që nuk është i kategorisë “Profesor”, jo me një kualifikim në profilet ku ato angazhohen

³³Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt(Aksesuar më 04-09-2022).

bazuar në udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 për “Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”³⁴ dhe në përputhje me Ligjin 80/15, neni 59, pika 3, titullarët e lëndëve të jenë të kategorisë “Profesor”. C’ka do të thotë se ndoshta një pjesë e problematikave të evidentuar në syllabuset e lëndëve mund të ishin menaxhuar më mirë nëse titullarët do t’i përkisnin kategorisë profesor dhe do kishin përvojë dhe kualifikim në profilet përkatëse. Gjithashtu duam të sjellim në vëmendje që kërkesa për të angazhaur në hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore titullarë që i përkasin kategorisë “Profesor” ka qenë pjesë e rekomandimeve të Ekspertëve Vlersues, të MASR kur është dhënë miratimi për licensimin e këtij programi studimi me disa rekomandime për institucionin tuaj. *Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.*

- Lidhur me komentin “Pika 4, Përsa i përket shpërndarjes së orëve të studimit individual të studentit jashtë auditorit, orët totale të praktikës profesionale dhe orë të studimit individual në auditor dhe jashtë auditorit në përgatitjen e temës së diplomës, emërtimi i lëndëve me zgjedhje sipas secilit profil në planin mësimorë” - Dëshirojmë të theksojmë se shpërndarja e orëve mësimore në klasë, jashtë klase, orëve të studimit individual etj janë të paraqitura në mënyrë të detajuar ne syllabet e secilës lëndë mësimore

Bazuar në këtë aspekt duam të evidentojmë se lidhur me mungesën e informacioneve të nevojshme të shpërndarjes së orëve të studimit individual të studentit jashtë auditorit, orët totale të praktikës profesionale dhe orë të studimit individual në auditor dhe jashtë auditorit në përgatitjen e temës së diplomës, emërtimi i lëndëve me zgjedhje sipas secilit profil, këto të dhëna nuk janë pasqyruar në planin mësimorë³⁵. Gjithashtu vëmë në dijeni se edhe pas kërkesës tonë gjatë vizitës në institucion lidhur me këto mangësi, sërish dokumentacioni ka ardhur me mangësi për këto aspekte³⁶. *Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.*

- Lidhur me komentin “Pika 1.1, Pika 4 - Një master shkencor, me kohëzgjatje dy vjeçare e kemi të vështirë ta gjejmë në një insitucion tjetër të arsimit të lartë publik në vend apo në arenën ndërkombëtare (Europsy38; APA39), kjo për arsye se është e pamundur që të zhvillohen njohuri teoriko-praktike dhe kompetenca të avancuar në 3 profile të ndryshme profesionale njëherësh”.

Hartimi i Masterit Shkencor me profile bazohet në një traditë të suksesshme të UNYT të Masterit sipas profileve (evidence MBA). Gjithashtu, bazohet ne një praktikë të njohur disavjecare ne botë te cilat ofrojnë Mastera Shkencorë në Psikologji me fokus në disiplina të ndryshme të Psikologjisë. Sjellim si shembull Universitetin e Padova-s si dhe Universitetin e Oakland ne SHBA.

³⁴ Udhëzimi Nr 29, datë 10.09. 2018. Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/09/Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf> (Aksesuar më 30.09.2022).

³⁵ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

³⁶ Evidenca 2. Vizita dy ditore në institucion. Plani mësimorë i programit Msc në Psikologji me profile Psikologji klinike, Psikologji Shkollore dhe Psikologji Ligjore, UNYT.

Në lidhje me mundësinë e zhvillimit të njohurive teoriko-praktike e kompetencave të pavarura në tre profile të ndryshme, ne mendojmë se Masteri Shkencor në Psikologji integron më së miri lëndë të përbashkëta shumë të nevojshme për ndërtimin e profilit. Kështu, lëndët e vitit të parë që përfshijnë: Zhvillimi njerëzor, Statistikat e Avancuara, Bazat Biologjike të Sjelljes dhe Testimi e matja psikologjike janë lëndë që zhvillojnë boshtin e njohurive të nevojshme të një psikologu pavërisht profilit. Po kështu, lëndët si Psikopatologji të Avancuara, Metodrat e Kërkimit Shkencor kanë vlerë të jashtëzakonshme si për psikologun klinik, ashtu edhe për psikologun që do të përballë në sistemin e edukimit apo në atë ligjor me problematika të tilla. Për më tepër, lëndët me fokus kërkimin shkencor janë pararendëse të mundësive në vijim të studentëve për të punuar si kërkues apo vijuar me studimet doktorale.

Vlerësojmë punën e institucionit për të marrë si model, programe të aplikuara në arenën ndërkombëtare si Italia dhe Amerika por do të sugjerim që ky model të mos merrej në konsideratë vetëm për emërtimin e këtij programi studimi të ciklit të dytë por edhe duke implementuar brendinë e tij. Nëse i referohemi shëmbujve të sjell, Universitetit të Padovës³⁷, programi mësimor dhe lëndët janë shumë ndryshe në strukturë dhe përmbajtje por edhe ndryshimet midis dy institucioneve përsa i përket burimeve njerëzore në dispozicion për të realizuar këtë program. Kujtojmë se në modelin e Padovës, 3 profilet janë në linjë me emërtimin dhe përmbajtjen e këtij programi dhe lëndët janë në funksion të një zgjerimi njohurish me pikprerje me profile të përafërta me fushën e aplikimit primarë atë klinik. Pra në funksion të nevojave për plotësim njohurish në profilin klinik dhe duke synuar plotësimin me kompetenca në profilin e psikologjisë ndërkulturore dhe sociale synohen një kualifikim më i mirë i studentëve që të zhvillojnë njohuritë e tyre dhe në aspektet që lidhen me diferencat social-kulturore në problematikat klinike. Por programi i ofruar nga UNYT ka një program mësimor i cili nuk justifikon profilet, për nga njohuritë e kompetencat e synuara. Duke iu referuar programit tjetër atij të ofruar nga Universiteti i Oakland, SHBA, mënyra e organizimit të kurrikulës mësimore³⁸ dhe dhënie e opsioneve studentit për të pasur liri zgjedhje në lëndë dhe module të vecanta i lejojnë profilizim të ndryshëm profesional përgjatë një programi formativ të ciklit të dytë 2-vjecar, por sugjerojmë institucionin që të mbajë në konsideratë edhe përshtatjen e kurrikulës së këtij programi në të njëjtën linjë me profilet dhe ku lëndët e profilit nuk ezaurohen me 1 apo 2 lëndë me zgjedhje që mund të zhvillojnë studentët përgjatë një vitit akademik. Rekomandimet tona i kemi mbështetur në institucioneve prestigjioze ndërkombëtare si Europsy³⁹; APA⁴⁰ për përmirësimin e ofertës formative me qëllim që

³⁷Second Cycle Degree in Clinical, Social, and Intercultural Psychology. <https://www.unipd.it/en/educational-offer/second-cycle-degree/psychology?tipo=LM&scuola=PS&ordinamento=2021&key=PS2588&cg=psychology> (Aksesuar më 07.11.2022).

³⁸ Mater of Science in Psychology. Degree programs and Graduate Certificates. https://catalog.oakland.edu/preview_program.php?catoid=56&poid=10346&returnto=11901 (Aksesuar më 07.11.2022).

³⁹ European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec) https://www.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3_Ehich_professions (Aksesuar më 01.09.2022)

⁴⁰ American Psychological Association (2022) Divisions of APA. https://www.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706 (Aksesuar më 01.09.2022)



të jetë konkurrese në treg. Por gjithashtu të dyja këto institucione kanë një kontribut të vazhdueshëm në unifikimin e programeve të studimit në fushën e psikologjisë në nivel ndërkombëtar, lidhur me kualifikimin, akreditimin dhe licensimin e psikologëve.

Duke mirëkuptuar institucionin lidhur me justifikimin e mbulimit të 3 profileve me lëndë e module sipas nevojave për formim profesional, lëndët kanë një ndarje sipas kategorive të komponentëve mësimorë bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁴¹; Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave⁴², dhe Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021 i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018⁴³ sipas tipit të veprimtarisë në A- lëndë bazë, B- lëndë karakterizuese, C-lëndë ndërdisiplinare/integruese, D-lëndë plotësuese, dhe E-detyrime përmbyllëse. Kjo lloj ndarje është pjesë e detyrimeve ligjore minimale për hapjen e programit të studimit por nuk justifikojmë 3 profile të ndryshme brenda një programi nisur nga fakti që lëndët të caktuar japin njohuri të zbatueshme në një sër profilesh. Kjo kërkon që njohuritë të përshtaten me nevojat profesionale, kompetencat, rolin dhe detyrat e psikologut klinik, shkollor dhe ligjor. Mbi bazën e këtyre ndarjeve edhe Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë jep licensat për ushtrimin e profesionit, duke qenë se për nga roli dhe detyrat në vendim e punës këto profile kërkojnë njohuri dhe kompetenca të avancuara për të justifikuar titullin e diplomës që marrin. Lëndët me fokus në drejtim të kërkimit shkencor janë pjesë integrale e cdo programi studimi të ciklit të dytë të studimit, që emërtohet “Master i Shkencave” dhe në përfundim të të cilit u jep studentëve gradën Master i Shkencave në fushën përkatëse. Dhe sigurisht kjo lejon vijimin e studimeve në ciklin e tretë, gjë që në raport është evidentuar pa i cënuar këtë të drejtë këtij programi studimi. Për sa më sipër ky komandim nuk ndryshon.

- Lidhur me komentin “Pika 1.3, kriteri 1: GVJ e sheh me skepticizëm mënyrën sesi stafi akademik do përfshijë brenda një syllabusi dhe do të trasmetojë te studentët njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. Brenda një programi studimi shohim të inkorporuara tre profile të cilat janë shumë të ndryshme nga njëri-tjetri, dhe secili kërkon impenjim dhe kompetenca profesionale të zhvilluar përmes kualifikimeve në linjë me profilin dhe/ose përvojën profesionale, që të mund të trasmetohet te studentët më mënyrën dhe sasinë e duhur”

⁴¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 30.09.2022).

⁴² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”
<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 30.09.2022).

⁴³ Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021. i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar.
<https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 30.09.2022).

Ne e vlerësojmë shumë të rëndësishëm këtë mendim, pasi është në filozofinë e punës së një pedagogu që të zhvillojë mësimin referuar njohurive, aftësive e kompetencave profesionale. Pavarësisht se profilet do të prodhojnë profesionistë në sisteme të ndryshme klinik/shkollor/ligjor, njohuritë e stimuli pritet tu përshtatet psikologut me formim shumë të thelluar në çështjet e zhvillimit, testimit e vlerësimit, kërkimit, aplikimit sipas profilit. Ndarja e profileve është e dukshme në lëndët e specialitetit të secilit profil, për më tepër informacioni është i integruar në lëndët e përbashkëta. Konkretisht, kur flasim për vlerësimin pedagogu përdor raste studimore në mjediset klinike të shëndetit mendor, në mjediset edukuese në shkollë, dhe në mjediset e sistemeve ligjore si në gjykata Po kështu, në secilin nga këto profesione është e domosdoshme njohuria mbi testimin e vlerësimit, këshillimin afatshkurtër/afatgjatë, raportimin me shkrim e verbal, etj. Referuar edhe gjykimit tuaj me vlerë në Kriterin 3, pritet të shihet se si do të implementohet programi kur në momentin që do të kemi studentë të regjistruar në profilet shkollore e ligjore, pasi deri tani i referohemi dy profileve jo aktive në mesimdhënie Psikologji me profil: “Ligjor” dhe “Shkollore”.

Bazuar në këtë aspekt komentet, sugjerimet janë bazuar në dy element të rëndësishëm të mënyrës sesi implementohet kurrikula mësimore.

Së pari këto element lidhen me përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve mësimore të cilat paraqesin një sër problemesh lidhur me temat mësimore të trajtuar që janë të një nivel fillestar njohurish, herë temat mësimore dalin jashtë tipologjisë së lëndës dhe emërimit të saj, dhe njohuri që janë marrë në ciklin e parë të studimeve. Për të gjitha këto aspekte raporti përmban informacion të detajuar mbi titujt e temave mësimore, përplasjet me lëndët e tjera kur janë evidentuar, dhe ripërsërtitje të koncepteve nga niveli bachelor.

Së dyti stafi i angazhuar në mesimrdhënie është i kategorisë lektor dhe mban gradën shkencore Dr., të cilët duke iu referuar syllabuseve janë dhe hartuesit e programeve të lëndëve, gjë e cila bie ndesh me Ligjin e Arsimit të Lartë për sa i përket titullarëve të lëndëve mësimore. Kryesisht profili mbizotërues bazuar në urdhrin e licensimit të tyre është “Klinik”. Duke integruar në lëndët e tyre, njohuri nga profile të ndryshme, në përpjekje për t’i bashkuar rrezikohet që të mos thellohesh aq sa duhet në asnjërin prej tyre, ky konstatim bazohet në përmbajtjen e programit të lëndëve mësimore. Vështirësia e një lektori që i përket profilit klinik qëndron në faktin që duke mos pasur kompetenca e njohuri, e as përvojë profesionale në profilet e tjera të mos jetë në gjendje të zhvilloj te studentët njohuri të thelluara për profilin e zgjedhur. Gjithashtu profilet klinik, shkollor dhe ligjor nuk janë të njëjtë as në drejtim të vlersimit, zhvillimit dhe kërkimit të aplikuar. Secili prej këtyre profileve ka një rol të përcaktuar qartë, zotëron kompetenca dhe përdor instrumentat e vlerësimit dhe mjetet e ndërhyrjes në funksion të kategorisë së klientëve me të cilët punon. Kodi i etikës dhe deontologjisë së psikologut dhe ligji nuk të lejojnë ushtrimin e rolit dhe detyrave që janë jashtë kompetencave dhe kualifikimeve akademike e profesional. Kujtojmë institucionin se profesioni i psikologut është një profesion i rregulluar me ligj dhe si i tillë duhet ushtruar konform rregullave. Gjithashtu edhe kualifikimi dhe njohuritë e studentëve që zgjedhin të investojnë në këto profile duhet të jepet me përgjegjësi shkencore dhe etike nga ofruesit potencial.

Cdo institucion që ka pjesë të oferës formative programe studimi duhet të ketë marrë të gjitha masat për ecurinë normale të tyre. Cështja në këtë rast komplikohet nga fakti se pjesë e profilit Klinik (profil aktiv) ka më shumë lëndë që përpiqen të mbulojnë programin e tyre mësimore me tema që prekin pak nga psikologjia ligjore, shkollore e klinike dhe nëse i referohemi syllabuseve nuk mund të flasim për një profil aktiv apo pasiv por një profil që përpiket të integrojë njohur nga tre profilet. Lëndët me zgjedhje nuk arrijnë të përmbushin nevojat e profileve përkatëse për njohuri të thelluara e kompetenca profesionale në linjë me profilet. Për sa më **sipër ky rekomandim nuk ndryshon.**

- Lidhur me komentin *“Referuar standartit 1.4, pika 1: GVJ sugjeron UNYT të rivlerësojnë mundësinë e ofrimit të stafit të kualifikuar në profilin shkollor dhe ligjor me qëllim të t’i përgjigjet në mënyrën e duhur nevojës së studentëve për të njohur rolin dhe pozicionin e tyre si dhe të zhvillojë kompetencat profesionale për të përmbushur siç duhet të gjitha detyrimet e rolit profesional kaq shumë të kërkuar në tregun e punës në varësi të profilit përkatës”*. UNYT është në kërkim të vazhdueshëm për të siguruar punësimin me kohë të plotë dhe të pjesshëm të profesionistëve për ofrimin e lëndëve në profilin shkollor e ligjor.

Bazuar në këtë aspekt GVJ nuk ka asnjë koment për të shtuar duke u parashtruar nga vetë institucioni si një aspekt për të cilin po tregohet një vëmendje e shtuar për të përmbushur këtë nevojë. Për sa më **sipër ky rekomandim nuk ndryshon.**

- Lidhur me komentin *“Standarti 2.4, kriteri 3: Përsa i përket sugjerimit për hartimin e syllabuseve të lëndëve për secilën prej profileve të propozuara me qëllim që njohuritë e marra nga studentët të jenë në linjë me nevojën e tyre për njohuri të thelluara, shprehi, dhe zhvillim kompetencash profesionale në profilin e zgjedhur. Dokumentacioni që Institucioni ynë ka dërguar, me të drejtë i referohet vetëm programit MSc në Psikologji, me profil “Psikologji klinike” i cili është aktiv, por, dëshirojmë të theksojmë se Syllabuset janë të hartuara për programin e studimit Msc në Psikologji, me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Ligjore” dhe “Psikologji Shkollore”. Ju lutem gjeni bashkëngjitur evidencen.*

Bazuar në dokumentacionin e lidhur me një pjesë të syllabuseve të lëndëve mësimore kemi komentuar edhe mbi këtë standart pasi ato pavarësisht emërimit kanë të njëjtën përmbajtje, të njëjtat çështje lidhur me përsëritjen e njohurive në lëndë të ndryshme, fokusimin në njohuri bazike të nivelit bachelor dhe tema që dalin jash tipologjisë së lëndës duke përfshirë tema e çështje të cilat duhet të trajtohen në lëndë të tjera^{44,45,46,47}. Për sa më **sipër ky rekomandim nuk ndryshon.**

- Lidhur me komentet *“Standarti 2.4, Kriteri 7 Sugjerojmë njësinë bazë të rishohë përsëritjen e mbivendosjen e disa temave mësimore në disa nga lëndët mësimore si ‘Testimi dhe matja*

⁴⁴ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

⁴⁵ Evidenca 2. Vizita dy ditore në institucion. Plani mësimorë i programit Msc në Psikologji me profile Psikologji klinike, Psikologji Shkollore dhe Psikologji Ligjore, UNYT.

⁴⁶Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

⁴⁷ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

psikologjike' me lëndën 'Vlerësimi psikologjik'; apo lënda 'Psikopatologji e avancuar' me lëndën 'Strategji të aplikuara dhe teknikat e Psikoterapisë'.

Lëndët e sipërcituara kanë një ndarje shumë të qartë të temave për secilën sesion të leksionit e të punës individuale e praktike me studentët. Në asnjë nga lëndët nuk ka përsëritje të punës me studentët apo të leksioneve përkatëse. Konteksti i paraqitjes si dhe njohuritë e thelluara në secilën nga lëndët janë të paraqitura në mënyrë shumë të qartë. Literatura përkatëse në secilën nga lëndët si dhe puna e organizuar me studentët nuk paraqet hapsirë, në mendimin tonë për mbivendosje të temave Brenda apo jashtë literaturës së secilës lëndë. Në një paraqitje të detajuar të secilës nga lëndët, ju paraqesim si më poshtë qasjen e secilës lëndë: Nëse në lëndën e Testimit e të Matjes Psikologjike studentët do të njihen me paraqitjen e rëndsisë së testimit psikologjik si pjesë e procesit të vlerësimit psikologjik, lënda trajton shkrimin e deklaratave Brenda testit, administrimin e testeve të ndryshme (me raste konkrete si pjesë të një procesi vlerësimi), thellimin e intervistës së strukturuar e të pastrukturuar si një instrument testues, me format e saj/templates të mundshme për paraqitjen e të dhënave pas aplikimit të saj, që ndiqet më pas nga identifikimi i një seri testesh referuar problematikave, si: testet e inteligjencës, testet e përdorura në mjediset klinike/edukative/ligjore; testet që përdoren në vlerësimin e personalitetit si dhe ato në mjediset klinike e këshillimore. Testimi si një pjesë themelore e procesit të vlerësimit i paraprin lëndës së vlerësimit psikologjik. Nëse në lëndën e testimit e matjes bazohemi mbi llojin e instrumentave, besueshmërinë, popullatën që ato studiojnë sipas grupmoshës, çështjeve të besueshmërisë e standartizimit, studentët janë vendosur në provë për aplikimin e intervistës klinike si dhe të identifikimit të testeve të përshtatshme referuar rastit studimor që kanë patur në studim individual gjatë kursit. Ndërkohë, lënda e vlerësimit psikologjik, thellohet në vlerësimin psikologjik per se, qartazi sipas crregullimeve psikologjike të paraqitura në DSM5, ku paraprihet nga rastet studimore, shqyrtimin e kriterëve të DSM5 dhe të diagnozës diferenciale gjatë procesit të integruar të vlerësimit psikologjik. Trajtimi i rasteve të crregullimeve merr jetë deri në fazën e sugjerimit të një plani trajtimi të rekomanduar për terapistin. Pas këtyre dy lëndëve, nis Trajtimi Psikologjik ku trajtohet rëndësia e qasjes dhe e aftësive gjatë trajtimit të individit. Lënda është e paracaktuar në disa faza, të mirë identifikuar. Brenda syllabit identifikohen aftësitë që nevojiten për një sesion terapeutik, çështje të kulturës, edukimit, inteligjencës si komponentë të rëndësishëm të punës së punës gjatë trajtimit në terapi si dhe një seri temash të evidentuara (që nuk përplasen asnjëra me syllabin e Vlerësimit Psikologjik apo të Strategjive e aplikimit të psikoterapisë). Kjo pasi syllabet diskutohen e shqyrtohen Brenda stafit për të shmangur përsëritjen e temave. Megjithatë, në nivel diskutimi, ripërsëritje të mesazheve qendrore mbi psikoterapinë kanë gjithmonë vend dhe rëndësi pasi sigurojnë rritjen e sigursë së studentit në lidhje me njohuritë në të nxënë të mëparshëm dhe rasteve me të cilat hasen në lëndët e radhës. Në lëndën e Strategjive të Aplikuara të Psikoterapisë janë marrë në shqyrtim në mënyrë të detajuar të gjitha strategjitë e teknikat sipas shkollave të mëndimit në Psikoterapi, nisur nga ajo psiko-analitive deri tek kognitive-biheviorale. Studentët janë inkurajuar ti mëshojnë punës individuale duke aplikuar teknika të shkollave specifike në praktikat e tyre në mësim dhe në ndërmarrjen e rasteve për arsye studimore.

Duke u bazuar në këtë aspekt për të mos përsëritur vetveten, në raport jepet një informacion i detajuar mbi temat mësimore dhe përplasjet e mundëshme të tyre, ripërsëritja dhe dalja jashtë tipologjisë së lëndës. Konstatimet tona mund të jenë lehtësisht të verifikueshme bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar^{48,49}. Kujtojmë institucionin se gjetjet tona nuk janë detyruese por rekomaduese duke u mbështetur në asetet dhe potencialin e institucionit për t'i përmbushur plotësisht. GVJ i jep rekomandimet lidhur me syllabuset për këtë program, nisur nga kompetencat dhe kualifikimet profesionale lidhur me profilet që vlersohen dhe bazuar në përvojën e gjatë të punës akademike në këto profile. Gjykojmë gjithashtu se opinionet tona mund të përmbajnë nota subjektivizmi, të cilat jemi përpjekur t'i "mbysim" duke i mbështetur komentet, diskutimet dhe gjetjet tona në evidencat dhe dokumentacionin e shqyrtuar për të përmbyllur me sukses këtë proces pune sfidues për nga detyra dhe përgjegjësia. Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave/Arteve në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE NË “PSIKOLOGJI” ME PROFILE “PSIKOLOGJI KLINIKE”, “PSIKOLOGJI SHKOLLORE”, “PSIKOLOGJI LIGJORE”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Institucioni i Arsimit të Lartë Jopublik, Universiteti i “New York-ut” në Tiranë zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me statutin ⁵⁰ dhe rregulloren ⁵¹ e tij të brendëshme, hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁵² dhe aktet nënligjore

⁴⁸Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

⁴⁹ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

⁵⁰ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

⁵¹ Evidenca 15. Rregullore e Universitetit.

⁵² Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”<https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJ>

	<p>si VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁵³; Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave⁵⁴, dhe Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021 i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018⁵⁵. Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore⁵⁶ dhe bazë⁵⁷, si dhe atë të programit të studimit⁵⁸ që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës, në linjë me interesat kombëtarë.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Program i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, i ofruar nga UNYT, respekton vlerat akademike, kulturore kombëtare në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁵⁹, të cilat janë pasqyruar në një sërë dokumentash të rëndësishëm që rregullojnë mbarëvajtjen e punës akademike, por jo vetëm, si statutin, rregulloren e njësisë kryesore, bazë, rregulloren e programit të studimit. Ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe paisjen e diplomë referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve⁶⁰ sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve të shtetit.</p>

[AEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLE TORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE djvu.txt](https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/vieëer?a=v&pid=sites&scid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËEiYjdi) (Aksesuar më 30.09.2022).

⁵³ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlori.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 30.09.2022).

⁵⁴ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/vieëer?a=v&pid=sites&scid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËEiYjdi> (Aksesuar më 30.09.2022).

⁵⁵ Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021. i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar.<https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 30.09.2022).

⁵⁶ Evidenca 16. Faculty Rules and Regulation, Alb.

⁵⁷ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁵⁸ Evidenca 20. Rregullore e programit.

⁵⁹ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”<https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLE TORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE djvu.txt> (Aksesuar më 17-02-2022).

⁶⁰ Ligj Nr. 23/2018 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf (Aksesuar më 30-09-2022).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

18

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Duke u mbështetur në planin strategjik të zhvillimit institucional⁶¹ si dhe në kërkimin strategjik të tregut⁶², ky program është përpjekur të hartohet në frymën e kuadrit të ri ligjor duke shfrytëzuar hapsirat lidhur diversifikimin e ofertave formative. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, është në përputhje me qëllimin dhe misionin e UNYT dhe është integruar në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij, Departamentit të Psikologjisë. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve, ky master me tre profile do të përbëjë një sfidë për njësinë dhe stafin lidhur me prespektivën e zhvillimit të tij në të ardhmen dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në avancimin e kërkimit shkencor në drejtim të problemeve psiko-sociale, me të cilat ndeshet psikologu klinik, shkollor dhe ai ligjor sot.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” konsiderohet i nevojshëm dhe në linjë me zhvillimin e shërbimit psiko-social në institucionet që ofrojnë shërbime psikologjike në kontekste të ndryshme profesionale në vendin tonë. Shërbimi psikologjik konsiderohet i një rëndësie të vecantë përsa i përket rolit mbështetës në drejtim të zhvillimit pozitiv të fëmijëve, adoleshentëve, të rriturve dhe personave në konflikt me ligjin që kanë nevojë për mbështetje psiko-emosionale përgjatë krizave të ndryshme me të cilat përballen në jetën e tyre. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i cili lidhet me studimin e tregut të punës⁶³, nga ana e UNYT paraqet një prespektivë optimiste dhe me një fushë të gjerë veprimi, gjë që reflektohet edhe në brendësi të raportit me një garanci në drejtim të përfitimit të njohurive teorike dhe trajnimeve profesionale që lehtësojnë vizibilitetin e diplomës së tyre në tregun e punës, por mbetet e paqartë sesi do të mbulohen profilet duke ruajtur specifikat dhe unicitetin e secilës prej tyre duke qenë të integruara në një program të vetëm. Një master shkencor, me kohëzgjatje dy vjeçare e kemi të vështirë ta gjejmë në një insitucion tjetër të arsimit të lartë</p>

⁶¹ Evidenca 13. UNYT Strategic Plan 2020-2025, Alb.

⁶² Evidenca 21. UNYT Market Research Strategy.

⁶³ Evidenca 22. UNYT Market Study, Eng.

	publik në vend apo në arenën ndërkombëtare (Europsy ⁶⁴ ; APA ⁶⁵), kjo për arsyjen se është e pamundur që të zhvillohen njohuri teoriko-praktike dhe kompetenca të avancuar në 3 profile të ndryshme profesionale njëherësh.			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Masteri Shkencor në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” përfiqet të integrojë në një fushë, atë të psikologjisë, njohuri të përgjithshme që synojnë të prekin tre disiplina të ndryshme të saj. Bazuar në profin dhe llojin e programit të studimit të ciklit të dytë, në aspektin ligjor nuk ka asnjë kufizim për të vijuar studimet në ciklin e tretë me qëllim zhvillimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe shkencore më të thelluara në fushën e psikologjisë kjo lidhur edhe me njohuritë rreth metodologjisë së kërkimit shkencor që jepen përmes këtij master duke iu referuar planit mësimor ⁶⁶ dhe syllabuseve të lëndëve ⁶⁷ . Ajo çfarë shihet me skepticizëm është mënyra sesi njohuritë e thelluara, aftësitë e kompetencave profesionale do të zhvillohen te studentët sipas profileve të zgjedhura në 2 apo 3 orë leksioni dhe 1 apo 2 orë seminari.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ofruar nga UNYT, është në linjë me strategjinë e

⁶⁴ European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec) https://ëëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3_Ëëëë_professions (Aksesuar më 30.09.2022)

⁶⁵ American Psychological Association (2022) Divisions of APA. https://ëëë.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706 (Aksesuar më 30.09.2022)

⁶⁶ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

⁶⁷ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

<p>strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>zhvillimit institucional⁶⁸ si dhe në kërkimin strategjik të tregut⁶⁹ dhe synon konsolidimin e dijeve, respektimit të lirisë akademike, autonomisë së strukturave përkatëse në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit, të avancimit në cilësinë e shërbimeve për palët e tjera. Dokumentacioni i UNYT, i shqyrtuar nga GVJ gjithashtu shpalos ambicjen e tij edhe në drejtim të mobilitetit duke lehtësuar shkëmbimin e stafit akademik⁷⁰; ⁷¹ dhe të studentëve⁷²; ⁷³ përmes një sërë programesh të BE-së. Ambicje që lehtësohet edhe nga fakti që programi ofrohet në gjuhën angleze.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Duke u bazuar te statuti⁷⁴ dhe rregullorja⁷⁵ e UNYT ka një ambicje të qartë në drejtim të zhvillimit në të gjitha drejtimet akademike, si dhe të ndërkombëtarizimit të tij kjo edhe përmes zhvillimit të programeve në bashkëpunim me State University of New York/ Empire State College (SUNY)/ESC në SHBA, me qëllim marrjen e diplomës së dyfishtë. Edhe pse është për t'u vlersuar ky vizion që synon të përthyeret në kontributit konkret në drejtim të prioriteteve të tij akademik edhe në mënyrën sesi është hartuar program i studimit në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” duke iu përshtatur kësaj politike të brendëshme të institucionit. GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nuk ka evidentuar ndonjë element në lidhje me ofrimin e këtij program studimi në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër.</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Program i studimit në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ofrohet nga departamenti i Psikologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, duke qenë në linjë me prioritetet e institucionit. Bazuar në këto të dhëna konfirmojmë se emërtimi, organizimi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit dhe strategjisë së tij për zhvillim⁷⁶.</p>

⁶⁸ Evidenca 13. UNYT Strategic Plan 2020-2025, Alb.

⁶⁹ Evidenca 21. UNYT Market Research Strategy.

⁷⁰ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁷¹ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

⁷² Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁷³ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁷⁴ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

⁷⁵ Evidenca 15. Rregullore e Universitetit.

⁷⁶ Evidenca 13. UNYT Strategic Plan 2020-2025, Alb.




<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Ky program studimi është hartuar duke u bazuar në prioritetet kombëtare lidhur me shërbimet psikologjike në kontakte të ndryshme profesionale të disiplinës së psikologjisë në Republikën e Shqipërisë. Hartimi dhe zhvillimi i programit të studimit synon të japë një kontribut të drejtpërdrejt në fushën e shëndetit mendor, edukimit dhe atë ligjor dhe të mbështetjes së shoqërisë. Kjo lidhur me rolin e psikologut klinik, shkollor dhe ligjor si një profesionist që mbështet, ndihmon, orientojnë fëmijët, adoleshentët, individët në moshë madhore lidhur me problematika të ndryshme. Në kushtet aktuale të përballjes me pandeminë globale roli i këtyre programeve studimi me drejtim human, na jep mundësinë të gjithëve të mund të edukohemi me vlerat e larta të respektit për dinjitetin, integritetin dhe kompetencat profesionale për t'i shërbyer shoqërisë ku bëjmë pjesë, duke qenë konform ligjeve⁷⁷ dhe akteve nënligjore^{78,79} por edhe me detyrimin për të përgatitur individ që justifikojnë vetveten dhe profesionin që përfaqësojnë në mënyrë dinjitoze.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të</p>	<p>Duke iu referuar objektivave të përcaktuar në rregulloren⁸⁰ e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji</p>

⁷⁷ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 17-02-2022).

⁷⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 17-02-2022).

⁷⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYkx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UzZkZkMzEiYjdi> (Aksesuar më 17-02-2022).

⁸⁰ Evidenca 20. UNYT Rregullore e Programit.




<p>përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjore” synon të pajisë studentët me njohuri të avancuara, aftësi të mëtejshme dhe eksperiencë në drejtime të ndryshme të disiplinës së Psikologjisë. Njësi bazë që e ofron, përmes këtij programi synon të përgatisë psikologë të aftë, të cilët do të jenë në gjendje jo vetëm të plotësojnë kriteret ligjore për licensim si psikologë në Republikën e Shqipërisë, por dhe të kontribuojnë në shumë fusha të shoqërisë së sotme, që përfshijnë shërbimet sociale dhe njerëzore, edukimim dhe arsimin, shërbimet publike, këshillim dhe punë klinike, sistemin ligjor dhe në kërkim shkencor në fushën e Psikologjisë. GVJ sheh me skepticizëm mënyrën sesi stafi akademik do përfshijë brenda një syllabusi dhe do të trasmetojë te studentët njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. Brenda një programi studimi shohim të inkuorporuara tre profile të cilat janë shumë të ndryshme nga njëri-tjetri, dhe secili kërkon impenjim dhe kompetenca profesionale të zhvilluar përmes kualifikimeve në linjë me profilin dhe/ose përvojën profesionale, që të mund të trasmetohet te studentët më mënyrën dhe sasinë e duhur.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. (4.2%)</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UNYT, kemi zhvillimin e një strategjie të mënyrës sesi do të kryhen studimet e tregut të punës⁸¹, ku sugjerohen një sërë aspektesh që mund të jenë në fokus të kërkimit, gjithashtu target grupi, i cili mund të shërbejë si kampion. Një studim të tregut të punës është vënë në dispozicion dhe ai përfshin një analizë të përgjithshme të pritshmërisë të studentëve dhe prindërve lidhur me mundësitë e tregut të punës në Shqipëri. Ky projekt duket se ka shërbyer për të bërë një vlerësim të tregut të punës nga ana e institucionit, para hapjes së programit të studimit Msc në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjore”⁸². Nga studimi i tregut të punës konkludohet se është e gjerë mundësia e studentëve për të gjetur veten në profilin e psikologut shkollor, ligjor dhe klinik në një sërë institucionesh private dhe publike që ofrojnë shërbime psikologjike. Ky studim bën një vlerësim të hapësirave dhe</p>

⁸¹ Evidenca 21. UNYT Market Research Strategy.

⁸² Evidenca 22. UNYT Market Study.

	<p>mundësive të punësimit që studentët e sapo diplomuar kanë në institucione të ndryshme, ku evidentohen shqetësimet e sjella nga tregu i punës mbi mungesën e aftësive dhe kompetencave profesionale të të sapodiplomuarve. Duke u bazuar te të dhënat sasiore të marra përmes vetëraportimit të studentëve janë gjeneruar statistika përshkruese për preferencat e studenteve për degë e profile specifike, nga ku vihet re se psikologjia ka një përqindje të ulët në preferencat e pjesëmarrësve në studim (4.2%). Ajo që shihet si e paqartë është se studimi i tregut bën një analizë për disa profile të tjera si të jurisprudencës, ekonomisë dhe inxhinierisë etj, por nuk ka ndonjë analizë e rekomandim me fokus në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke iu referuar rregullores së programit të studimit⁸³, plani mësimor⁸⁴ dhe syllabuseve të lëndëve⁸⁵, GVJ është përpjekur të jap një vlerësim lidhur me këtë kriter. Programi i studimit Msc në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” duke iu referuar rregullores paracakton objektiva formativ të ndryshëm për secilin profil, kjo në linjë edhe me kompetencat që duhet të formojë te studentët, duke qenë se këto profile ndryshojnë shumë midis tyre. Referuar planit mësimor⁸⁶ kemi të ndarë 3 profile, i cili përmban ndryshime në emërtim vetëm për kategorinë e lëndëve ndërdisiplinore integruese në varësi të profilit, përmes të cilave synohet edhe zhvillimi i kompetencave profesionale të studentëve sipas profilit përkatës. Rregullorja e programit të studimit gjithashtu duke iu referuar objektivave formuese, strukturës dhe përmbajtjes së programit të studimit, i ka përcaktuar të ndara këto aspekte për secilin profil. Bazuar te syllabuset e lëndës kemi vetëm një syllabus, i cili përmes programit lëndor synon të zhvillojë njohuri dhe kompetenca te studentët sipas profileve përkatëse. Mbetet për t’u parë sesi kjo mënyrë organizimi do të garantojë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji</p>

⁸³ Evidenca 20. UNYT Rregullore e Programit.

⁸⁴ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

⁸⁵ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

⁸⁶ Evidenca 9. UNYT Master in Psy- 3 Profiles Final version.




<p>studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjore” duke i’u referuar emërtimit të tij, përmbajtjes së programit lëndor dhe tipologjinë e lëndëve të formimit karakterizues dhe integruese është i vështirë të përafrohet me programe të tjera në IAL-et publike në vend, pasi pjesa më e madhe e tyre ofrojnë programe të ngjashme studimi vetëm për një profil specifik dhe nuk i kanë të grupuara të treja në një program, kjo konsiderohet si vecanti e UNYT. Sigurisht bëhet e vështirë të vlerësohet mundësia e transferimit të studimeve apo punësimit në tregun ndërkombëtar, edhe pse masteri në fjalë ofrohet në gjuhën angleze, kjo e lidhur edhe me një sërë kushtesh të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë e programit të studimit. Në thelb ky program studimi, bazuar te plani mësimor⁸⁷ dhe syllabuseve të lëndëve⁸⁸, përmes lëndëve dhe moduleve synon pajisjen e studentit me njohuri dhe kompetenca që janë të ngjashme me atë që përgjithësisht mund të marrë një student edhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend për profilin profesional të psikologut klinik, profilet e tjera shihen të riskuara për sa i përket njohurive e kompetencave që mund të zhvillojnë te studentët. Duke iu referuar një sërë organizmash të rëndësishme ndërkombëtare që kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e shkencës së psikologjisë dhe monitorimit e standardeve më të larta profesionale në ushtrimin e profesionit të psikologut, Europsy⁸⁹; APA⁹⁰, American Psychology and Loë Society⁹¹, nuk evidentohet ndonjë program i ciklit të dytë që të përfshijë tre profile në një.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara,</p>	<p>Duke u bazuar në statutin dhe vizionin e institucionit, diplomat e përbashkëta me institucionet ndërkombëtare kanë qenë në fokus të UNYT që në themelim. Kjo mbështetur në hapat e ndërmarë për t’i ofruar programet në gjuhën angleze, element që duhet vlerësuar si pozitiv dhe që lehtëson procesin e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes programeve të Erasmus+</p>

⁸⁷ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

⁸⁸ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

⁸⁹ European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec) https://eue.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3_Èhich_professions (Aksesuar më 30.09.2022)

⁹⁰ American Psychological Association (2022) Divisions of APA. https://eue.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706 (Aksesuar më 30.09.2022)

⁹¹ Bottoms, B., Costanzo, M., Greene, E., Redlich, A., Eoolard, J. & Zapf. P. (2004). Careers in Psychology and the Laë: A Guide for Prospective Students. A Publication of the Careers and Training Committee, American Psychology-Laë Society, APA Division 41. <https://eue.apadivisions.org/division-41/education/students/career-guide.pdf> (Aksesuar më 31.09.2022).




<p>mbështetet në përvojën disaveçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>etj, dhe bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në vendet e BE. Gjithashtu vlen të theksohet se kur flasim për fushën e Psikologjisë bazuar në mungesën e përvojës në drejtim të zhvillimit të kësaj shkence në vendin tonë para viteve 90, duhet të kemi parasysh se programet lëndore tipikish përgjatë gjithë historisë së zhvillimit të kësaj disipline janë bazuar dhe kanë evoluar duke u mbështetur në programet ndërkombëtare dhe duke marrë si model zhvillim, qasjen që këto vende kanë pasur ndaj psikologjisë. Në këtë kuadër përgjithësisht programet e studimit në këtë fushë kanë ngjashmëri në drejtim të programit lëndor dhe objektivave formuese e kompetencave profesionale që synojnë të zhvillojnë. Duke iu referuar këtij program studimi, një sër elementësh të strukturës së këtij programi studimi si kreditet sipas Sistemit Evropian të Trasferimit të Krediteve (ECTS), kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlersimit, etj, janë të gjithë element të pranishëm që janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Ajo çfarë konsiderohet si ngërc është prania e 3 profileve të ndryshme brenda një program të ciklit të dytë që praktikisht e bën të pamundur zhvillimin e kompetencave dhe aftësive e njohurive të thelluar sipas secilit profil.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në linjë me direktivat ndërkombëtare e kombëtare për profesionet e rregulluara dhe ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar⁹². Kjo gjë ka imponuar rregulla të qarta edhe për IAL-et publike e private lidhur me përshtatjen e programeve të studimit në linjë me rregullat në fuqi. Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ofrohet me kohë të plotë, i shtrirë në dy vite akademike me kohëzgjatje normale dhe organizohet me 120 ECTS⁹³. Bazuar në programin lëndor dhe planin mësimor të këtij programi, studentëve u mundësohet përvoja e praktikës profesionale, e cila mund të kryhet në disa qendra dhe institucione publike dhe private në vend. Kjo</p>

⁹² Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

⁹³ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

	<p>përzgjedhje e institucioneve të praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë kompetencat profesionale, fitojnë dije praktikë mbi mjetet dhe instrumentat që përdor psikologu sipas profilit të zgjedhur në punën e tij. Gjithashtu këto profile profesionale të ofruara nga UNYT janë të përfshirë në grupin e profesioneve të rregulluara nga shteti. Por edhe nëse studentët nuk penalizohen lidhur me kriteret që të licensohen te Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, konform procedurave të vet urdhrit, duke qenë se emërtimi i diplomës do të përmbajë një ndarje sipas profilit të zgjedhur nga studentët, krijon një lloj ambiguiteti të kompetencat e munguar ose të pjeshme që mund të marrin lidhur me profilin e tyre, njohuri që duke iu referuar planit mësimor kufizohet vetëm te lëndët me zgjedhje, gjë e cila nuk ezauron të gjitha nevojat e profilit të zgjedhur.</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjorë” ofrohet në gjuhën angleze. Ky element nën klimën e kohëve të fundit lidhur me ndër-kombëtarizimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, të promovuar fort edhe nga Kryeministri e sheh vizionin e UNYT një hap para të tjerëve. Kjo pasi duke shqyrtuar dokumentacionin kemi një sërë praktikash pozitive në drejtim të mobilitetit e shkëmbimit të stafit akademik^{94, 95} dhe të studentëve^{96, 97} përmes një sërë programesh të BE-së si Erasmus dhe Mevlana. Ambicje që lehtësohet edhe nga fakti që program ofrohet në gjuhën angleze.</p>
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjorë” ofrohet në gjuhën angleze dhe duke iu referuar dokumentacionit të dërguar në ASCAL, evidencat janë në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Dokumentacioni ruhet kryesisht në gjuhën angleze e shqipe, komunikimi i brendëshëm midis njësive realizohet sërish në gjuhën angleze⁹⁸.</p>

⁹⁴ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁹⁵ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

⁹⁶ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁹⁷ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁹⁸ Evidenca 80. UNYT Department Meeting




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e institucionit mbi stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie⁹⁹ dhe referuar CV¹⁰⁰ të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike.</p> <p>Stafit akademik i angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” rezultoi se nga 5 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi me profile në psikologjik klinike, shkollore dhe ligjore, katër (4) janë me profil klinik (E. C.; B. L.; S. Dh., A. H.)¹⁰¹ ndërsa A. C., me profil edukim – organizacional. Referuar kualifikimit akademik dhe përvojave profesionale rezultoi sërisht problematike çështja e mbulimit të profilit shkolror dhe ligjor me staf akademik, cili të ketë kualifikime dhe/ose përvojë profesionale në këto dy kontekste. Mungesa e kapaciteteve dhe burimet e duhura njerëzore në fushën akademike për profilin ligjor dhe shkolror mund të çënojë cilësinë në mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p><i>GVj sugjeron UNYT të rivlerësojnë mundësinë e ofrimit të stafit të kualifikuar në profilin shkolror dhe ligjor me qëllim të t'i përgjigjet në mënyrën e duhur nevojës së studentëve për të njohur rolin dhe pozicionin e tyre si dhe të zhvillojë kompetencat profesionale për të përmbushur siç duhet të gjitha detyrimet e rolit profesional kaq shumë të kërkuar në tregun e punës në varësi të profilit përkatës.</i></p>

⁹⁹ Evidenca 53. Tabela Përmbledhëse për ankesin e RVB.

¹⁰⁰ Evidenca 54. UNYT CV of instructors of Psychology Department.

¹⁰¹ Evidence 79. UNYT List of Academic Registered as Practitioners of Clinical Psychology.

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është në përputhje me kushtet dhe kriteret klasifikuese të fushës akademike kjo referuar udhëzimeve kombëtare për arsimin e lartë. Njësia bazë që ofron Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” është Departamenti i Psikologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Gjithashtu, duke qenë një program që është hapur në vitin akademik 2020-2021 dhe akoma nuk është akredituar, numri i identifikimit të diplomës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave e Çertifikatave bazuar në kodifikimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” duhet të gjenerohet konform direktivave dhe urdhëzimit Nr.12, datë 18.03.2009, “Për krijimin e Rregjistrin Shtetëror dhe Çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”¹⁰².</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë që ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ka një koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit¹⁰³ dhe asaj të programit të studimit konform nevojave të tregut të punës¹⁰⁴ përse i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është një linjë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo i jep mundësinë njësisë bazë, Departamentit të Psikologjisë, të ketë shanse në rritje për zhvillimin e burimeve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu, bazuar në klasifikimin/ kodifikimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, profilet e ofruara nga UNYT përgjithësisht janë në harmoni me statutin e tij të brendshëm¹⁰⁵ dhe rregulloren¹⁰⁶ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në</p>

¹⁰² Urdhëzimi Nr.12, datë 18.03.2009, “Për krijimin e Rregjistrin Shtetëror dhe Çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/02/Udhezim_12_18_03_2009.pdf (Aksesuar më 31.09.2022)

¹⁰³ Evidenca 13. UNYT Strategic Plan 2020-2025, Alb.

¹⁰⁴ Evidenca 21. UNYT Market Research Strategy.

¹⁰⁵ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

¹⁰⁶ Evidenca 15. Rregullore e Universitetit.

	institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ¹⁰⁷ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ¹⁰⁸ me disa ndryshime të tjera ¹⁰⁹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UNYT për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, duke siguruar koordinimin midis strukturave të saj, një sërë hallkash dhe mekanizams h rregullojnë mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik ^{110, 111, 112} . Njësia bazë përmes strukturave të saj si pedagogut udhëheqës përgjatë semestrit për çdo student ¹¹³ , grupit mësimor mbikëqyrin, monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësimor për këtë program studimi.

¹⁰⁷ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 17-02-2022).

¹⁰⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 17-02-2022).

¹⁰⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZEnhMEElYjdi> (Aksesuar më 17-02-2022).

¹¹⁰ Evidenca 20. UNYT Rregullore e Programit.

¹¹¹ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

¹¹² Evidenca 15. Rregullore e Universitetit.

¹¹³ Evidence 162. UNYT SAO Rules & Regulations, Alb.

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve Masterit Shkencor në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, Departamenti i Psikologjisë duhet të vendos në dispozicion marrëveshje institucionale¹¹⁴. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UNYT dhe të konfirmuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë por edhe nga studentët, evidentohet prania e një sërë marrëveshjesh institucionale të lidhura me institucione brenda¹¹⁵ dhe jashtë¹¹⁶ vendit në funksion të realizimit të objektivave formuese në funksion të procesit mësimor, por jo të gjitha kanë impakt në drejtim të zhvillimit të programit të studimit. Vlen të theksohet nevoja e tyre për zhvillimin e programit të studimit dhe shfrytëzimin e marrëveshjeve për qëllime të praktikave profesionale, aktivitete të tjera me natyrë ekstrakurrikulare, orë të hapura me lektorë të ftuar, takime pune dhe mundësive për mobilitet të stafit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, UNYT ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi institucional^{117,118} që janë në funksion të praktikës profesionale. Këto marrëveshje janë me disa institucione si “Deloitte Group”, “Ministria e Brendshme”, “Boga Associates”, “Eagles Group Albania”, “Neptun Albania”, “Lufthansa Albania”, “Duapune”, “GIZ-ALBANIA”, “Albtelecom”, “Smartwork” etj. Duke iu refruar listes së marrëveshjeve në funksion të praktikës profesionale nuk kemi evidenca lidhur me marrëveshjet dhe mënyra sesi janë përcaktuar kushtet e bashkëpunimit dhe afatet e vlefshmërisë ligjore mbi periudhën kohore të aktivizimit të tyre. Bazuar në listën e këtyre marrëveshjeve gjejkojmë se pjesa më e madhe e tyre nuk iu përshtaten nevojave të studentëve të fushës së psikologjisë dhe profileve ligjore, shkollore e klinike. Por si kyçe për profilin e psikologut mund të konsiderohen institucionet si “Linja e këshillimit për gra dhe vajza”, “Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, “Bashkia Tiranë” dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor</p>

¹¹⁴ Evidenca 23. UNYT List of Agreements and MoUs Carreer Office.

¹¹⁵ Evidenca 25. UNYT List of Agreements and MoUs.

¹¹⁶ Evidenca 26. UNYT List of International Universities – MoU.

¹¹⁷ Evidenca 23. UNYT List of Agreements and MoUs Carreer Office.

¹¹⁸ Evidenca 53. Tabelat Përmbledhëse për aneks- RVB.




	<p>Tiranë, të cilat krijojnë mundësi të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e mundësive për të realizuar eksperiencë pune vullnetare, kryesisht për profilet shkollore e ligjore.</p> <p><i>GVJ sugjeron UNYT që të shtohet numri i institucioneve që mund të shfrytëzohen në funksion të praktikës profesionale me qëllim që të mbulojnë në mënyrë të plotë nevojat e të 3 profileve të saj, si profili klinik me qëndra të shëndetit mendor, spitale, organizata që ofrojnë shërbime psikologjike për personat me probleme të shëndetit mendor. Profili shkollor, ku në fokus duhet të jenë institucione të arsimit parauniversitar publike dhe private, ku përfshihen cerdhe, kopshte dhe shkolla. Përsa i përket profilit Ligjor në fokus duhet të jenë institucionet e drejtësisë, ku përveç gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të përfshihen edhe rajonet e policisë, shërbimi i provës, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale etj.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Duke iu referuar marrëdhënieve zyrtare e bashkëpunimeve, kemi një sërë dokumentash lidhur me institucione brenda¹¹⁹ dhe jashtë vendit¹²⁰ për nevojat e zhvillimit të programit. Nga shqyrtimi i listave të institucioneve me të cilat UNYT ka marrëveshje, zyra e karrierës dhe njësia bazë orientojnë studentët përse i përket përvojave të ndryshme praktike si praktika mësimore, stazhet e shkurtra, puna vullnetare etj. Referuar programit të studimit “Master i shkencave” në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” evidentojmë vetëm 4 institucione që i përshtaten këtij masteri, Linja e këshillimit për gra dhe vajza”, ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’ i cili nuk ofron shërbime psikologjike për personat me probleme të shëndetit mendor, por monitoron respektimin e standarteve për ushtrimin e profesionit, certifikon trajnime e kualifikime afarshkurtra për nevojat e psikologëve. Duke iu referuar Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit Social, ka disa institucionet nën varësi si “Qendra Komunitare e Terrenit”, Qendra Multidisiplinare “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”, Qendra Komunitare “Shkozë” dhe Qendra Komunitare “Strehëza” dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pjesa tjetër e institucioneve si “Deloitte Group”, “Ministria e Brendshme”, “Boga Associates”, “Eagles Group Albania”,</p>

¹¹⁹ Evidenca 23. UNYT List of Agreements and MoUs Career Office.

¹²⁰ Evidenca 26. UNYT List of International Universities – MoU.

	<p>“Neptun Albania “, “Lufthansa Albania”, “Duapune”, “GIZ-ALBANIA“, “Albtelecom”, “Smartwork” nuk iu përshtaten nevojave të studentëve të fushës së psikologjisë dhe profileve ligjore, shkollore e klinike.</p> <p><i>Për këto 3 institucione është e nevojshme prania e një marrëveshje zyrtare ku të përcaktohen qartë mënyra sesi do të shfrytëzohen për nevojat e praktikës profesionale.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>UNYT disponon një numër të konsiderueshëm evidencash lidhur me bashkëpunimet me institucionet homologe ndërkombëtare¹²¹ lidhur me bashkëpunimin për projekte të përbashkëta universitare^{122,123,124} përmes Erasmus + dhe Mevlana¹²⁵, si dhe për mobilitetin e stafit dhe të studentëve të tij^{126, 127}. Lektorë të ftuar dhe studentë kanë qenë pjesë e leksione të hapura me profesor të ftuar vendas dhe të huaj, workshop-e¹²⁸, konferenca, projekte të zbatuara në shkallë departamenti, aktivitete shkencore të organizuara nga departamenti që janë me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”. Një sër projektesh janë ndërmarrë dhe vijojnë të zbatohen në fushën e shkencave shoqërore ku janë të përfshirë anëtarë të stafit akademik, duke kontribuar në drejtim të rritjes profesionale dhe eksperiencave të mira nga bashkëpunimet me profesionistët ndërkombëtarë Gjithashtu, në drejtimin e trajnimeve profesionale të ofruara për stafin e studentët, alumnit (ish student) e UNYT në mobilitete të ndryshme si trajnime, mësimdhënie etj. të financuar nga Erasmus +^{129, 130, 131}.</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë nëpërmjet strukturave të saj monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të programit të studimit përmes disa formave monitoruese si analiza vjetore e departamentit¹³²,</p>

¹²¹ Evidenca 26. UNYT List of International Universities – MoU.

¹²² Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

¹²³ Evidenca 34. IBU- Albania – Erasmus Agreement.

¹²⁴ Evidenca 28. UNYT Erasmus Day-University of Nër York Tirana,

¹²⁵ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

¹²⁶ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

¹²⁷ Evidenca 33. UNYT EUA Memebership Activation.

¹²⁸ Evidenca 39. UNYT Training and Ëorkshop 2020.

¹²⁹ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

¹³⁰ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolaprhship- Poster.

¹³¹ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

¹³² Evidenca 191. UNYT Annual Monitoring Report

përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	strategjisë për metodat e mësimdhënies ¹³³ . Nga Departamenti i Psikologjisë kemi evidenca ¹³⁴ lidhur me analizën e raportit të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Jo	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Duke iu referuar dokumentacionit në dispozicion rezultojnë se politikat institucionale të UNYT mbështesin stafin në përfshirjen në një sërë projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor ¹³⁵ . Bazuar në dokumentacionin për mbështetjen e stafit akademik kemi një sërë nismash ¹³⁶ që synojnë të krijojnë mundësi për pjesëmarrje në trajnime ^{137, 138, 139} , workshop ¹⁴⁰ , konferenca ^{141, 142} dhe intershipe ¹⁴³ , nga ku një pjesë e stafit akademik të njësisë bazë ka marrë pjesë në konferenca të organizuar në bashkëpunim me partnerët e saj ndërkombëtar ¹⁴⁴ dhe publikime në revista ndërkombëtare. Mbështetja e stafit lidhur me mobilitete në mësimdhënie përmes Erasmus + ^{145, 146, 147} kanë qenë të shumta. Këto lloje mobilitetesh kanë impakt pozitiv jo vetëm te stafi

¹³³ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning Strategy.

¹³⁴ Evidenca 6. Vizita dy ditore në institucion. Raporti Analitik

¹³⁵ Evidenca 81. UNYT-EU Health Issues- Univeristy of Neë York Tirana

¹³⁶ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

¹³⁷ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

¹³⁸ Evidenca 207. UNYT Staff Training

¹³⁹ Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

¹⁴⁰ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

¹⁴¹ Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – iNvitation B. L.

¹⁴² Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

¹⁴³ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

¹⁴⁴ Evidenca 88. UNYT List of Publications of the members of department 2019-2022.

¹⁴⁵ Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

¹⁴⁶ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching ëeek – internationalization of teaching

¹⁴⁷ Evidenca 127UNYT Erasmus A. Halimi.

	<p>akademik, por edhe në rritjen e aseteve të burimeve njerëzore të vetë UNYT dhe të studentëve të saj.</p> <p>Duke iu referuar dokumentacionit nuk kemi evidentuar akordim të një fondi të veçantë apo forma të tjera të mbështetjes financiare lidhur me pjesëmarrjen në konferenca e publikime shkencare për të mbështetur stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>“Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Standarteve të Cilësisë”¹⁴⁸ i zgjedhur nga senati i UNYT përpos detyrave të tjera ka për detyrë edhe kordinimin dhe vlersimin e kërkimit shkencor. Gjithashtu, duket se njësia bazë monitoron në mënyrë periodike avancimin e stafit në drejtim të kualifikimit dhe angazhimit në punë kërkimore-shkencore^{149, 150}. Njësia bazë dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë monitoron dhe vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni në funksion të vlerësimit të ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor mbështetur nga “European and Balkan Research Institute Center”, i cili ka nën varësi 3 qendra me fokus përthithjen dhe implementimin e projekteve kombëtare e ndërkombëtare sipas fushave të kërkimit shkencor “Research, Project and Innovation Center”, “Balkan Research Center” dhe “European Research Center”¹⁵¹. Ky institut ka implementuar një sër projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar¹⁵². Në realizimin e këtyre projekteve janë përfshirë pedagogë të njësisë kryesore dhe bazë, gjithashtu edhe studentët. Departamenti i Psikologjisë është angazhuar në projekte të ndryshme, anëtar të stafit akademik janë angazhuar në “Research, Project and Innovation Center”. Këto iniciativa jo vetëm promovojnë stafin dhe institucionin te palë të treta, por janë edhe përfutuese për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe përvojës profesionale, e cila shpaloset shumë mirë edhe në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe</p>	<p>Institucioni nxit stafin për të marrë pjesë në konferenca, workshope, leksione të hapura apo mobilitete të ndryshme përmes Erasmus + dhe Mevlana^{153, 154, 155}, duke u përpjekur t'i japë prioritet</p>

¹⁴⁸ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

¹⁴⁹ Evidenca 88. UNYT List of Publication of the members of department 2019-2022.

¹⁵⁰ Evidenca 187. UNYT Individual Annual Objectives of Academic Staff.

¹⁵¹ Academic Staff. <https://unyt.edu.al/index.php/faculty/> (Aksesuar më 04.09.2022)

¹⁵² Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

¹⁵³ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

¹⁵⁴ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

¹⁵⁵ Evidenca 207. UNYT Staff Training

praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	mbështetjes së pedagogëve të njësisë dhe studentëve në drejtim të avancimit në veprimtarinë kërkimore-botuese të tyre. Por nuk kemi evidenca për një mbështetje financiare nga UNYT në këtë drejtim. Gjithashtu përsa i përket mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe të drejtave të autorit kemi hasur evidenca lidhur me pajisjen e UNYT me Turitin ¹⁵⁶ -një aplikacion antiplagjiaturë që mbron pronësinë intelektuale dhe lufton plagjiaturën dhe mungesën e korrektësisë akademike.			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	UNYT duke bashkepunuar me Universitete të tjera ^{157, 158, 159} përmes Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO) bazuar në marrëveshjet bilaterale në programe shkëmbimi dhe projekte të Erasmus + dhe Mevlana krijojnë mundësi që stafi dhe studentët të mund të angazhohen në iniciativa në varësi të interesave profesionale dhe kërkimore shkencore. Një sërë nismash dokumentojnë përfshirjen e promovimin e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencorë si për stafin akademik ^{160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167} dhe për studentët ^{168, 169, 170, 171, 172} e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁵⁶ Evidenca 141. UNYT Manual of Information security, Alb.

¹⁵⁷ Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

¹⁵⁸ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching week – internationalization of teaching

¹⁵⁹ Evidenca 127 UNYT Erasmus A. Halimi.

¹⁶⁰ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

¹⁶¹ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

¹⁶² Evidenca 207. UNYT Staff Training

¹⁶³ Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

¹⁶⁴ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

¹⁶⁵ Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – invitation B. L.

¹⁶⁶ Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

¹⁶⁷ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

¹⁶⁸ Evidenca 71. UNYT.Intership Placement of intership students first cohort.

¹⁶⁹ Evidenca 36. UNYT International Student-Congress 2020.

¹⁷⁰ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

¹⁷¹ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolaprrship- Poster.

¹⁷² Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” përgjithësisht është hartuar konform Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,¹⁷³ dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”^{174, 175} dhe duke respektuar Sistemin Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS)¹⁷⁶. Kemi balancë në ndarje të lëndëve në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas udhëzimeve të MASR. Programi i studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” realizohet me 120 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij janë 2 vite akademike, i ndarë në katër semestra me peshën e fitimit të 30 krediteve për semester. Në përfundim të programit të studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” lëshohet diploma ose certifikata dhe suplementi i diplomës sipas një formati të caktuar të propozuar nga UNYT dhe të miratuar nga QSHA, konform kritereve dhe procedurave ligjore¹⁷⁷.</p>

¹⁷³Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI-80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-09-2022).

¹⁷⁴VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 17-02-2022).

¹⁷⁵Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”
<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&scid=ZnNobi5lZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 17-02-2022).

¹⁷⁶ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁷⁷ Udhëzimi Nr.10, datë 30.03.2020. Për Përcaktimin e Elementëve Përbërës, Formën e Diplomës, ose Certifikatës së Lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Procedurës së Regjistrimit të Tyre në Regjistrin Shtetëror të

	<p><i>Sugjerohet institucioni të dokumentojë formatin e diplomës ose certifikatës dhe suplementin e diplomës të propozuar dhe miratuar me vendim senati. Kjo konsiderohet e domosdoshme për të qartësuar profilet dhe formën e njohjes së tyre në përfundim të një cikli studimi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjorë”¹⁷⁸ përmes moduleve dhe lëndëve¹⁷⁹ synon të formojë shprehje dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes në kontekstin klinik por pak hapsira në drejtim të zhvillimit shkollor dhe ligjor. Kjo në një llojshmëri të gjerë rolesh profesionale si psikolog klinik në drejtim të ofrimit të shërbimeve në një sërë kontekstesh klinike, qendra spitalore dhe të shëndetit mendor; psikolog shkollor në drejtim të zhvillimit të shprehive profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët, me klientët të cilët kanë probleme të zhvillimit; dhe si psikolog ligjor në ofrimin e shërbimeve psikologjike si vlersim dhe mbështetje psiko-emocionale për të gjithë personat në konflikt me ligjin. Pikërisht rritja e diapazonit të mundësive që u krijojnë studentëve në fushën profesionale mund të konsiderohet si pikë e fortë dhe e dobët e këtij programi studimi. Për të pasur më të lehtë orientimin e studentëve në tregun e punës, por edhe drejt vetëpunësimit të tyre kërkohen kompetenca profesionale që justifikojnë emërtimin e këtij masteri. Vetpunësimi është i mundur vetëm pas liqensimit, por formimi akademik duhet të përmbush kriteret e udhrit të psikologut për liqensim të studentëve të këtij program studimi pas marrjes së diplomës për të gjithë ata student që kanë të dy ciklet e studimit në fushën e psikologjisë. Duke iu referuar emërtimit në 3 profile të ndryshme brenda fushës së psikologjisë mund të themi se ky program studimi i ciklit të dytë synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë të profesioneve. Por GVJ sheh me skepticizëm mënyrën sesi stafi akademik do përfshijë brenda një syllabusi dhe do të trasmetojë te studentët njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim dhe që karakterizojnë profilin e programit në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjorë” në përputhje me nivelin e studimeve, në të cilin ofrohen</p>

Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e LArtë dhe Kërkimin Shkencor.

http://qsha.gov.al/infos/regjistrim_diplome/udhezim_10_format_diploma_register.pdf (Aksesuar më 04.09.2022).

¹⁷⁸ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁷⁹ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

38




	<p>ato dhe me kërkesat e tregut të punës. Brenda një programi studimi shohim të inkorporuara tre profile të cilat janë shumë të ndryshme nga njëri-tjetri, dhe secili kërkon impenjim dhe kompetenca profesionale të zhvilluara përmes kualifikimeve në linjë me profilin dhe/ose përvojën profesionale, që të mund të trasmetohen te studentët më mënyrën e duhur.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Referuar këtij kriteri mund të themi se përmbajtja e programeve lëndore¹⁸⁰, dhe literatura e përdorur janë dy elementë të rëndësishëm në drejtim të njohurive të përparuara për këtë fushë studimi dhe më tej në drejtim të zhvillimit të kompetencave shkencore dhe profesionale të studentëve. Përmbajtja e programit të studimit nuk krijon kushte për zhvillim kompetencash profesionale të psikologut klinik, shkollor dhe ligjor duke iu referuar syllabuseve të lëndës¹⁸¹. Duke iu referuar syllabuseve të lëndës kemi syllabuset, të cilat janë për një profil profesional, duke qenë të paspecifikuara sipas profileve. Nëse syllabusi i paraqitur synon të aplikohet për të 3 profilet, ky mund të konsiderohet këcënim serioz i njohurive dhe kompetencave për fushën e studimit ose punësimin e studentëve të këtij programi studimi. Duke iu referuar temave mësimore duket se lektorët janë në sfidë lidhur me hartimin e syllabusit me qëllim prekjen e të 3 profileve, dhe kjo bën që risku i daljes nga linja e profilit të lëndës të jetë i madh, njohuritë janë të cinguara, pasi nuk të jep mundësi të thellohesh plotësisht në një profil dhe të ezaurosh të gjitha çështjet që parashtron lënda specifike për profilin.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë bazë të hartojë dhe disponojë syllabuset e lëndëve për secilën prej profileve të propozuara me qëllim që njohuritë e marra nga studentët të jenë në linjë me nevojën e tyre për njohuri të thelluara, shprehi, dhe zhvillim kompetencash profesionale në profilin e zgjidhur.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme</p>	<p>Duke iu referuar këtij kriteri, GVJ e ka të vështirë të përcaktojë qartë çështjen e zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, duke qenë se ambicja e institucionit përfshin në një program studimi të ciklit të dytë, 3 profile profesionale shumë të ndryshme nga njëri-tjetri. Duke vendosur para një sfide dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie që t’i përgjigjet në mënyrën e duhur nevojave të</p>

¹⁸⁰Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

¹⁸¹ Evidenca 56. UNYT Syllabi in English.

<p>për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>studentëve në 3 profile për dhënien e njohurive, zhvillimin e shprehive dhe aftësive profesionale të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në njërin prej 3 fushave të specializuara të studimit/profesionale.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë të hartojë syllabuset mësimore për secilin profil dhe të parashikojë stafin që do të angazhohet në mësimdhënie sipas profilit përkatës, duke treguar kujdes që stafi të ketë arsimimin e duhur, kualifikimet dhe fushën e ekspertizës në linjë me profilin në të cilin angazhohet.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”¹⁸² përgjithësisht përmban elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, përmes moduleve dhe lëndëve¹⁸³ të ndara sipas kategorive. Plani mësimorë është i organizuar në lëndë/module, numër kreditesh, sipas vitit akademik dhe semstrave, orë leksioni, seminari, etj. Syllabuset e secilës lëndë janë të organizuara sipas strukturës si më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës, etj. Plani mësimor ka mungesa në elementët që lidhen me orët mësimore në auditor, orët mësimore në punë të pavarur të studentit, për lëndën plotësuese 12 ECTS (praktikën) dhe detyrimet përmbyllëse 18 ECTS (temën e diplomës) mungon ndarja e orëve mësimore në auditor dhe punë e pavarur e studentit.</p> <p><i>Rekomandojmë institucionin që të përfshijë në planin mësimorë të gjithë komponentët e përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”¹⁸⁴; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe disa shtesave që i janë bërë VKM Nr. 41, Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021¹⁸⁵.</i></p>

¹⁸² Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁸³ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

¹⁸⁴ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-09-2022).

¹⁸⁵ VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH” <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 04-09-2022).

<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë¹⁸⁶ dhe urdhrave¹⁸⁷ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite sipas përqindjes së detyrueshme bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 6.67% (8 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 55 % (66 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 13 % (16 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS); <p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”¹⁸⁸ ka një balancë të qartë të peshës që zë secila lëndë veprimtari formuese brenda programit të studimit referuar kërkesës që imponohet nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021. Duke iu referuar kriterëve të tjera përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018¹⁸⁹, si kodi i etikës apo numrit të krediteve dhe kohëzgjatjen e tij në vite janë konform aktet ligjore e nënligjore.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”¹⁹⁰ respekton kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr.185,</p>


¹⁸⁶ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-09-2022).

¹⁸⁷ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËEiYjdi> (Aksesuar më 04-09-2022).

¹⁸⁸ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁸⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËEiYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁹⁰ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.




aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	<p>datë 25.03.2021 duke përfshirë respektimin e numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga GVJ evidentohet se ky program studimi nuk parashikon në planin mësimor orët mësimore për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore orët e zhvilluara në auditor dhe orët për punë individuale e pavarur e studentit, por vetëm numrin e krediteve (18 ECTS).</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë të përcaktojë qartë në programin e studimit raportin e orëve në auditor dhe orëve në punë të pavarur të studentit për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë në UNYT, ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë. Mësohet nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe anëtarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit¹⁹¹. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit”¹⁹². IAL-i Privat, "Universiteti i New York-</p>

¹⁹¹ Evidenca 182. UNYT Action Plan, Senate Decision, Minutes of QAC.

¹⁹² Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (2017). Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit




	ut Tiranë" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" nëpërmjet shërbimit në AMS.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Njësia kryesore "Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale" dhe njësia bazë "Departamenti i Psikologjisë", përgjegjëse për programin e studimit Msc në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" përmbush detyrimet ligjore në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë". Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga këto departamente¹⁹³:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Psikologjisë • Departamenti Juridik • Departamenti i Shkencave Politike / Marrëdhënieve • Ndërkombëtare-politike
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore", përgjithësisht përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Duke iu referuar CV të tyre¹⁹⁴ mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform titujve dhe gradave, dhe pjesërisht përsa i përket fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat që grupi i vlersimit të jashtëm ka shqyrtuar, rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, për vitin akademik 2020-2021 ka patur gjithsej 40 pedagogë, nga të cilët pedagogë efektiv 26 (PAE) dhe 14 (PAK), gjithashtu për nevojat e njësisë kryesore dhe asaj bazë janë angazhuar edhe 16 (PA), ndërsa për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 40 pedagogë, nga të cilët janë pedagogë efektiv 23</p>

<https://eëë.ascal.al/media/documents/publikime/Manual%20afatet%20e%20akreditimit%20IAL%20dhe%20programe%202017.pdf> (Aksesuar më 02.09.2022).

¹⁹³ Evidenca 7. UNYT Organigrama 2020.

¹⁹⁴ Evidenca 54. UNYT CV of instructors of Psychology Department.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

43

	(PAE) dhe 17 (PAK) si dhe personeli administrative në mbështetje të procesit mësimor 18 (PA) ¹⁹⁵ .
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Përsa i përket stafit akademik të Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale për vitin akademik 2020-2021, sipas evidences rezultojnë 26 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 6 me titull “Prof.As.”, 13 me gradën “Dr.” dhe 6 me Msc, 1 Dr. në proces dhe 14 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 me titullin akademik Prof. dr., 1 Prof. asoc., dhe 10 me gradën “Dr.” dhe 1 Dr në process dhe 1 Msc si dhe personeli administrative në mbështetje të procesit mësimor 16 (PA)¹⁹⁶.</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 23 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 4 me titull “Prof.asoc.”, 12 me gradën “Dr.” dhe 7 me Msc, dhe 17 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 me titullin akademik Prof asoc., dhe 10 me gradën “Dr.” dhe 4 me Msc, 1 Dr, në proces dhe personeli administrative 18 (PA)¹⁹⁷.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik të Departamentit të Psikologjisë për vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 7 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull “Prof.Asoc.”, 5 me gradën “Dr.” dhe 1 me Msc, dhe 1 pedagogë me kontratë (PAK) me gradën “Dr.” dhe personeli administrative 16 (PA)¹⁹⁸.</p> <p>Ndërsa stafi i angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 7 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull “Prof.As.”, 5 me gradën “Dr.” dhe 1 me Msc, dhe 1 pedagogë me kontratë (PAK) me gradën “Dr.” dhe personeli administrative në mbështetje të procesit mësimor për njësinë bazë 18 (PA)¹⁹⁹.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 për programin e studimit Master Shkencor në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” rezulton i mbuluar 90.3 % nga PAE dhe 10,7% nga PAK²⁰⁰.</p> <p>Ngarkesa e mbuluar përmes personelit akademik efektiv është në masën 90% përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>

¹⁹⁵ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁹⁶ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁹⁷ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁹⁸ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

¹⁹⁹ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²⁰⁰ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë angazhon personelin akademik ndihmës për nevojat e praktikës profesionale dhe projektit kërkimor për mbrojtjen e gradës shkencore. Duke iu referuar të dhënave “Mbi ngarkesën totale të personelit akademik të programit Master i Shkencave në Psikologji në një vit akademik 2020-2021 dhe 2021-2022” rezulton se ky proces mbulohet vetëm nga E. C., staf akademik efektiv i njësisë bazë²⁰¹. Duke iu referuar udhëzuesit të praktikës profesionale²⁰² përcaktohen qartë detyrimet e studentëve dhe të personelit mbikqyrës nga UNYT. Duke iu referuar planit mësimor²⁰³ e kemi të vështirë të kuptojmë sesi është e organizuar në semestër e vit akademik, numrit të orëve në terren, etj.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë bazë të përpilojë në tabelat përmbledhese të planit mësimor konform udhëzimeve lidhur me zërat për çdo aspekt, përfshirë në të orët në auditor/ jashtë tij dhe studimi individual, pedagogët përkatës për mbulimin e praktikës mësimore dhe temave të diplomave sipas profileve përkatëse të realizuara prej saj, sipas direktivave në fuqi, me qëllim që të mund të shprehemi drejt për kriterin në fjalë.</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore në bashkëpunim me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” duhet të zbatojë VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”, dhe sipas Nenit 12, të Statutit të UNYT²⁰⁴, ku sipas propozimit të përgjegjësit të Departamentit duhet të miratojë në rolin e kordinatorit të programit, një anëtarë të stafit akademik i cili duhet të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale në përputhje me objektivat e 3 profileve të tij. Duke iu referuar dokumentacioneve në dispozicion nuk u evidentuan dokumenta që na lejonin të përcaktonim përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë bazë të caktojë një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij sipa 3 profileve.</i></p>

²⁰¹ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²⁰² Evidenca 70. UNYT. Intership Guidelines-Msc,

²⁰³ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²⁰⁴ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" duhet të përfshijnë monitorim të objektivave formuese të programit të lëndës. Roli i koordinatorit lehtëson në aksesin e informacionit për studentët dhe për pedagogun e praktikës në lidhje me terrenet e mundshme të shfrytëzueshme nga studentët e këtij program studimi për praktikën profesionale sipas profileve, por edhe përmes angazhimit të studentëve në një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare të organizuara në rang departamenti apo fakulteti. Koordinator i programit duhet të raportojë në mënyrë periodike tek drejtuesi i njësisë përgjegjëse në lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>Rekomandimet tona si GVJ në lidhje me këtë aspekt parashetrojnë nevojën e dokumentimit të rolit dhe punës së koordinatorit te drejtuesi i njësisë bazë përmes raporteve të shkruara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, si dhe ndërveprojnë së bashku për të përmbushur më së miri detyrimet ligjore që lidhen me ecurinë e tij si në rastin e miratimit të grupit të cilësisë në nivel departamenti, dhe miratimit të grupit të vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi. Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjës të departamentit dhe zyrtarë përkatës të Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë apo zyrtarë ndihmës akademike, mësohet se protokollat e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi</p>

	studimi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Ky program studimit i ciklit të dytë, Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" përgjithësisht është konform rregullores së programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 6.67% (8 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 55 % (66 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinore/Integruese 13 % (16 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS); <p>Departamenti i Psikologjisë ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij dhe kjo konform udhëzimeve të MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë.</p> <p><i>Rekomandohet përfshirja në kurrikulën e programit të studimit dhe të orëve të dedikuara për "Praktikën profesionale" dhe ndarjen e ngarkesës në jave mësimore, si dhe përcaktimin e orëve mësimore në auditor dhe orëve të pavarura të studimit dedikuar "Diplomës".</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë ka një informacion pjesërisht konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarjes në planin mësimor²⁰⁵, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit për pjesën dërrmuese të lëndëve mësimore (tabela 10)²⁰⁶, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademik. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program</p>

²⁰⁵ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²⁰⁶ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

	studimi ²⁰⁷ , në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, etj.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" përgjithësisht respekton kriteret për elementët e structures së programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018)²⁰⁸, duke respektuar numrin e krediteve (120 ECTS) dhe kohëzgjatjen e tij (2 vite akademike) bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe kryesisht një shpërndarje të planit mësimor²⁰⁹, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore²¹⁰, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, si dhe dokumente të tjera^{211, 212, 213}.</p> <p><i>Gjithsesi kërkohet që njësia bazë të angazhohet për të realizuar plotësimin e planit mësimor me të gjithë elementët e nevojshëm konform ligjit në fuqi përta i përket:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimit në planin mësimorë të lëndëve me zgjedhje sipas emërimit të tyre. - Përcaktimin në planin mësimorë të orëve të studimit individual për secilën prej lëndëve mësimore. - Përcaktimin në planin mësimorë të orëve në funksion të praktikës mësimore - Përcaktimin në planin mësimorë të orëve në auditor dhe punë individuale e studentit për temën e diplomës

²⁰⁷ Evidenca 20. Rregullore e programit.

²⁰⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 17-02-2022).

²⁰⁹ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²¹⁰ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²¹¹ Evidenca 106. Student's survey for identification of Master program needs.

²¹² Evidenca 109. Instructors handbook- Alb.

²¹³ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore" ka paqyruar informacionin e nevojshëm që lidhet me ecurinë e studentëve në rregulloren mësimore të programit të studimit²¹⁴, është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit. Në planin e tij mësimor²¹⁵ përgjithësisht janë pasqyruar elementët që përbëjnë këtë program studimi me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësisive të tij monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike²¹⁶, procedurat e ndjekura në pranimin²¹⁷, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve të UNYT²¹⁸.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Veprimtaritë formuese për programin e studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore", të ndara sipas komponentëve mësimore përgjithësisht janë konform ligjit për arsimin e lartë²¹⁹ dhe duke u përpjekur të respektojnë elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Referuar të dhënave të shqyrtuara nga GVJ, përgjithësisht struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit, por gjithsesi disa aspekte janë të nevojshme të përshtaten konform udhëzimeve lidhur me elementët që duhet të përmbajnë.</p> <p><i>Sugjerimet e GVJ për njësinë bazë të angazhohet në vijimësi për të përcaktuar në syllabuset e lëndëve informacion të detajuar për lëndën e "praktikës profesionale" dhe "temën e diplomës" lidhur me orët in auditor dhe punë individuale e studentit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe "Psikologji Ligjore", duhet të jetë objekt monitorimi nga njësi bazë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre, me qëllim</p>

²¹⁴ Evidenca 20. Rregullore e programit.

²¹⁵ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²¹⁶ Evidenca 169. UNYT Foreign Students Guidelines Alb.

²¹⁷ Evidenca 165. UNYT Senate decisions on Admission criteria and quotas 2019.

²¹⁸ Evidenca 42. Politika e Transferimit të Studimeve Alb.

²¹⁹ Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Shqipëri" https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 17-02-2022).

<p>ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë. Duke iu referuar të dhënave që u shqyrtuan nga GVJ, dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion rezulton se gjatë këtyre dy viteve akademike vetëm profili Klinik ka qenë aktiv. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se ngarkesa mësimore mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë në masën 90.1 %. Të dhënat për dokumentacionin e programit si syllabuset e lëndëve, raporti i vlersimit të brendshëm etj, janë të gjitha në anglisht, ashtu sic është dhe gjuha e realizimit të procesit mësimor në këtë master.</p> <p><i>Rekomandohet nga GVJ një angazhim i vazhdueshëm për përmirësimin e kurrikulës në drejtim të përmbajtjes së lëndëve mësimore²²⁰ sipas profileve ashtu sic është emërtuar ky program studimi, gjë e cila paraqet vështirësi në kushtet aktuale bazuar në syllabuset e lëndëve mësimore²²¹ dhe të cv-ve ²²², stafit të angazhuar në këto profile profesional (një pjesë e stafit akademik i përkasin profilit të psikologjisë klinike²²³) ka mungesa që i përkasin fushës së psikologjisë shkollorë-ligjore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit të ciklit të dytë e programit të studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike",</p>

²²⁰Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip..

²²¹ Evidenca 169. UNYT Foreign Students Guidelines Alb.

²²² Evidenca 54. UNYT CV of instructors of Psychology Departmnet.

²²³ Evidence 79. UNYT List of Academic Registred as Practitioners of Clinical Psychology.

<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>“Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”^{224, 225} reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve në 120 ECTS, me 60 kredite për çdo vit akademik, duke respektuar ndarjen e ECTS me nga 30 ECTS në semestër. Kohëzgjatjes normale të tij në 2 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregullores së UNYT.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i këtij programi studimi mund të konsiderohet një sfidë për njësinë bazë përsa i përket mënyrës sesi do të implementohet programi me 3 profile. Problematikat kryesore evidentohen në raport me planin mësimorë i cili nuk mjafton vetëm të jetë i vecantë për cdo profil por edhe i shoqëruar me syllabuset e çdo lënde për secilin prej profileve të këtij programi studimi si dhe stafin akademik të parashikuar për mbulimin e këtyre profileve, të cilat janë jo vetëm të ndryshëm nga njëri-tjetri, por edhe vështirë të hasen në institucione publike në vendin tonë, apo në arenën ndërkombatare. Madje duke iu referuar disa prej organizatave prestigjioze në fushën e psikologjisë, si APA²²⁶, American Psychology and Loë Society²²⁷, dhe Europsy Europsy²²⁸ të cilat japin udhëzime specifike përsa i përket ndarjes së profileve dhe mënyrës sesi duhet të hartohen planet mësimore për cdo profil që të justifikojnë cilësinë dhe zhvillim kompetencash me qëllim përfitimin e njohurive të thelluara teoriko-praktike dhe shprehive sipas profilit përkatës. Profilizimi i programeve të studimit fatkeqësisht shihet si një trend i ri që po merr vrull kryesisht në disa IAL private vetëm në vendin tonë,</p>

²²⁴ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²²⁵ Evidenca 171. UNYT Plani mësimorë I programit Msc. në Psikologji.

²²⁶ American Psychological Association (2022) Divisions of APA.

https://eëë.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706 (Aksesuar më 30.09.2022)

²²⁷ Bottoms, B., Costanzo, M., Greene, E., Redlich, A., Éoolard, J. & Zapf. P. (2004). Careers in Psychology and the Laë: A Guide for Prospective Students. A Publication of the Careers and Training Committee, American Psychology-Laë Society, APA Division 41. <https://eëë.apadivisions.org/division-41/education/students/career-guide.pdf> (Aksesuar më 31.09.2022).

²²⁸ European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec)

<https://eëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3> Èhich professions (Aksesuar më 30.09.2022)

	<p>trend i cili mund të rrezikojë cilësinë dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë të tregojnë kujdes dhe të monitorojnë ofertën e tyre formative më qëllim që të jetë brenda standarteve lidhur me zhvillimin e kompetencave të studentëve por edhe në linjë me programet e institucioneve ndërkombëtare. Kryesisht ato Amerike, nisur edhe nga bashkëpunimi i vazhdueshëm që UNYT ka me State University of New York/ Empire State College (SUNY)/ESC me qëllim zhvillimin e programeve në bashkëpunim dhe marrjen e diplomës së dyfishtë, konform standarteve ndërkombëtare dhe bërjen sa më kompetitive në treg të një oferte formative të konsoliduar dhe lehtësisht të realizueshme bazuar në burimet njerëzore në dispozicion, për zhvillimin e këtij programi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Stafi akademik, referuar lëndëve dhe moduleve, është përpjekur të integrojë në syllabus njohuri për 3 profile, që zhvillohen në një program studimi të ciklit të dytë Msc në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkolllore" dhe "Psikologji Ligjore"²²⁹. Kjo situatë duket se ka vënë në vështirësi njësinë bazë dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie, që të synojë përfshirjen brenda syllabusit²³⁰ të njohurive të cilat prekin të 3 profilet, dhe kjo ndoshta ka rezultuar me rrisht të dajles herë pas here nga tipologjia e lëndës dhe shoqëruar me pamundësi për t'u thelluar në njohuri dhe shprehje në linjë me profilin. Duke iu referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe takimeve me stafin dhe përfaqësues të njësisë, syllabuset, janë vënë në dispozicion vetëm për një profil, duke qenë se vetëm ky profil po zhvillohet. Ndërkohë që 2 profilet e tjera nuk kanë syllabuse të vecanta. Kjo situatë shihet e paqartë në mënyrën sesi institucioni do t'i përgjigjet në kohë një kërkese nga grupet mësimore që mund t'i përkasin profilit ligjor dhe shkollor, duke qenë se parashikimet dhe syllabuset janë hartuar dhe ofrohen vetëm për profilin klinik, që sipas argumentit nga përfaqësuesit e UNYT, të dhënë gjatë vizitës në institucion, kjo sepse vetëm ky profil ka pasur interes dhe është aktivizuar. Elementët e tjerë të planit mësimor²³¹ përgjithësisht janë në linjë me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të</p>

²²⁹ Evidenca 8. UNYT Plani mësimor i programit Msc në Psikologji V 2020-2021.

²³⁰ Evidenca 55. UNYT Syllabet shqip..

²³¹ Evidenca 171. UNYT Plani mësimorë I programit Msc. në Psikologji.

	<p>ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, respekton standartet për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 2 viteve akademike. Një balancë e ngjashme respektohet edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë²³² dhe udhëzimeve ndihmës të vet UNYT²³³ me qëllim që të respektohen elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite.</p> <p><i>Rekomandimet tona për këtë kriter lidhet me nevojën që duhet të parashtrijnë anëtarët e njësisë lidhur me mënyrën sesi duan të vijojnë ta zhvillojnë këtë program studimi, pas një periudhe 2 vjecare të testimit të ofertës formative në treg.</i></p> <p><i>Nëse kjo ofertë formative shihet e përshtatshme atëherë sugjerohet njësia bazë të hartojë syllabuset mësimore për secilin prej profileve dhe të parashikojë staf akademik që zotëron njohuri dhe kualifikime për të përmbushur nevojat e programit për arsim cilësor, të ndihmojnë studentët të zhvillojnë njohuri dhe kompetenca në linjë me profilin, që diploma e tyre të ketë një vizibilitet më të madh në tregun e punës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollorë" dhe "Psikologji Ligjore", lëndët, dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, përgjithësisht është në përputhje me profilin e psikologjisë klinike, edhe pse kjo linjë herë pas here vështirësohet nga nevoja për të përfshirë lëndë që justifikojnë profilet e tjera. Por kryesisht struktura ka një linjë mbizotëruese të profilit klinik, kjo duke u përpjekur të jetë në linjë me përcaktimet ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/</p>

²³² Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri" https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 17-02-2022)..

²³³ Evidenca 209UNYT Teaching and learning strategy, Alb.

integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse.

- Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 6.67% (8 ECTS);
- Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 55 % (66 ECTS);
- Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 13 % (16 ECTS);
- Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS);
- Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS);

Ndërsa lidhur me ngjashmëritë me programe të tjera ndërkombëtare, mund të themi se përtej realitetit të disa IAL-ve private në vendin tonë, nuk mund të gjenden në asnjë institucion të arsimit të lartë ndërkombëtar programe studimi të ciklit të dytë, me profile kaq të ndryshme nga njëri-tjetri brenda një masteri bazuar në hulumtimet ndërkombëtare (APA²³⁴, American Psychology and Low Society²³⁵, National Association of School Psychologists (NASP)²³⁶, dhe Europsy)²³⁷. Kjo ofertë formative mund të jetë atraktive për financat e institucionit që e ofron, duke i mundësuar tërheqjen e një numri më të madh të interesuarish për profile të ndryshme, por gjykojmë se nuk krijon kushte për zhvillim të njohurive dhe kompetencave në linjë me profilet. Gjasat janë që të shndërrohet në një sfidë të vazhdueshme për njësinë e cila duhet të përpiket të rekrutojë staf në linjë me profilet, por dhe për pedagogët të cilët duhet të sforcohen të përafrojnë njohuritë me profilet dhe t'i përmbledhin në një syllabus.

Rekomandohet institucioni të orientohet në një proces diskutimi brenda njësisë lidhur me fokusin që duan t'i japin këtij programi studimi, pasuar me masat e nevojshme që justifikojnë ofertën formative të miratuar dhe të ofruar në linjë me standartet e

²³⁴ (2022) Divisions of APA. https://www.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706 (Aksesuar më 30.09.2022)

²³⁵ Bottoms, B., Costanzo, M., Greene, E., Redlich, A., Eoolard, J. & Zapf, P. (2004). Careers in Psychology and the Laë: A Guide for Prospective Students. A Publication of the Careers and Training Committee, American Psychology-Laë Society, APA Division 41. <https://www.apadivisions.org/division-41/education/students/career-guide.pdf> (Aksesuar më 31.09.2022).

²³⁶ National Association of School Psychologists. (2022). Graduate Program Approval and Accreditation. <https://www.nasponline.org/standards-and-certification/graduate-program-approval-and-accreditation> (Aksesuar më 09.09.2022)

²³⁷ European Certificate in Psychology. (2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec) <https://www.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3> *Ëhich professions* (Aksesuar më 30.09.2022)

	<p><i>cilësisë së American Psychology and Law Society²³⁸, National Association of School Psychologists²³⁹ dhe American Psychological Association²⁴⁰; kjo në linjë edhe me bashkëpunimin e hershëm insitucional që UNYT ka me State University of New York/ Empire State College (SUNY)/ESC në SHBA.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi ka një përpjekje në lidhje me elementët që synon të zhvillojë te studenti në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e psikologut klinik. Gjithashtu, programi përfshin element mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë psikologun klinik të realizojë detyrën e tij të ofrimit të shërbimeve psikologjike në mënyrë profesionale në kontekste të ndryshme profesionale. Mbështetur në disa elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij sipas veprimtarive formuese, raportit teori-praktikë, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve gjykojmë se programi i pasqyron për profilin klinik. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimorë, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlersimin e dijeve dhe një sërë akvitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët.</p> <p><i>GJV sugjeron njësinë të rivlersojë mundësinë e përmirësimit ose konsolidimit të ofertës formative sipas një linje punë që është më afër realizimit të saj, bazuar në burimet njerëzore në dispozicion duke lehtësuar stafin akademik në ndërtimin dhe implementimin e një programi lëndor në linjë me fushën e ekspertizës dhe kompetencave profesionale të tyre.</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/moduleve) përditësohen në</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar mund të parashtrijmë se programi i studimit Msc. në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollore" dhe</p>

²³⁸ Bottoms, B., Costanzo, M., Greene, E., Redlich, A., Eoolard, J. & Zapf. P. (2004). Careers in Psychology and the Laë: A Guide for Prospective Students. A Publication of the Careers and Training Committee, American Psychology-Laë Society, APA Division 41. <https://ëëë.apadivisions.org/division-41/education/students/career-guide.pdf> (Aksesuar më 31.09.2022).

²³⁹ National Association of School Psychologists (2010). Standards for Graduate Preparation of School Psychologists 2010 file:///C:/Users/User/Downloads/1_Graduate_Preparation.pdf. (Aksesuar më 09.09.2022).

²⁴⁰ American Psychological Association & APA Office of Program Consultation and Accreditation. (2006). Guidelines and Principles for Accreditation of Programs in Professional Psychology (G&P). Retrieved from <http://ëëë.apa.org/ed/accreditation/about/policies/guiding-principles.pdf>

<p>mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>“Psikologji Ligjore” duhet të jetë gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore²⁴¹ çdo vit akademik dhe monitorimit me kujdes e miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Duke qenë një program i ri studimi, mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në profilin e zgjedhur.</p> <p>Në linjë me profilizimin, <i>GVJ sugjeron që pedagogët që mbulojnë lëndët karakterizuese të programit, të tregojnë kujdes në përzgjedhjen e literaturës së detyruar me tekste akademike, si dhe të parashtrajnë në këto tekste një nivel të avancuar njohurish që u lejon studentëve të avancojnë në dijet e tyre. Një kujdes të veçantë duhet të tregohet nga staf akademik që të mos trajtojnë të njëjtat aspekte që mund të jetë jenë trajtuar edhe në programin Bachelor në Psikologji.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në mënyrën e ndërtimit të moduleve/lëndëve, duhet t’u jepet mundësi studentëve për fitimin e shprehive shkencore dhe profesionale sipas tre profileve që përbëjnë ofertën formative të UNYT. Një sërë aktiviteteish të formimit teorik dhe praktik duhet të fokusohen në hapsirat e nevojshme për të përkthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë psikologut shkollor, ligjor dhe klinik të zhvillojë disa kompetenca profesionale të lidhura me procesin e vlerësimit dhe të ndërhyrjes psikologjike, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. Megjithatë ky element duhet parë në kontekstin global, pasi personeli akademik në një pjesë të rasteve, referuar syllabuseve të lëndëve mësimore²⁴² ndodhet nën “presion” për të përfshirë brenda tij njohuri për secilin profil duke e larguar padashje nga tipologjia e lëndës që mbulon. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimor të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë. Referuar syllabuseve, lënda “Bazat biologjike të sjelljes” në temat e trajtuar duket se ka gjasa të përsëris njohuritë e marra në nivelin Bachelor në lëndë si “Biologjia Humane”, “Truri dhe Sjellja” dhe “Hyrje në të mësuar dhe Kognicion” bazuar në temat mësimore të trajtuara, tema 2 “Origjina e trurit</p>

²⁴¹Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

²⁴²Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

dhe sjellja njerëzore”, tema 3 “Organizimi i sistemit nervor”, tema 4 “Biopsikologjia e emocioneve”, tema 5 “Bazat biologjike të agresionit”, tema 6 “Organizimi i sistemit ndijor dhe mororik”, tema 9 “Baza biologjike e zhvillimit të gjuhës, prodhimit dhe mësimin”, tema 10 “Bazat biologjike të të menduarit dhe të nxënimit”²⁴³. Përpjekja për të integruar informacion të tipologjive të ndryshme për një nivel bazik njohurish nuk përmbush nevojat për nivel të zhvilluar njohurish që i përshtaten programit master.

Lënda “Rritja e njeriut dhe zhvillimi” ka në fokus tema të psikologjisë së zhvillimit që përfshijnë periudhën nga lindja deri në vdekje”.

Lënda “Testimi dhe matja psikologjike”, ka ndajren e temave sipas javëve mësimore duke i referuar specifikave leksion/seminare që i dedikohen një teme. Udhëzimet dhe rregullat për hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore bazuar në rregullat në fuqi, parashikojnë rreth 15 tema mësimore të trajtuara, që çdo javë mësimore ka në fokus dhënien e njohurive të reja dhe ndërthurjen e këtyre njohurive me veprimtari praktike përgjatë orëve të seminarit apo mund të integrohen sëbashku dhe të ndërthuren veprimtaritë e leksion/seminar sipas mënyrës së përzgjedhur nga lektori. Bazuar në lëndën në fjalë, tema mësimore nr 3 “Aplikimi Teknika e intervistës dhe aplikim” dhe java 4 “Lojë me role”, java 5 “Prezantim detyrash”, java 7, Aplikimi në mjediset klinike dhe dhe këshillimore”, java 9 “Vlerësimi klinik dhe këshillimi” java 10 “Përsëritje dhe raste studimore” dhe java e 12 “Dorëzim i detyrave dhe raste studimore”, rezulton se mbulimi i orëve të didikuara leksionit me veprimtari praktike, nuk krijojnë kushte për realizimin e objektivave të lëndës.

Lënda “Psikopatologji e avancuar” ka në brendi 6 tema mësimore, të cilat fokusohen te çrregullimet neuro-zhvillimore dhe vijojnë me çrregullimet e humorit, skizofreninë, çrregullimet e ankthit, ato disociative-somatike dhe mbyllet me çrregullimet e personalitetit. Më pas kalon në bazën teorike që shpjegon psikopatologjitë, shkaqet, etimologjinë diagnozën e prognozën nga tema 8 deri te tema 10, më pas kemi një detyrë kërkimore në temën 11, dhe vijon me trajtimin e psikopatologjive në temat 12-13, dhe përmbyllet me detyrë kërkimore në temat 14-15.

²⁴³Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip..



Përgjithësisht duke i referuar Manualit të çrregullimeve të shëndetit mendor (DSM-IV e revizionuar/ apo edicioneve të fundit), për çdo çrregullim jepen kriteret, flitet për diagnozën diferenciale, prognozën etj, madje përfshihen edhe aspekte që lidhen me diferencat kulturore kur vlerësojmë një çrregullim të shëndetit mendor, që një klinikist duhet t'i ketë në konsideratë kur bën evidentimin dhe vlerësimin e problematikës që i është paraqitur. Ndarja e temave mësimore në pjesë ku fillimisht përshkruar çrregullimet dhe më pas flet për teoritë që i shpjegojnë ato, me më pas trajtimin, ky i papërcaktuar se për çfarë është ky trajtim, duken të vështira për t'u kuptuar sesi mund të ndihmojnë studentët të avancojnë në një drejtim të caktuar profesional.

Lënda “Vlerësimi psikologjik” ka një fokus në temën mësimore 3 “Çrregullimi i ankthit social”, tema 4 “Çrregullimi i ankthit të përgjithshëm”, tema 5 “Çrregullimi obsesiv-kompulsiv”, tema 6 “Stresi post-traumatik”, tema 7 “Depresioni (çrregullimet e humorit)”, tema 8 “Çrregullimi i personalitetit” etj.

Lënda “Zhvillimi social dhe i personalitetit” temat fokusohen në “Hyrje në zhvillimin social dhe të personalitetit të fëmijëve”, “Prespektiva teorike për zhvillimin e personalitetit”, “Ndryshimet në jetë, kërkesat /nevojat , ndërveprimi social dhe zhvillimi i personalitetit”, “Temperamenti dhe zhvillimi social i fëmijës”, pastaj tema 5 “Zhvillimi social-emocional dhe personalitetit në foshnjëri, marrëdhënia prind-fëmijë dhe atashimi”, tema 6 “Vetja dhe të tjerët, marrëdhëniet e ngushta dhe zhvillimi social i fëmijës” tema 8 “ Impakti social, biologjik dhe përfaqësimet e fëmijëve në botë, vet-zhvillimi”, vijon me temat 10,11,12, 13 fokusohen tek “Zhvillimi i personalitetit”, Aftësitë e marrjes së rolit”, “Sjellja prosociale” dhe “Zhvillimi i roleve gjinore”.

Lënda “Trajtimi Psikologjik; Teori dhe aftësi” ka në lloj konfuzioni lidhur me temat mësimore në brendësi të saj, të cilat nuk i përgjigjen plotësisht tipologjisë së lëndës duke filluar me temën 1 “Trajtimi psikologjik”, tema 2 ‘Këshillimi psikologjik”, 3” Psikoterapia”, 4 “Këshilluesi/ Psikoterapist” etj.

Lënda “Kognicioni human dhe të mësuarit” duket se disa tema që duhet t'i ketë në fokus, duke qenë brenda tipologjisë së saj, janë trajtuar edhe në lëndë të tjera si “Bazat biologjike të sjelljes”. Duke iu referuar një pjese të syllabuseve që nuk janë cituar

	<p>specifikisht evidentohen pjesërisht të njëjtat problematika lidhur me mënyrën e organizimit të temave mësimore pa koherencë dhe linjë me njëra-tjetrën, në disa raste njohuritë e shpalosura në program duken për një nivel bazik njohurish, tema që trajtohen e ritrajtohen nga lektorë të ndryshëm bazur në literaturë të ndryshme për të njëjtët studentë mund të krijojë një sër handikapesh përsa i përket garantimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë. Duhet theksuar se litaratura e përdorur përgjithësisht është e përshtatshme për tipologjinë e lëndëve, por mënyra e organizimit të saj dhe veç të tjerash mospërmbajtja e linjës së tekstit të përdorur mund të ketë nxitur këtë situatë.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë bazë të rishohë përsëritjen e mbivendosjen e disa temave mësimore në disa nga lëndët mësimore si 'Testimi dhe matja psikologjike' me lëndën 'Vlerësimi psikologjik'; apo lënda 'Psikopatologji e avancuar' me lëndën 'Strategji të aplikuara dhe teknikat e Psikoterapisë'.</i></p> <p><i>Sugjerojmë njësinë bazë që programet mësimore të lëndëve të hartohen nga titullarë që i përkasin kategorisë "Profesor", kanë arsimimin dhe kualifikimet e duhura për profilin për të cilin hartojnë syllabusin dhe kanë përvojën dhe njohuritë për të hartuar një program lëndor në linjë me tipologjinë e lëndëve të veçanta sipas profileve, për të cilat ofrohet ky program.</i></p> <p><i>Një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore;</i></p> <p><i>Vëmëndje më e shtuar në përfshirjen e temave mësimore dhe koordinimin e tyre me një literature të përshtatshme për objektivat e lëndës mësimore, do të përmirësonte cilësinë në mësimnxënie dhe njohjen e këtij roli në një mënyrë më të konsoliduar nga ana e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit përgjithësisht mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe kriterëve për licensimin e psikologëve sipas Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Nëse i referohemi planit</p>




	<p>mësimor²⁴⁴ duhet të kemi një ndarje të balancuar midis veprimtarive formuese, të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij. Këto veprimtari duhet të kenë balancim të aspektit teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale gjithashtu duhet të mbështesë nevojat e programit shkencor për zhvillim kompetencash dhe aftësish për të gjetur veten në tregun e punës. Nëse i referohemi lëndëve mësimore ka disa lëndë, të cilat për nga emërtimi duket se rrisin mundësitë për dublim njohurish, pasi janë shumë të përafërta midis tyre. I referohemi syllabuseve dhe përmbajtjes së tyre për lëndët:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- “Strategjitë dhe Teknikat e Aplikuara të Psikoterapisë”, dhe “Trajtimi Psikologjik: Teori dhe Aftësi“, “Psikopatologji e Avancuar” 2- “Konjicioni Human dhe të Mësuarit”, dhe “Zhvillimi Social dhe i Personalitetit”, 3- “Vleresimi Psikologjik” dhe “Testimi dhe Matja Psikologjike” <p><i>Tipologjia e lëndës në emërtim dhe përmbajtja e lëndës duhet të jenë objekt diskutimesh dhe konsultash të herëpashërshme me qëllim të shmangjes së mbivendosjes së njohurive.</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Ky program studimi duhet t'i përgjegjet nevojave aktuale të vendit, por edhe nevojave të tregut kombëtarë përsa i përket profesionistëve që ofrojnë shërbime psikologjike në kontekste të ndryshme profesionale në fushën e psikologjisë. Dinamikat e zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve, problematikat që bashkëshoqërojnë procesin e zhvillimit në moshë të rritur janë tepër komplekse dhe të ndërlydhura. Kjo gjë kërkon profesionistë të kualifikuar, të cilët kanë kompetenca shkencore dhe profesionale për ndërhyrje në kontekstin klinik, shkollor dhe ligjor, për të realizuar procesin e vlersimit psikologjik, evidentimin e problemeve të shëndetit mendor dhe ndërtimin e një plani ndërhyrje që lejon marrësit e shërbimit të përmirësojnë cilësisht jetën personale, sociale dhe akademike. Nga vizita në institucion vlerësojmë si pozitive konsultimin me urdhrin e psikologut në lidhje me njohjen e këtij programi bazuar në emërtim, por kjo nismë nuk mjafton për përmirësimin e</p>

²⁴⁴ Evidenca 171. UNYT Plani mësimorë i programit Msc. në Psikologji.




	<p>përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>Duke mos pasur evidence të qarta në këtë drejtim bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar GVJ rekomandon aktivizimin e strukturave të bordit të punës me qëllim që të mbështesin programin e studimit me ide dhe propozime. Gjithshtu, një ndihmë të madhe mund të japin e konsultimet publike me studentë dhe profesionistë të grupeve profesionale të psikologëve shkollorë, ligjor dhe klinik.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi i ciklit të dytë, Master Shkencor në "Psikologji" me profile në "Psikologji Klinike", "Psikologji Shkollorë" dhe "Psikologji Ligjorë" bazuar në veprimtaritë praktike të ndërthura në lëndë të ndryshme u jep mundësi studentëve të njihen me aspekte të kërkimit shkencorë përmes detyrave të kursit me karakter aplikativ dhe analizave bibliografike bazuar në shqyrtim literature që realizohen si pjesë e lëndëve të veçanta. Gjithashtu, një sërë lëndësh janë në funksion të zhvillimit të njohurive lidhur me njohuri në drejtim të studimeve e kërkimeve shkencore. Këto aspekte krijojnë mundësi për vijimin e zhvillimit të kompetencave shkencore në analizën, ndërhyrjen dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kontekstin e psikologjisë. Ndërthurja e njohurive dhe shprehive të kërkimit shkencor që synohen të përvetësohen përmes programit të studimit do t'i ndihmojë studentët të zotërojnë asetet e nevojshme për avancimin në drejtim të kërkimit shkencor si dhe do të lejojnë studentët të vijojnë studimet në ciklin e tretë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi II.5</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë përgjithësisht bazuar te CV-të²⁴⁵ e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi përmbush rekomandimet e BA për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik të Departamentit të Psikologjisë për vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 7 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull “Prof.As.”, 5 me gradën “Dr.” dhe 1 me Msc, dhe 1 pedagogë me kontratë (PAK) me gradën “Dr.”²⁴⁶.</p> <p>Ndërsa stafi i angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 7 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull “Prof.As.”, 5 me gradën “Dr.” dhe 1 me Msc, dhe 1 pedagogë me kontratë (PAK) me gradën “Dr.”²⁴⁷.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 për programin e studimit rezulton i mbuluar 90.3 % nga PAE dhe 10,7% nga PAK²⁴⁸.</p> <p>Ngarkesa e mbuluar përmes personelit akademik efektiv është në masën 90%, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në të dhënave që kemi mbi edukimin dhe kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të thuhet se përmbushen standartet referuar titujve dhe gradave²⁴⁹, edhe pse sugjerohet të kihet parasysh vijimësia e arsimimit të tyre brenda profilit të psikologjisë shkollore dhe ligjore, kur këto dy profile të aktivizohen. Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor për vitin akademik 2020-2021 na është vënë në dispozicion dhe referuar realizimit të këtij programi studimi stafi akademik ka kualifikimin e duhur në lidhje me gradat dhe titujt akademik.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të Personelit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për 2020-2021, 100% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik;

²⁴⁵ Evidenca 54. UNYT CV of instructors of Psychology Deparmnet.

²⁴⁶ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²⁴⁷ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²⁴⁸ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²⁴⁹ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

	- Për 2021-2022, 100% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik;
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Bazuar në dokumentacionin që lidhet me CV-të e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ²⁵⁰ rezultojnë se nga 5 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënie në këtë program, (4) janë me profil klinik (E. C.; B. L.; S. Dh., A. H.,) ²⁵¹ ndërsa A. C., me profil shkollor-organizacional, ndërsa 1 (PAK) mban gradën Dr. Ky program studimi ka pasur aktiv përgjatë këtyre dy viteve vetëm profilin klinik, i cili mbulohet nga lektorë që janë në përshtatje me profilin në të cilin japin mësim, atë klinik, duke qenë se vetëm ky profil është aktivizuar përgjatë këtyre dy viteve akademike.
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni në funksion të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit janë vënë në dispozicion stafi akademik, një sërë marrëveshesh bashkëpunimi institucional ²⁵² , ²⁵³ që janë në funksion të praktikës profesionale. Këto marrëveshje janë me disa institucione si “Deloitte Group”, “Ministria e Brendshme”, “Boga Associates”, “Eagles Group Albania”, “Neptun Albania”, “Lufthansa Albania”, “Duapune”, “GIZ-ALBANIA”, “Albtelecom”, “Smartëork” etj. Duke iu referuar listës së marrëveshjeve në funksion të praktikës profesionale nuk kemi evidencë lidhur me marrëveshjet dhe mënyra sesi janë përcaktuar kushtet e bashkëpunimit dhe afatet e vlefshmërisë kohore. Bazuar në këto marrëveshje gjykojmë se pjesa më e madhe e tyre nuk iu përshtaten nevojave të studentëve të fushës së psikologjisë dhe profileve ligjore, shkollore e klinike. Por si kyçe për profilin e psikologut mund të konsiderohen institucionet si “Linja e këshillimit për gra dhe vajza”, “Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, “Bashkia Tiranë” dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione të specializuara në fushën e psikologjisë u japin mundësi studentëve të zhvillojnë

²⁵⁰ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

²⁵¹ Evidence 79. UNYT List of Academic Registered as Practitioners of Clinical Psychology.

²⁵² Evidenca 23. UNYT List of Agreements and MoUs Career Office.

²⁵³ Evidenca 53. Tabelat Përmbledhëse për aneks- RVB.

	<p>praktikën profesionale pranë qendrave që kanë shërbim psikologjik dhe psikologë klinik në organikën e tyre. Në këtë mënyrë krijohen kushtet që studentët të përfitojë nga përvoja dhe profesionalizmi i profesionistëve të terrenit.</p> <p><i>Sugjerimet tona si GVJ, për njësinë bazë lidhen me përpjekjen për të përfshirë sa më shumë institucione që i përshtaten profileve përkatëse si atij klinik që tashmë është aktiv, por edhe profilit shkollor dhe ligjor duke qenë se të dy këto profile janë pjesë e ofertës formative të UNYT.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Duke u bazuar në strukturën akademike dhe ndihmës akademike dhe të infrastrukturës në shërbim të këtij programi²⁵⁴, gjejkojmë se UNYT plotëson më së miri nevojat e studentëve të këtij programi studimi. Në lidhje me këtë kriter disa evidenca garantojnë angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion komunikimi me stafin e pranishëm në takim na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjës për infrastrukturë dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e	Njësia bazë që ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollorë” dhe “Psikologji Ligjorë” duhet të konsultohet dhe mbështetet në përmirësimin e këtij program studimi dhe në

²⁵⁴ Evidenca 53. Tabelat Përmbledhëse për aneks- RVB.

<p>punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>përshtatjen e tij me kërkesat e tregur të punës përmes bashkëpunimit të vazhduar me bashkëpunorë dhe partner nga tregu i punës me të cilat UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar. Kjo praktikë do të konsiderohej me ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij program studimi, nëse do të shfrytëzohej më mirë nga njësia bazë, por gjithsesi duke qenë një program i ri, këto aspekte duhen parë në kohë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë, bazuar në procedurat dhe politikat për zhvillimin e kurrikulës parashikon konsultime me grupet e punës, komitete, komisione të posacme në nivel njësie bazë dhe kryesore, përfaqësues të unionit studentor dhe komiteteve profesionale, me qëllim monitoron në vijimësi të këtij program studimi²⁵⁵. Në takimet me drejtuesen e njëzisë bazë, GVJ u informua se njësia bazë kryen vlersime periodike të stafit të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi²⁵⁶. Njësia bazë realizon monitorim përmes pyetësorëve me student në lidhje me lëndën dhe pedagogët²⁵⁷, për mënyrën e realizimit të programit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat UNYT ka një marrëveshje. Këto nisma duhet të ndihmojnë në evidentimin e çështjeve kryesore që shqetësojnë palët e ndryshme të përfshira si studentët, stafin akademik apo strukturat e tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Përmes Zyrës së Karrierës²⁵⁸ bazuar në rregulloren e saj²⁵⁹ dhe këshilluesit akademik²⁶⁰ institucioni ka marrë një pozicion aktiv në drejtim të vijimit të zhvillimit të kompetencave të studentëve dhe ish-studentëve të tij, dhe shfrytëzimin e këtyre burimeve njerëzore për nevojat e veta institucionale. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Të gjitha këto struktura dhe nisma konsiderohen me ndikim pozitiv për mbështetjen e alumnit. Gjithsesi, nuk kemi evidenca që na lejojnë të vlerësojmë sesa merren në konsideratë sugjerimet e Alumni në drejtim të përmirësimit të këtij program studimi.</p>

²⁵⁵ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

²⁵⁶ Evidenca 186. UNYT Peer Evaluation Template

²⁵⁷ Evidenca 194. Student evaluation form.

²⁵⁸ Evidenca 177. UNYT Career Office Working plan 2021-2022


²⁵⁹ Evidenca.176. UNYT Rregullore e zyrës së karrierës Alb.

²⁶⁰ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni ka realizuar një sër veprimtarish kërkimore- shkencore me qëllim avancimin e njohurive dhe dijeve për fushat e tij të interesit. Bazuar në realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare për vitin 2020-2022, kemi praninë e një sër aktiviteteve si trajnime, workshop-ve apo vizitave të realizuara me institucione publike e private kombëtare, organizimin e konferenca e leksione të hapura. Këto aktivitete janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit institucional që UNYT ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit e shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore në drejtim të fushave të tij të interesit. Përsa i përket këtij program studimi duke qenë një program që pritet të akreditohet për herë të parë, këto aspekte siç janë vetë procesi i akreditimit e të tjera mund të shërbejnë si shtysë e mirë për riorganizimin e programeve të posaçme sipas fushave specifike të interesit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” bazuar në rregulloren e programit të studimit²⁶¹ përkaton 3 objektiva kryesorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përgatisë psikologë që kanë njohuri dhe aftësi të thelluara mbi aspektet sociale, emocionale, mendore, zhvillimore të psikopatologjisë njerëzore dhe të trajtimit të çështjeve të lidhura me shëndetin mendor. 2. Të përgatisë psikologë që do të jenë profesionistë të aftë dhe të sukseshëm në komunikim e bashkëpunim si dhe do të synojnë rritje personale e profesionale të vazhdueshme dhe të pandërprerë

²⁶¹ Evidenca 20. UNYT Rregullore e programit.

	<p>3. Të përgatisë profesionistë që janë jo vetëm konsumatorë të mirëinformuar të studimeve shkencave por dhe prodhues të ardhshëm të tyre.</p> <p>Ky program studimi u jep mundësi studentëve të avancojnë në drejtim të kualifikimeve të tyre në ciklin e tretë të studimit pas përmbylljes së këtij program studimi. Gjithashtu, referuar edhe vizionit të masterit, objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit duke kanalizuar profilin e psikologut në një shumëllojshmëri rolesh profesionale brenda kontekstit klinik, shkollorë dhe ligjor.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë nxit dhe ka një rol aktiv në drejtim të bashkërendimit dhe administrimit të veprimtarive në mësimdhënie^{262, 263}. Në këtë aspekt janë ndërmarrë një sër nismash që kanë ndikim pozitiv si në zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik por edhe tek studentët²⁶⁴ e këtij program studimit. Nga evidencat shihen shëmbuj të mirë të mbështetjes së stafit akademik në pjesmarrje në veprimtari kërkimore shkencore, studentëve^{265, 266}, projekte kombëtare e ndër -kombëtare^{267, 268}. Mënyra e realizimit të procesit mësimor dhe autonomia që secili pedagog ka në drejtim të realizimit të programit mësimor kryhen duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë i mundëson studentëve të angazhohen në veprimtari që nxisin mendimin kritik dhe refleksionin personal mbi çështje e fenomene që evidentohen në kontekstin klinik. Gjithashtu, vlen të theksohet se lëndë të veçanta kanë të përfshira edhe detyrat e kursit, në të cilat studentët fillojnë të zhvillojnë aftësi në drejtim të hulumtimeve që bazohen te shqyrtimi i literaturës. Konferencat, trajnimet, projektet kombëtare dhe ndërkombëtare shërbejnë si mjet për nxitjen dhe motivimin e studentëve të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore²⁶⁹. Duke iu referuar të dhënave kemi një sër evidencash që mbështesin këtë aspekt si pjesmarrja e studentëve</p>

²⁶² Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

²⁶³ Evidenca 59. UNYT Peer review process Msc program Psychology

²⁶⁴ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

²⁶⁵ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

²⁶⁶ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

²⁶⁷ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

²⁶⁸ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

²⁶⁹ Evidenca 202. UNYT EQAF – Student engagement Contribution QA Training.




	në konferenca të ndryshme studentore ^{270, 271} trajnime ²⁷² , projekte të fituara dhe të zbatuara në nivel institucional ²⁷³ , etj.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Bazuar në angazhimet e stafit akademik dhe të UNYT përmes “European and Balkan Research Institute Center”, i cili ka nën varësi 3 qendra me fokus në përthithjen dhe implementimin e projekteve kombëtare e ndërkombëtarë sipas fushave të kërkimit shkencor “Research, Project and Innovation Center”, “Balkan Research Center” dhe “European Research Center” ²⁷⁴ . Ky institut ka implementuar një sër projektesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ²⁷⁵ . Në realizimin e këtyre projekteve janë përfshirë pedagogë të njësisë kryesore dhe bazë, gjithashtu edhe studentët. Departamenti i Psikologjisë është angazhuar dhe ka aplikuar në projekte të ndryshme, anëtar të stafit akademik janë angazhuar në “Research, Project and Innovation Center”. Vlerësojmë se këto janë elementë që ndikojnë pozitivisht në drejtim të plotësismit të këtij kriteri.			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë dhe strukturat e tjera janë partner në një sër projektesh si Erasmus + dhe Mevlana ²⁷⁶ , përmes të cilit krijohen mundësi për shkëmbim të praktikave të mira në trajnime, leksione të hapura, mobilitete në mësimdhëne për stafin akademik ^{277, 278} të ardhurat nga aktivitete të ndryshme sic janë projektet në të cilat janë pjesë ²⁷⁹ . Gjithashtu institucioni mbështetet stafin akademik për publikime shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtar e pjesmarrje në konferenca shkencore sipas informacioneve të marra gjatë takimit me stafin dhe drejtues të UNYT, evidenca në lidhje me financime konkrete nuk kemi hasur.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁷⁰ Evidenca 87. K. Krasniqi. Certificate research first international students conference.

²⁷¹ Evidenca 82. UNYT revieëer in the international students congress organized from IBI.

²⁷² Evidenca 202. UNYT EQAF – Student engagement Contribution QA Training.

²⁷³ Project and research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 09.09.2022).

²⁷⁴ Academic Staff. <https://unyt.edu.al/index.php/faculty/> (Aksesuar më 04.09.2022)

²⁷⁵ Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

²⁷⁶ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

²⁷⁷ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

²⁷⁸ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

²⁷⁹ Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni mbështet grupet lëndore përmes aktiviteteve ekstra - kurrikulare promovuese të realizuar në si leksione të hapura, ëorkshop, konferenca dhe projektet kërkimore të reja siguron bashkëpunimin ²⁸⁰ me struktura të tjera kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare ^{281, 282} për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor ²⁸³ . Përfshirja e stafit akademik në këto projekte ka një impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit të kompetencave profesionale në drejtim të mësimdhënies dhe të avancimit në kërkim shkencor. Një sërë nismash në këtë drejtim krijojnë mundësi për mobilitetet dhe shkembime të stafit dhe studentëve ²⁸⁴ .
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Përfshirja e stafit akademik ^{285, 286} dhe studentëve të njësisë bazë në një sër projektesh e studimesh me karakter kërkimor shkencor zhvillon dijet dhe kompetencat profesionale të tyre. Projekte të cilat janë në zbatim (1 projekt) apo të përfunduar (5 projekte) ²⁸⁷ ku është angazhuar stafi akademik i UNYT dhe studentët e tij. Përfitimi i institucionit nga përfshirja në realizimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare ²⁸⁸ , është me impakt për studentët e stafin akademik.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të	Një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare janë organizuar nga Departamenti i Psikologjisë ^{289, 290} dhe strukturat e tjera të UNYT në bashkëpunim me institucione dhe profesionist të lirë ²⁹¹ si Jaen Monnet Modules, Jaen Monnet Network, etj. Ndër to mund të

²⁸⁰ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

²⁸¹ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

²⁸² Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

²⁸³ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

²⁸⁴ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

²⁸⁵ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

²⁸⁶ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

²⁸⁷ Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

²⁸⁸ Project and research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 09.09.2022).

²⁸⁹ Evidenca 61. UNYT Study visit Autism center.

²⁹⁰ Evidenca 62. UNYT Study visit on psychological testing at Municipality of Tirana (Zyra e karrierës).

²⁹¹ Conference. <https://unyt.edu.al/index.php/tag/conference/> (Aksesuar më 09.09.2022)

cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	përfshijmë leksione të hapura me lektor të ftuar, të huaj e vendas, workshope, konferenca dhe takime informuese në lidhje me probleme të ndryshme psiko-sociale ²⁹² . Të gjitha këto aktivitete ndihmojnë njësinë kryesore dhe bazë, stafin akademik dhe studentët në arritjen e objektivave të tyre formative dhe profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	UNYT harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative në mësimdhënie ²⁹³ . Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga GVJ, UNYT disponon sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve Gnomon, Alfa për financat, Turnitin aplikacion antiplagjiaturë, dhe ESET antivirus për serverat ²⁹⁴ . Gjithashtu, sistemi i autorizuar i menaxhimit të bibliotekës dhe biblioteka online të përdorura për komunikimin e brendshëm, si dhe webfaqja zyrtare e UNYT. Aplikimi i metodave të ndryshme në lëndë e module mesimore, si studimet e rastit, analizat në grupe dhe individuale, detyrat e kursit dhe shkëmbimi i ideve, përdorimi i videove dhe artikujve ndihmojnë studentët të njihen me një mori

²⁹² Events. <https://unyt.edu.al/index.php/category/events/> (Aksesuar më 09.09.2022)

²⁹³ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.

²⁹⁴ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

	formash interaktive që lehtësojnë të kuptuarit e koncepteve teorike dhe përthyerjen e tyre në aspektin praktik e aplikative. Institucioni në funksion të përmirësimit të shërbimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe innovative ka planifikuar përmirësimin e strukturës mbështetëse të TIK-ut, rritjen e përdorimit të teknologjisë për studentët, wireless, “klasat inteligjente” me projektor LCD, ekranet e projeksonit, laptop, videokonferenca, e-learning etj, të cilat konsiderohen hapa të rëndësishëm në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UNYT ka përgatitur një udhëzues ²⁹⁵ me qëllim që të ndihmojnë pedagoët të kuptojnë dinamikat e ndryshme që ndikojnë mësimdhënien dhe të nxënit e sukseshëm. Në drejtim të realizimit, monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik njësia bazë, përmes një sër formash që përfshijnë vlersimin nga studentët ²⁹⁶ , vlerësimin e performancës ²⁹⁷ vetvlersimin ²⁹⁸ dhe vlersimin nga eprori i njësisë bazë/kryesore ²⁹⁹ realizon këtë proces në mënyrë periodike.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Bazuar në statutin dhe rregulloren e programit të studimit, institucioni përmes strukturave të saj garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies në bashkëpunim me rektorin mësimor ideon dhe organizon procesin e monitorimit të aktivitetit mësimor. Në fund të çdo semestri administrohen te studentët pyetësorë ³⁰⁰ në lidhje me cilësinë në mësimdhënie për lëndët e çdo program studimi ³⁰¹ .
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Cilësisë ³⁰² është njësi që e mbështet punën e saj në Ligjin për Arsimin e Lartë, Kodin e Cilësisë dhe Standartet e Cilësisë me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Organi kolegjal që funksionon në nivel institucional është Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, që funksionon si komision i përhershëm, i përbërë nga 5 anëtarë të emëruar nga rektori dhe të miratuar nga senati, ku kemi dhe një anëtar përfaqësues të

²⁹⁵ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.

²⁹⁶ Evidenca 194. Student evaluation form.

²⁹⁷ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

²⁹⁸ Evidenca 196. Individual Performance Assessment form 2021.

²⁹⁹ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

³⁰⁰ Evidenca 194. Student evaluation form.

³⁰¹ Evidenca 197. UNYT Vlersimet e pedagogëve nga studentët prog. Pasuniversitare.

³⁰² Evidenca.180. UNYT Quality Assurance Manual.

	studentëve. Këto struktura duke iu referuar rregullores ³⁰³ monitorojnë punën e njësisë bazë përmes raportimit periodik ³⁰⁴ dhe monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.								
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Institucioni në drejtim të inkurajimit të personelit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie aplikon një sër formash si vlersimin nga studentët ³⁰⁵ , vlerësimin e performancës ³⁰⁶ vetvlerësimin ³⁰⁷ dhe vlerësimin nga eprori i njësisë bazë/kryesore ³⁰⁸ që synojnë të monitorojnë procesin e mësimdhënies. UNYT nxit mundësitë për publikim në revista shkencore, pjesmarrjes pa pagesë të stafit akademik në konferencat e përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë vendase dhe të huaja, lejon mobilitetin jashtë vendit nëpërmjet Erasmus +, përfshirjen në projekte kërkimore, aplikon në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Këto aspekte shihen si forma pozitive në drejtim të stimulimit dhe nxitjes së personelit akademik për avancim në karrierën e tyre profesionale dhe në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Notë përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Notë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Notë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e	Procesi i mësimdhënies në UNYT përfshin një sër formash interaktive me studentët të parashtruara edhe në programin e lëndëve mësimore. Nga bisedat me stafin akademik, takimet me

³⁰³ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

³⁰⁴ Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.

³⁰⁵ Evidenca 194. Student evaluation form.

³⁰⁶ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

³⁰⁷ Evidenca 196. Individual Performance Assesment form 2021.

³⁰⁸ Evidenca 71. UNYT Intership placement of intership students first cohort.

<p>njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursit, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, rishikim artikujsh, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare. Veprimtaritë e tjera ndihmëse si leksionet e hapura me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Me ndikim pozitiv në këtë drejtim është dhe përdorimi i sistemit të teknologjisë së informacionit nga stafi dhe studentët në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me forma, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Personeli akademik duke iu referuar këtij diversiteti dhe nevojave të studentëve, është në një pozicion tepër sfidues duke qenë se ky diversitet jo vetëm duhet të marrë në konsideratë studentët por edhe profilet që janë të inkuorporuar në këtë master shkencor. Liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë implementimi i këtyre kërkesave duhet monitoruar në vijimësi, me qëllim që program i studimit të përmirësojë mësimdhënien e mësimnxënien si dhe modulet e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të</p>	<p>UNYT mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, jo vetëm përmes stukturave monitoruese por edhe përmes udhëzuesve për mësimdhënien³⁰⁹. Ky udhëzues synon përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie për stafin akademik të UNYT, përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Mbështetur në raportin e vlersimit të brendshëm dhe në syllabuset e lëndëve mësimore liria akademike në drejtim</p>

³⁰⁹ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.




nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	të organizimit të procesit mësimor i jep mundësi programit të përmirësohet.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duke iu referuar syllabuseve, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme, përgjithësisht krijon kushte për një të nxënë efektiv në linjë me profilin klink, kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës, profili i tyre del jashtë fushës së psikologjisë ligjore dhe shkollore në disa raste. Pavarësisht se profili i vetëm që është aktivizuar në këto 2 vite akademike, ai i Psikologjisë klinike, sërisht situata është delikate bazuar në mënyrën sesi janë organizuar planet mësimore për një pjesë të lëndëve me tema mësimore që dublohen në disa lëndë, njohuri tepër bazike për nivelin bachelor, lëndë që mundohen të mbulojnë njohuri për 3 profile të ndryshme dhe humbasin vetveten, apo tema që nuk kanë shpesh lidhje me njëra-tjetrën e që nuk ndjekin tipologjisë e lëndës.</p> <p><i>Sugjerimi i GVJ për njësinë bazë, që do të ndihmonte personelin në implementimin e planit mësimor në mënyrë kompetente do të përfshinte;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore nga titullarë të kategorisë “Profesor”, të cilët kanë arsimin dhe kualifikimet në linjë me profilin e këtij masteri.</i> - <i>Parashikimi i ofertës formative nga ana e njësisë bazë në mënyrë të plotë për të 3 profilet e këtij masteri, duke hartuar syllabuse të vecanta për secilin profil, dhe duke parashikuar stafin që do të mbulojë profilet për secilin grup mësimor që do të formohet.</i> - <i>Mbështetja tek insitucionet ndërkombëtare, me të cilat bashkëpunon për të përmirësuar ofertën formative, planet mësimore të lëndëve duke i përafruar me kurrikulën e tyre.</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së kurrikulës³¹⁰ dhe zyrës së cilësisë³¹¹ për përmirësimin e formave dhe metodave në mësimdhënie ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces ka një përpjekje përmes kordinimit nga</p>

³¹⁰ Evidenca 41. UNYT Curricula development policy and procedures, Alb.

³¹¹ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	departamenti ³¹² dhe komisionit të sigurimit të cilësisë ³¹³ , në nivel institucional si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie ³¹⁴ . Përfshirja e studentit në vlersimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët ³¹⁵ , realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies ³¹⁶ . Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Bazuar në udhëzuesin e mësimdhënies ^{317, 318} por edhe në mënyrës sesi janë hartuar syllabusët ³¹⁹ në përgjithësi ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie si role-play, studim rastesh, fokus-grupe, rishikim literature, diskutim artikujsh shkencore etj që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri praktike mbi fushën e psikologjisë. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksionit.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Format dhe metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga pedagogu. Mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog–student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

³¹² Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.

³¹³ Evidenca 182. UNYT Action plan, senate decision, minutes of QAC

³¹⁴ Evidenca 183. UNYT Minutes of QAC Action plan.

³¹⁵ Evidenca 194. Student evaluation form.

³¹⁶ Evidenca 198, UNYT Performance report spring 2021.

³¹⁷ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.

³¹⁸ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

³¹⁹ Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin^{320, 321} e shqyrtuar por edhe nga konstatimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se UNYT ka në dispozicion infrastrukturën fizike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në një godinë. Departamenti i Psikologjisë, i cilë është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore ka në dispozicion një sipërfaqje të mjaftueshme, në salla leksioni dhe seminari me kapacitetin e nevojshëm për numrin e studentëve të këtij program studimi. Sallat e leksionit dhe të seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë të pajisura me videoprojektor dhe kompjuter dhe wireless. Përpos tyre ambiente pune e konsultimi lejojnë shfrytëzimin nga studentët për nevojat mësimore, salla interneti, biblioteka, mjediset çlodhëse, janë ambiente që mund të përdoren nga studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, sallat e leksionit janë të pajisura me kompjuter, whiteboard/smartboard dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor dy laboratore informatike, bibliotekën në godinën e tij dhe atë online në JSTOR, Ebsco, Porquest, Gale³²² si dhe Emerald, e-biblioteka McGrill Hill³²³. Gjithashtu një ambient që është në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor është dhe biblioteka³²⁴ e cila ka një kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e studentëve të këtij programi</p>

³²⁰ Evidenca 139. UNYT space and facilities

³²¹ Evidenca 138. UNYT Relacioni Arkitektonik

³²² Evidenca 140. UNYT Library facilities.

³²³ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

³²⁴ Evidenca 140. UNYT Library facilities.

	studimi, me infrastrukturën e nevojshme si kompjuter dhe internet.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Në linjë edhe me objektivat kryesor strategjik të UNYT është dixhitaizimi. Të gjithë auditorët janë të pajisura me whiteboard dhe system projektimi dixhital, mjete të tjera audio e video. Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratore informatike, bibliotekën online. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale duke përdorur dhe platformat elektronike. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht në web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse në gjuhën angleze, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi në mbështetje të procesit mësimor është e përshtatshme dhe e rinovuar çdo vit nga strukturat përgjegjëse ³²⁵ sipas kërkesave të ardhura nga njësia bazë ³²⁶ . Një pjesë e literaturës bazë gjykohet e përshtatshme për tu përdorur për nevojat akademike. Përsa i përket literaturës në formë fizike apo elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se praktika e ndjekur nga institucioni është tepër positive si në drejtim të blerjes së librave fizik në 3 kopje (Amazon Global Store) që depozitohen në bibliotekën e UNYT, por edhe përmes abonimit në bibliotekat online. <i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u>: për një pjesë të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, të shfrytëzojë burimet në dispozicion, por dhe të tregoj kujdes në ruajtjen e një ekuilibri midis emërtimit të lëndës mësimore apo modulit dhe literaturës së përdorur për realizimin e saj.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të	Biblioteka e UNYT ndodhet në katin e parë dhe ka një hapsirë prej 215 m ² me 48 vende leximi ³²⁷ , dhe 2 tavolina pune me 6 përdorues secila, si dhe zonën e kompjuterave me 12 kompjutera në dispozicion të përdoruesve të saj. Biblioteka mbulon një sër

³²⁵ Evidenca 117. UNYT Books report psychology 2021-2022

³²⁶ Evidenca 118. Request for books.

³²⁷ Evidenca 139. UNYT space and facilities



<p>programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>shërbimesh si arkivim të çdo kopje të libri të ri fizik që hyn, arkivim të punimit të diplomës, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen literaturën mësimore dhe ekstrakurrikulare. Biblioteka ka në total 8.354 kopje fizike, të cilat janë kryesisht në tre kopje të ndara sipas përdoruesve, një kopje për stafin akademik, një kopje tjetër për studentët dhe shërbimin e bibliotekës. Fondi i alokuar nga UNYT çdo vit në funksion të blerjeve të reja është 20.000 euro. Për nevojat e njësisë bazë për vitin akademik 2021-2022 janë blerë 22 kopje fizike³²⁸.</p> <p><i>Kjo praktikë e UNYT, e rrallë përse i përket politikave të IAL në vendin tonë, konsiderohet me impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së teksteve mësimore në funksion të programit të studimit, garanton lehtësira për stafin lidhur me përmirësimin e bazës së literaturës mësimore, të cilën sugjerojmë që stafi akademik ta shfrytëzojë më mirë.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e UNYT ka një sistem të menaxhimit të librit online, që mundëson organizimin e librave dhe kërkimin e tyre sipas kategorive³²⁹. Platforma lehtëson procesin e kërkesave për të tërhequr libra nga anëtarët. Në platformë gjenden edhe link-et për aksesim në bibliotekat online ndërkombëtare JSTOR, Ebsco, Proquest, Gale³³⁰ si dhe Emerald, e-biblioteka McGrill Hill³³¹. Të gjitha këto platforma janë në funksion të mësimdhënies e mësimnxënies dhe mund të aksesohen lirisht nga stafi akademik dhe studentët e UNYT. Gjithashtu ambjentet janë në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në Universitetin e New Yorkut Tiranë³³² të gjithë auditorët janë të pajisur me whiteboard dhe sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video. Në funksion të digjitalizimit i gjithë mjedisi është mbështetur edhe me rrjetet wifi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, skaner në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ. Ndërkohë që janë të shfrytëzueshme mjediset e</p>

³²⁸ Evidenca 117. UNYT Books report psychology 2021-2022

³²⁹ Evidenca 139. UNYT space and facilities

³³⁰ Evidenca 140. UNYT Library facilities.

³³¹ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

³³² Evidenca 139. UNYT space and facilities

	<p>punës në bibliotekë dhe në 2 laboratorët e teknologjisë së informacionit me kapacitet prej 35 vende pune. Kjo infrastrukturë krijon të gjitha kushtet për shfrytëzim nga studentët për detyrat e kursit, diplomave dhe studimeve specifike. Këto mjedise janë vende ku studentët dhe stafi akademik kanë mundësinë të bashkëpunojnë të mbështetur nga sistemi dhe biblioteka digjitale, në një ambient modern ku punohet, studiohet, krijohet dhe jetohe të bashku.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>UNYT ka shërbime në platforma dhe link-et për aksesimin e bibliotekave ndërkombëtare online. Të tilla si biblioteka dixhitale Emerald, e-biblioteka McGrill Hill³³³, bibliotekë që ofron orientim dhe ndihmë në kërkim të punimeve dhe librave dixhital si dhe akses të plotë dhe të licensuar në internet për materialet që ofron, universiteti. Po ashtu, në bibliotekën dixhitale JSTOR, e cila siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore në 75 disiplina, universiteti ka abonim me account-in e bibliotekës nëpërmjet të cilit mund të aksesojnë stafi akademik dhe studentët dhe ku behet e mundur leximi online dhe ruajtja e materialeve që dëshirojnë direkt nga platforma e tyre. Të tjera burime janë Ebsco, Open Dissertations.org që është një bashkëpunim midis EBSCO dhe BiblioLabs që sjell një qasje innovative, Porquest, Gale³³⁴ që janë bazë të pavarura të dhënash që përmbajnë revista shkencore, që mbulojnë të gjitha fushat e shkencës, teknologjisë, mjekësisë, shkencave shoqërore, arteve dhe shkencave humane.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm³³⁵ përdorin sistemin e ri të menaxhimit të të dhënave të studentëve, Gnomon software, e cila shërben për të mbajtur rekordet e studentëve. Ky software mbështet si zyrën e rekrutimit të studentëve duke vijuar me zyrën e regjistrimit dhe financave. Çdo zyrë ka akses dhe përpunon të dhënat e studentëve të regjistruar duke ndjekur çdo hap deri në diplomim. Posta elektronike e UNYT përmes Outlook-office 365.edu, ku të gjithë anëtarët e stafit dhe studentëve kanë llogarinë e tyre postare. Shërbimi Turnitin është një shërbim për studentët dhe stafin për t'u shfrytëzuar për nevojat e tyre akademik, duke mundësuar kontrollin e plagjiaturës brenda</p>

³³³ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

³³⁴ Evidenca 140. UNYT Library facilities.

³³⁵ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.




	punës së studentit, për të parandaluar mashtrimin dhe pandershmërinë akademike. Sistemi i printimit dhe laboratorët e kompjuterave dhe pajisjet e tjera të informatikës janë të gjitha në funksion të komunikimit të brendëshëm dhe hapsirës vetijake të dedikuar.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Departamenti i Psikologjisë ka vënë në dispozicion të studentëve për përgatitjen e temës së diplomë stafin akademik dhe një udhëzues të punimit të diplomës ³³⁶ . Ky udhëzues përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, udhëheqjes, të monitorimit, prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të diplomës. Kjo realizohet konkretisht nga njësi bazë, e cila sipas RVB mbulon rolin e kordinatorit të programit të studimit. Njësi u propozon studentëve listën e pedagogëve që janë në dispozicion për programin e studimit, cdo student plotëson formularin e aplikimit për temën e diplomës, departamenti bën miratimin e tyre sipas kriterëve specifike për punimin e temës duke u bazuar në udhëzuesin e saj. Gjithashtu, të detyrueshme për studentin janë takimet me udhëheqësin e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë	Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, përmes Komisionit të Përhershëm të Standarteve të Cilësisë ³³⁷ . në rang institucional, Zyrës së Sigurimit të Cilësisë ³³⁸ , Zyrës së Kurrikulës ³³⁹ dhe Njësisë Bazë ³⁴⁰ , të cilat synojnë promovimin e vazhdueshëm të mësimdhënies duke hartuar plane

³³⁶ Evidenca 57. UNYT Msc. in Psychology Master Thesis Guideline and APP.

³³⁷ Evidenca 183. UNYT Minutes of QAC Action plan.

³³⁸ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

³³⁹ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

³⁴⁰ Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.

<p>dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>veprimi³⁴¹ dhe kordinuar punën midis tyre. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, në funksion të kësaj çështje është hartuar edhe një udhëzues për metodat në mësimdhënie³⁴². Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Përmes raportit të vlerësimit të studentëve³⁴³ i cili lejon mbledhjen e një informacioni të detajuar mbi një sër aspektesh lidhur me procesin mësimnxënës dhe mësimdhënës vlersimin e performancës³⁴⁴ vetvlersimin³⁴⁵ dhe vlersimin nga eprori i njësisë bazë³⁴⁶. Këto praktika u sigurojnë informacione të rëndësishme si Njësisë për Zhvillimin e Kurrikulës dhe njësisë kryesore dhe asaj bazë. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë në bashkëpunim me Njësinë për Sigurimin e Cilësisë dhe Njësinë për Zhvillimin e Kurrikulës³⁴⁷ ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Mjetet si raporti vjetor i njësisë bazë³⁴⁸ i lejon të mbledh një informacion të detajuar mbi një sër aspektesh të rëndësishme. Bashkëpunimi i njëzisë bazë me komisionin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, i cili monitoron programin në vijimësi, duhet të sigurojë informacione të rëndësishme si për strukturat drejtuese në nivel institucional ashtu dhe për njësinë kryesore dhe atë bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UNYT krijon hapsira për të respektuar lirinë akademike të stafit në raport me mënyrën e organizimit të procesit mësimor duke përfshirë forma të reja interaktive dhe përdorimin e teknologjisë dhe burimeve të tjera të brendshme në këtë drejtim, si psh shërbimi Turnitin, mjaft i mirë për stafin dhe studentët në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Githashtu, përmes projekteve të ndryshme (Jean Monett Moduls) stafi akademik ka pasur mundësi të</p>

³⁴¹ Evidenca 182. UNYT Action plan, senate decision, minutes of QAC

³⁴² Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.

³⁴³ Evidenca 194. Student evaluation form.


³⁴⁴ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

³⁴⁵ Evidenca 196. Individual Performance Assesment form 2021.

³⁴⁶ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

³⁴⁷ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

³⁴⁸ Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.



	eksperimentojë edhe me format e reja të mësimdhënies përmes ofrimit të moduleve të ndryshme ³⁴⁹ . Këto përvoja si dhe mobilitetet, leksionet e hapura me lektor të ftuar, konferencat, etj., konsiderohen me ndikim pozitiv në zhvillimin e metodave të reja inovative në mësimdhënie.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Duke iu referuar këtij kriteri një sër veprimtarish të ndërmarra mbështesin kualifikimin e stafit në fushën e kërkimit shkencor dhe përfitimit të përvojës në mësimdhënie si projekte ³⁵⁰ , mobilitete, trajnimeve, publikimeve ³⁵¹ , konferenca ³⁵² . Bazuar në dokumentacionin për mbështetjen e stafit akademik kemi një sër nismash ³⁵³ që synojnë të krijoj mundësi për pjesmarrje në trajnime ^{354, 355, 356} , workshop ³⁵⁷ , konferenca ^{358, 359} dhe intershipe ³⁶⁰ , nga ku një pjesë e stafit akademik të njësisë bazë ka marrë pjesë ³⁶¹ . Mbështetja e stafit në mobilitete në mësimdhënie përmes Erasmus + dhe Mevlana ^{362, 363, 364} kanë qenë të shumta.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, UNYT ndjek një politikë institucionale në drejtim të kërkimit shkencor ^{365, 366} . Institucioni bazuar në politikën e ndërkombëtarizimit përmes bashkëpunimit ndërkombëtar synon rritjen e cilësisë së stafit akademik. Për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse kemi një sër nismash ³⁶⁷ që të krijoj mundësi për pjesmarrje në trajnime ^{368, 369, 370}

³⁴⁹ Evidenca 81. UNYT EU Helath Issue -University of Neë York Tirana

³⁵⁰ Evidenca 81. UNYT EU Helath Issue -University of Neë York Tirana

³⁵¹ Evidenca 88. UNYT List of publications of the member of department 2019-2022.

³⁵² Evidenca 94. UNYT MC certificate B.L.

³⁵³ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

³⁵⁴ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

³⁵⁵ Evidenca 207. UNYT Staff Training

³⁵⁶ Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

³⁵⁷ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

³⁵⁸ Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – iNvitation B. L.

³⁵⁹ Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

³⁶⁰ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

³⁶¹ Evidenca 88. UNYT List of Publications of the members of department 2019-2022.

³⁶² Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

³⁶³ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching ëeek – internationalization of teaching

³⁶⁴ Evidenca 127 UNYT Erasmus A. Halimi.

³⁶⁵ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

³⁶⁶ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

³⁶⁷ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

³⁶⁸ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

³⁶⁹ Evidenca 207. UNYT Staff Training

³⁷⁰ Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

	workshop ³⁷¹ , konferenca ^{372,373} dhe intershipe ³⁷⁴ . Këto nisma duhet të synojnë ta shndërrojnë UNYT në një institucion aplikativ, novator, të orientuar nga tregu i punës dhe zhvillimi krijues i qëndrueshëm. Një sër projektesh ³⁷⁵ janë ndërmarrë dhe vijnë të zbatohen në fushën e shkencave shoqërore ku janë të përfshirë anëtarë të stafit akademik, duke kontribuar në drejtim të rritjes profesionale dhe eksperiencave të mira nga bashkëpunimet me profesionistët ndërkombëtarë.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë janë angazhuar në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe implementimit të metodave të reja. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, në funksion të kësaj çështje është hartuar edhe një udhëzues për metodat në mësimdhënie ³⁷⁶ .
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidence të qartë përse i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedurë që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti ³⁷⁷ , formulari i vlerësimit të performancës ³⁷⁸ nga njësia e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë, vetvlerësimin ³⁷⁹ dhe vlerësimin nga eprori i njësisë bazë ³⁸⁰ . Këto procedurë synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve	UNYT duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka zhvilluar një sër aktiviteteve si workshope, konferenca, trajnime, mobilitete të stafit dhe studentëve duke u

³⁷¹ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

³⁷² Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – invitation B. L.

³⁷³ Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

³⁷⁴ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

³⁷⁵ Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

³⁷⁶ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

³⁷⁷ Evidenca 194. Student evaluation form.

³⁷⁸ Evidenca 198. UNYT Performance report -Spring 2021.

³⁷⁹ Evidenca 196. Individual Performance Assessment form 2021.

³⁸⁰ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	siguruar bashkëpunim dhe përfshirje të vazhdueshme të partnerëve për përmirësimin e aftësive të mesimdhënies të stafit akademik dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj. Në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive shkencore e profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren e njësisë bazë ³⁸¹ dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit ³⁸² , sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e punimit të diplomës. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar platforma elektronike që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive ³⁸³ bëhen publike ³⁸⁴ , ³⁸⁵ dhe njihen nga studentët edhe përmes sistemit të informacionit online (e-Gnomon) sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e	Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve ³⁸⁶ të programit të studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë

³⁸¹ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

³⁸² Evidenca 20. Rregullore e programit.

³⁸³ Evidenca 109. UNYT Instructor's Handbook -Alb.

³⁸⁴ Evidenca 122. UNYT Final Exam Communication.

³⁸⁵ Evidenca 125. UNYT e-exam platform 2020.


³⁸⁶ Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip..

<p>vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>studentët. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësimi më objektiv, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimi të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit, përmes grup pyetjeve për kontrollin e njohurive, grup pyetje analizuese dhe grup pyetje zhvilluese. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma, për programin e studimit. Gjithashtu, duke shfrytëzuar sistemin e komunikimit të brendshëm studentët mund të marrin informacion dhe të kryejnë procedurat e regjistrimit³⁸⁷ në kurse të ndryshme për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik³⁸⁸.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

³⁸⁷ Evidenca 109. UNYT Instructor's Handbook -Alb.

³⁸⁸ Evidenca 125. UNYT e-exam platform 2020.




<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Mbështetur në procedurën e përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë³⁸⁹ dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit³⁹⁰, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësimi më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit. Elementë kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose verbale. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit³⁹¹.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit ose përmes sekretimit të provimeve, një pjesë mund të realizohen në platform elektronike e-learning UNYT e-scholarship Exam³⁹² përmes ProProofs³⁹³. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma. Platforma (ProProofs) e UNYT e-scholarship Exam³⁹⁴ duket se ofron opsionin e testimit dhe vlerësimit edhe online me qëllimin që të eliminojë mundësitë dhe format e abuzimit, si dhe të rrisë transparencën për një testim dhe vlerësim objektiv.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Njësia bazë ka një procedurë në drejtim të hapave e afateve kohore që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës³⁹⁵. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit</p>

³⁸⁹ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

³⁹⁰ Evidenca 20. Rregullore e programit.

³⁹¹ Evidenca 109. UNYT Instructor's Handbook -Alb.

³⁹² Evidenca 125. UNYT e-exam platform 2020.

³⁹³ Evidenca 148 UNYT ProProof -e examPlatform Invoice.

³⁹⁴ Evidenca 125. UNYT e-exam platform 2020.

³⁹⁵ Evidenca 20. Rregullore e programit.




<p>realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>për t'u miratuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik. Praktikrat profesionale, dhe mbrojta e diplomave realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave³⁹⁶. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatit e çdo studenti. Çsekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet³⁹⁷.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback³⁹⁸ dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen, bazuar edhe në rregulloren e departamentit³⁹⁹. Cdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlersim të notës përmes komisioneve të posaçme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim. Proçedura të mirëorganizuar⁴⁰⁰ për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar⁴⁰¹ që t'u japë mundësi studentëve që t'iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxënimit. Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezën orgjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën,</p>	<p>Njësitë përgjegjëse e UNYT dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Respektimi i proçedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave^{402, 403} që lidhen me kushtet si; mospërdorimi i së</p>

³⁹⁶ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

³⁹⁷ Evidenca 20. Rregullore e programit.

³⁹⁸ Evidenca 76. UNYT Turnitin report.

³⁹⁹ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁴⁰⁰ Evidenca 20. Rregullore e programit.

⁴⁰¹ Evidenca 76. UNYT Turnitin report

⁴⁰² Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁴⁰³ Evidenca 20. Rregullore e programit.

<p>kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mira për të shmugur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra, por edhe shërbimi Turnitin është një mjet mjaft efikas dhe i nevojshëm për të ndihmuar stafin akademik dhe studentët të evitojnë plagjiaturën në provime e detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>UNYT disponon një procedurë të mirëfilltë për sa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit⁴⁰⁴ dhe në syllabusin e lëndës⁴⁰⁵.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni respekton procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlersimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit⁴⁰⁶. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në portalin e studentit ose përmes sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Çdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlersim të notës përmes komisioneve të posacme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim. Duke u bazuar te rregullorja e njësisë bazë⁴⁰⁷, në rregulloren e programit⁴⁰⁸, dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.</p>

⁴⁰⁴ Evidenca 20. Rregullore e programit.

⁴⁰⁵Evidenca 55. UNYT Sylabet shqip.

⁴⁰⁶ Evidenca 20. Rregullore e programit.

⁴⁰⁷ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁴⁰⁸ Evidenca 20. Rregullore e programit.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë të profileve ndërdisiplinare në kontekstin e fushës së psikologjisë klinike, shkollore dhe ligjore, por kjo larmishmëri mund të shihet edhe si jo e plotë nëse disa lëndë mësimore bazohen në një literaturë të përsëritur të atyre njohurive që studentët i kanë marrë në ciklin e parë të studimeve apo dublim njohurish në lëndë të ndryshme. Në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën e psikologut klinik, shkollor apo ligjor dhe në një aftësim për të zhvilluar kompetenca profesionale te studentët, lidhur me profilin e zgjedhur, program i studimit duhet tu garantoj studentëve thellim njohurish dhe t’u zhvillojë aftësi profesionale, gjë e cila bazuar në stafin akademik^{409, 410} të angazhuar në mësimdhënie syllabuseve⁴¹¹. dhe literaturës së përdorur duket e vështirë të përmbushet me sukses për të gjitha profilet e propozuara.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë të ndërmarrë masa për të hartuar syllabuse të vecanta sipas 3 profile të propozuar për këtë master, hartimi i syllabuseve të realizohet nga titullarë që i përkasin kategorisë “Profesor” dhe të kenë kualifikimin në linjë me fushën e psikologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,</p>	<p>UNYT dhe njësia bazë për këtë program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në aspektin praktik përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin e postës elektronike të</p>

⁴⁰⁹ Evidenca 54. UNYT CV of instructors of Psychology Department.

⁴¹⁰ Evidence 79. UNYT List of Academic Registered as Practitioners of Clinical Psychology.

⁴¹¹ Evidenca 55. UNYT Syllabus shqip.

<p>humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>institucionit Outlook -office 365, EDU, e-Gnomon, shërbimi Turnitin, biblioteka online për aksesimin e librave e artikujve online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sërë aktivitete që ndikojnë pozitivisht në si angazhimi i stafit bashkë me studentët në qendrën e karrierës dhe aktivitetet ekstrakurrikulare ku janë përfshirë studentët si veprimtari bamirësie, konferenca dhe leksione të hapura që u japin mundësi ndërveprimi, të cilat përgjithësisht realizohen në gjuhën angleze, e cila është dhe gjuha e këtij program studimi. Ky aspekt konsiderohet si pikë e fortë si në drejtim të lehtësimit të mobiliteteve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare të stafit e studentëve por edhe në shfrytëzimin më të mirë të literaturës në dispozicion në gjuhën angleze.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në këtë drejtim kemi disa nisma të njësisë bazë si vlersimin nga studentët⁴¹², vlerësimin e performancës⁴¹³ vetvlerësimin⁴¹⁴ dhe vlersimin nga eprori i njësisë bazë/kryesore⁴¹⁵, të cilat realizohen në mënyrë periodike. Analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Prezenca e këtyre praktikave në institucion shihet si element pozitiv në drejtim të përpjekjeve për të ofruar lëndë e module që synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në lidhje me aplikimin e këtij kriteri sipas evidencave, realizohen përmbledhje të njohurive për të nxjerr konkluzione dhe diskutimin e orientuar të studentëve para provimeve nga secili prej personelit akademik që është angazhuar në këtë program studimi. Pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe</p>	<p>UNYT në këtë drejtim ka praktika të mira⁴¹⁶; ⁴¹⁷; ⁴¹⁸ përsa i përket hapësirave që ka stafi akademik për të përfutuar nga përfshirja në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare</p>

⁴¹² Evidenca 194. Student evaluation form.

⁴¹³ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁴¹⁴ Evidenca 196. Individual Performace Assesment form 2021.

⁴¹⁵ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

⁴¹⁶ Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

⁴¹⁷ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching eëek – internationalization of teaching

⁴¹⁸ Evidenca 127UNYT Erasmus A. Halimi.

<p>seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>që janë fituar nga institucioni, përfitimi nga mobiliteti i stafit⁴¹⁹, ⁴²⁰, ⁴²¹, ⁴²², ⁴²³, ⁴²⁴, ⁴²⁵, ⁴²⁶ dhe studentëve⁴²⁷, ⁴²⁸, ⁴²⁹, ⁴³⁰, ⁴³¹ përmes projekteve të BE, eventet e ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si trajnime, konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari. Përmes krijimit të mundësisë për pjesëmarrje në konferencat që UNYT organizon pa pagesë për stafin e tij akademik krijohen mundësi të tjera në këtë drejtim.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjejmë mbi këtë aspekt bazuar në një sërë formash interaktive të përdorura në mësimdhënie. Por disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë të cilat përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve. Gjithsesi, vlerësohet që problematikat e evidentuara më lart përgjatë këtij raporti ndikojnë negativisht në këtë aspekt.</p> <p><i>GJVJ sugjeron kapërcimin e saj nëse stafi akademik angazhohet në një proces përmirësimi të literaturës së përdorur për nevojat e lëndës mësimore dhe në përputhje me emërtimin e saj, e cila sjell dije dhe njohuri të avancuara në profilet përkatëse dhe nuk del jashtë tipologjisë së lëndës përmes temave të trajtuara.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe</p>	<p>Personeli akademik mbështet diskutimet, punën në grup dhe nxit studentët në reflektimin e zgjidhjeve të caktuara në kontekstin klinik, shkollor dhe ligjor. Duke u bazuar në mënyrën e ndërtimit</p>

⁴¹⁹ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

⁴²⁰ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

⁴²¹ Evidenca 207. UNYT Staff Training

⁴²² Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

⁴²³ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

⁴²⁴ Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – Invitation B. L.

⁴²⁵ Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

⁴²⁶ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

⁴²⁷ Evidenca 71. UNYT.Internship Placement of internship students first cohort.

⁴²⁸ Evidenca 36. UNYT International Student-Congress 2020.

⁴²⁹ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁴³⁰ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolaprship- Poster.

⁴³¹ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

<p>zgjdhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>të silabuseve të lëndëve/moduleve por edhe nga takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët ka një klimë pozitive të ndërveprimit midis stafit dhe studentëve për çështjet mësimore. Pasi procesi i mësimdhënies bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, shqyrtimin e literaturës, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënit në tërësi.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Klima e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore janë element që duhen parë në vijimësi, pasi personelit akademik është i pamjaftueshëm për të mbuluar fushën e kespertizës për të 3 profilet. Gjithashtu, duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore ato paraqesin probleme që lidhen me temat mësimore, dublimin në lëndë të ndryshme, njohuri që janë bazike dhe ripërsëritje e nivelit bachelor. E gjithë kjo shihet me skepticizëm sesi do implemetohen në planin mësimor të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mund të ketë vështirësi. Kjo duke iu referuar përvojës profesionale të një pjese të stafit mund të jetë i mundur, por programi i lëndës dhe temat mësimore në linjë me tipologjinë e lëndës duhet të përmirësohen.</p> <p><i>Bazuar në këto problematika të evidentuara <u>GVJ rekomandon një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore, me qëllim shmangien që në lëndë të ndryshme të përsëriten njohuritë që jepen në auditor.</u></i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Bazuar në përfshirjen në projekte⁴³², botime artikujsh, konferenca⁴³³, ⁴³⁴, ⁴³⁵ kemi një sërë evidencash, në të cilat pedagogët e njësisë bazë janë angazhuar. UNYT ka nisma të mira edhe lidhur me organizimin e konferencës studentore⁴³⁶ e cila është e përvitshme. Në këtë konferencë, studentët duke bashkëpunuar me pedagogët e tyre paraqesin punimet e tyre kërkimore.</p>

⁴³² Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁴³³ Evidenca 71. UNYT.Intership Placement of intership students first cohort.

⁴³⁴ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolaprrship- Poster.

⁴³⁵ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁴³⁶ Evidenca 36. UNYT International Student-Congress 2020.

Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera kemi nisma me një sër institucionesh brenda dhe jashtë vendit lidhur me mobilitetet e studentëve për mësimdhënie ^{437, 438} , intershipe ⁴³⁹ , trajnime etj ⁴⁴⁰ . Gjithashtu, edhe veprimtaritë e përbashkëta të organizuara nga UNYT si konferenca ^{441, 442} , workshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit ^{443, 444} lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu veprimtari të vlefshme janë ato me Erasmus + ^{445, 446, 447} për realizimin e mobilitetit të stafit e studentëve shihen si pozitive, por është herët për të vlerësuar vijimësinë e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Bazuar në rregulloren njësisë dhe të programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ^{448, 449} dhe në udhëzimin për punimin e temës së diplomës institucioni ka hartuar procedurë të posaçme ⁴⁵⁰ për studentët, të cilët mbrojnë diplomën. Kriteret për mbrojtje diplome me temë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes njësisë bazë që zhvillon programin. Njësia bazë ka një format të posaçëm për realizimin vlerësimit sipas ndarjes

⁴³⁷ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolaprrship- Poster.

⁴³⁸ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁴³⁹ Evidenca 71. UNYT.Intership Placement of intership students first cohort.

⁴⁴⁰ Evidenca 71. UNYT.Intership Placement of intership students first cohort.

⁴⁴¹ Evidenca 36. UNYT International Student-Congress 2020.

⁴⁴² Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

⁴⁴³ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

⁴⁴⁴ Evidenca 207. UNYT Staff Training

⁴⁴⁵ Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

⁴⁴⁶ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching week – internationalization of teaching

⁴⁴⁷ Evidenca 127 UNYT Erasmus A. Halimi.

⁴⁴⁸ Evidenca 19. Deparment Rules and Regulations, Alb.

⁴⁴⁹ Evidenca 20. Rregullore e programit.

⁴⁵⁰ Evidenca 109. UNYT Msc in Psychology master Thesies Guidlime and App Form Sylabi.

	në disa komponentë. Gjithashtu përmes sistemit Turnitin bëhet edhe kontrolli i autenticitetit të materialit të paraqitur nga studenti.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Njësia bazë dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës ⁴⁵¹ . Përsa i përket realizimit të temës së diplomës studentët e këtij programi në përfundim të këtij cikli studimi, diplomohen si kërkues shkencor në profilin e psikologjisë klinike, shkollore dhe ligjore pas mbrojtjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës me temë ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës dhe monitorimin e punës përmes seancave të konsultimit që janë të detyrueshme nga studenti për t'u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave e realizon njësia bazë.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në realizimin e projektit kërkimorë që të fitojnë gradën kërkues shkencor në psikologji klinike, shkollore dhe ligjore. Realizimi i një punimi shkencor nga studentët i jep mundësi komisionit të bëjë një vlerësim të kompetencave kërkimore dhe profesionale të përvetësuar nga studentët përgjatë këtij itinerari formavit 2 vjeçar. Bazuar në rregulloren e programit të studimit studentët vihen në dijeni në fillim të semestrit të dytë, të vitit të dytë, nga Përgjegjësi i Departamentit mbi rregullat e mbrojtjes së punimit të diplomës që kërkon vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore, si dhe të kenë qënë të suksesshëm në realizimin e praktikës profesionale, si dhe të kenë shlyer detyrimet ndaj institucionit.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Personeli akademik orienton ⁴⁵² dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së diplomës. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit ⁴⁵³ dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e seancave të konsultimit individuale përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit, si dhe të nënshkrimit nga pedagogu udhëheqës të punimit final para se të dorëzohet tek komisioni i mbrojtjes.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për	Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jasht institucionit, UNYT ka

⁴⁵¹ Evidenca 109. UNYT Msc in Psychology master Thesies Guidlime and App Form Sylabi.

⁴⁵² Evidenca 109. UNYT Msc in Psychology master Thesies Guidlime and App Form Sylabi.

⁴⁵³ Evidenca 20. Rregullore e programit.

<p>kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>nënshkruar një numër të kufizuar marrëveshjesh bashkëpunimi (4 në fushën e psikologjisë). Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si seancat e konsultave individuale, konsultat me pedagogët, aksesit në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka dhe salla e leximit, sistemi antiplagjiaturë, etj.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal. Ky proces lehtësohet edhe nga sistemi antipalgjiaturë, Turnitin, që studentët dhe pedagogët udhëheqës përdorin për të përmbyllur me sukses gjithë punën e përbashkët.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit vlerësimi i studentëve në përfundim të punimit të diplomës realizohet para komisionit të diplomimit dhe vlerësohet me notë nga ky komision, sipas sistemit të miratuar në rregulloren e programit me pikëzim (0-4) dhe me shkronja (A-F).</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të syllabuseve të këtij programi studimi në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore duhet të hartoj dhe pajisë studentin me Diplomë /Certifikatën, Suplementin e saj ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Duke mos pasur në dispozicion në format të propozuar të UNYT lidhur me mënyrës sesi do të jenë emërtuar këto dokumenta e kemi të vështirë të shprehemi.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të syllabuseve të këtij programi studimi në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore duhet të hartojë dhe pajisë studentin me Suplementin e Diplomës, dhe certifikatën ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur në gjuhën angleze dhe shqip. Bazuar në</p>

	dokumentacioni e shqyrtuar nuk kemi evidenca për të vlerësuar përmbushjen e këtij kriteri nga UNYT.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni dhe duke përdorur sitemin e tij të ruajtjes së rekordeve që është e-Gnomon (nota, mungesa, detyrime). Pas përfundimit të studimeve nga studentit, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat ⁴⁵⁴ . Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit	Zyra e Burimeve Njerëzore ⁴⁵⁵ e cila ka si mision të siguroj menaxhim efektiv të burimeve njerëzore ka të dhënat për personelin e angazhuar në mësimdhënie. Zyra e burimeve njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimi ⁴⁵⁶ . Stafit akademik dhe ndihmës kanë dosjet

⁴⁵⁴ Evidenca 45. UNYT Archive rules and Regulations, Alb.

⁴⁵⁵ Evidenca 128. UNYT Human Resources Polict Document, Alb.

⁴⁵⁶ Evidenca 45. UNYT Archive rules and Regulations, Alb.

<p>akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>personale me të dhëna të plota. Kjo zyrë merret me procedurat e rekrutimit⁴⁵⁷ të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjeshme si dhe me stafin ndihmës akademik⁴⁵⁸. Kjo zyrë mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës⁴⁵⁹ për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë rekrutimi⁴⁶⁰ për personelin akademik përmes disa hapash që fillon me inkurajimin e departamenteve në rekrutimin e stafit në mënyrë efektive⁴⁶¹. Zyra e burimeve njerëzore sipas dokumentacionit⁴⁶² ka përgjegjësinë të kujdeset për rekrutimin e stafit me aftësi, njohuri dhe ekspertizë e eksperiencën e duhur për të ndihmuar UNYT në arritjen e objektivave të tij. Kjo zyrë kujdeset që njësi bazë të marr vendimin në bazë të kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik⁴⁶³, Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Duke iu referuar rregullores së zyrës së burimeve njerëzore cdo fillim semestri njësi bazë evidenton nevojat për staf. Procedurat e përcaktuara nga institucioni⁴⁶⁴ në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike⁴⁶⁵ për t’u bërë pjesë e stafit akademik të UNYT janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online⁴⁶⁶ të UNYT dhe përzgjedhja bëhet me</p>

⁴⁵⁷ Evidenca 130. UNYT Recruitment procedure, Eng.

⁴⁵⁸ Evidenca 132. UNYT Psychology Recruiting procedures academic staff.

⁴⁵⁹ Evidenca 133. UNYT Board decision 30.09.2021. no 09 Appointment of Dean.

⁴⁶⁰ Evidenca 130. UNYT Recruitment procedure, Eng.

⁴⁶¹ Evidenca 131. UNYT Vacancy Announcement.

⁴⁶² Evidenca 133. UNYT Board decision 30.09.2021. no 09 Appointment of Dean.

⁴⁶³ Evidenca 128. UNYT Human Resources Polict Document, Alb.

⁴⁶⁴ Evidenca 130. UNYT Recruitment procedure, Eng.

⁴⁶⁵ Evidenca 131. UNYT Vacancy Announcement.

⁴⁶⁶ Evidenca 131. UNYT Vacancy Announcement.



	<p>konkurs. Institucioni në fillim të vitit akademik publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web www.unyt.edu.al⁴⁶⁷ të UNYT pas identifikimit të nevojave.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike⁴⁶⁸ përmes mjeteve të komunikimit që ka në dispozicion, si faqja e universitetit dhe rrjetet sociale, sipas të gjitha kriterëve⁴⁶⁹. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ngrihet një komision ad hoc i propozuar nga Dekani dhe i miratuar nga Rektori, “Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit akademik”, i përbërë nga pedagogë dhe punonjës kërkimorë-shkencorë të brendshëm, të cilët bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të personelit akademik. Kjo zyrë publikon shpalljen duke përdorur faqen e saj zyrtare apo rrjetet sociale. Shpallja e pozicionit vakant për staf akademik dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike hartohen nga sekretaria e burimeve njerëzore në bashkëpunim me përgjegjësin e njësisë bazë. Të dhënat e publikimit përfshijnë përshkrimin e pozicionit të punës, kriteret e përgjithshme për aplikim, dokumentacionin shoqërues, afati i aplikimit dhe adresën e dorëzimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

⁴⁶⁷ Job Vacancies- Ëork ëith us. <https://unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-ëork-ëith-us/> (Aksesuar më 09.09.2022).

⁴⁶⁸ Job Vacancies- Ëork ëith us. <https://unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-ëork-ëith-us/> (Aksesuar më 09.09.2022).

⁴⁶⁹ Evidenca 131. UNYT Vacancy Announcement.



<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni angazhohet në drejtim sigurimit të kushteve të përshtatshme për të realizuar detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Kapacitetet infrastrukturor⁴⁷⁰ në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezultojnë se platformat elektronike si dhe mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” administrohet nga Departamentit i Psikologjisë pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Gjatë takimit me stafin e institucionit konstatohet që Njësia e Zhvillimit të Cilësisë është njësia që organizon trajnimet periodike në përputhje me kornizën dhe statutin^{471, 472}. Po ashtu në drejtim të trajnimeve profesionale që duhet të ofrohet ka një rritje të programeve Erasmus + të dhënat tregojnë se ka pasur trajnime⁴⁷³, konferenca, pjesmarrje në projekte kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga qendra e projekteve e UNYT ku përfshihen staf, student dhe alumnit (ish student). Institucioni krijon mundësi në drejtim të kualifikimit dhe rritjes profesionale nëpërmjet marrëveshjeve të shkëmbimit të stafëve dhe studentëve nga Erasmus +.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të</p>	<p>Mënyra e organizimit në tërësi të veprimtarive të UNYT synon dixhitalizimin e tij duke synuar ofrimin e një sër platformash, shërbimesh e mjetesh që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe rrisin cilësinë e saj. Gjithashtu një sër veprimtarish të ndërmarra mbështesin kualifikimin e stafit në fushën e kërkimit shkencor dhe përfitimit të përvojës në mësimdhënie si projekte⁴⁷⁴, mobilitete, trajnimeve, publikimeve⁴⁷⁵, konferenca⁴⁷⁶. Bazuar në dokumentacionin për mbështetjen e stafit akademik kemi një sër</p>

⁴⁷⁰ Evidenca 139. UNYT Space and Facilities.

⁴⁷¹ Evidenca 206. UNYT Quality Assurance Training.

⁴⁷² Evidenca 203. UNYT EQAF 2021 QA Training.

⁴⁷³ Evidenca 205. UNYT Lithuania training eëek.

⁴⁷⁴ Evidenca 81. UNYT EU Helath Issue -University of Neë York Tirana

⁴⁷⁵ Evidenca 88. UNYT List of publications of the member of department 2019-2022.

⁴⁷⁶ Evidenca 94. UNYT MC certificate B.L.



personelit mësimor-shkencor.	nismash ⁴⁷⁷ që synojnë të krijoj mundësi për pjesmarje në trajnime ^{478, 479, 480} workshop ⁴⁸¹ , konferenca ^{482, 483} dhe intershipe ⁴⁸⁴ , nga ku një pjesë e stafit akademik të njësisë bazë ka marrë pjesë në bashkëpunim me partnerët e saj ndërkombëtar ⁴⁸⁵ . Mbështetja e stafit lidhur me mobilitetin në mësimdhënie përmes Erasmus + dhe Mevlana ⁴⁸⁶ ; ⁴⁸⁷ ; ⁴⁸⁸ ndihmojnë në për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vërtetimit ⁴⁸⁹ dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi përpjekjen e vazhduar të njësisë në përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. UNYT ka angazhuar personel akademik, personel akademik dhe kërkues, personel ndihmës akademik dhe personel administrative. Personeli akademik mban tituj akademik, Profesor i Asociuar si dhe gradë shkencore “Doktor i Shkencave”			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

⁴⁷⁷ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

⁴⁷⁸ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

⁴⁷⁹ Evidenca 207. UNYT Staff Training

⁴⁸⁰ Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

⁴⁸¹ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

⁴⁸² Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – invitation B. L.

⁴⁸³ Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

⁴⁸⁴ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

⁴⁸⁵ Evidenca 88. UNYT List of Publications of the members of department 2019-2022.

⁴⁸⁶ Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

⁴⁸⁷ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching eek – internationalization of teaching

⁴⁸⁸ Evidenca 127 UNYT Erasmus A. Halimi.

⁴⁸⁹ Evidenca 53. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.

<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UNYT është një institucion që siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse⁴⁹⁰. Aktiviteti i tij ushtrohet në një godinë dhe mjediset sportive që përmbushin këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjedisëve të nevojshme, të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve të tij. Mjediset e godinës plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral⁴⁹¹. Për këtë program studimi ka në dispozicion zyra shërbimi, sallat e leksionit /seminareve janë të pajisura me kompjuter, ëhiteboard/smartboard dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike, bibliotekën në godinën e tij dhe atë online në JSTOR, Ebsco, Porquest, Gale⁴⁹² si dhe Emerald, e-biblioteka McGill Hill⁴⁹³ të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore, si klasa, laboratorët, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si ëhiteboard dhe sistem projektimi dixhital, mjete të tjera audio e video. Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja e tyre. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor 2 laboratore informatike dhe bibliotekën. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale duke përdorur dhe platformat elektronike përmes E-Gnomon dhe shërbimin Turnitin për monitorimin e pandershmërisë akademike⁴⁹⁴. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht në web.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme</p>	<p>Të gjithë auditorët janë të pajisur me whiteboard dhe sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video. Në funksion të digjitalizimit i gjithë kampusi është i mbështetur me rrjetet wifi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, skaner etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ. Ndërkohë që janë të</p>

⁴⁹⁰ Evidenca 139. UNYT Space and Facilities.

⁴⁹¹ Evidenca 138. UNYT Relacioni Arkitektonik

⁴⁹² Evidenca 140. UNYT Library facilities.

⁴⁹³ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

⁴⁹⁴ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.




<p>për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>shfrytëzueshme mjediset e punës në bibliotekë dhe në 2 laboratorët e teknologjisë së informacionit me kapacitet prej 35 vende pune. Kjo infrastrukturë krijon të gjitha kushtet për shfrytëzim nga studentët për detyrat e kursit, diploma dhe studime specifike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratorët e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij program studimi, janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe janë të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori i teknologjisë së informacionit ka një kapacitet prej 35 vende pune, si dhe biblioteka që ka një hapësirë prej 215 m² me 48 vende leximi⁴⁹⁵ dhe 2 tavolina pune me 6 përdorues secila, si dhe zonën e kompjuterave me 12 kompjutera në dispozicion të përdoruesve të saj</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Referuar programit të studimit “Master i shkencave” në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkolllore” dhe “Psikologji Ligjore” evidentojmë vetëm 4 institucione që i përshtaten praktikave profesionale si “Linja e këshillimit për gra dhe vajza”, “Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë” i cili nuk ofron shërbime psikologjike për personat me probleme të shëndetit mendor, por monitoron respektimin e standarteve për ushtrimin e profesionit, certifikon, ofron trajnime e kualifikime afarshkurtra për nevojat e psikologëve. Duke iu referuar Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit Social, ka disa institucionet nën varësi si “Qendra Komunitare e Terrenit”, Qendra Multidisiplinare “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë se Bashku”, Qendra Komunitare “Shkozë” dhe Qendra Komunitare “Strehëza” dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pjesa tjetër e institucioneve si “Deloitte Group”, “Ministria e Brendshme”, “Boga Associates”, “Eagles Group Albania”, “Neptun Albania”, “Lufthansa Albania”, “Duapune”, “GIZ-ALBANIA”, “Albtelecom”, “Smartëork” nuk iu përshtaten nevojave të studentëve të fushës së psikologjisë të profileve ligjore, shkolllore e klinike, duke kufizuar bashkëpunimin midis tyre zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p><i>Sugjerojmë njësinë bazë të shtoj marrëveshjet zyrtare të bashkëpunimit për nevojat e programit të studimit dhe të</i></p>

⁴⁹⁵ Evidenca 139. UNYT space and facilities



	<i>dokumentojë praninë e marrëveshjeve me 3 institucionet, ku të përcaktohen qartë kushtet e bashkëpunimit midis palëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UNYT ndodhet në katin e parë dhe ka një hapsirë prej 215 m ² me 48 vende leximi ⁴⁹⁶ , dhe 2 tavolina pune me 6 përdorues secila, si dhe zonën e kompjuterave me 12 kompjutera në dispozicion të përdoruesve të saj. Biblioteka mbulon një sër shërbimesh si arkivim të cdo kopje të libri të ri fizik që hyn, arkivim të punimit të diplomës, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen literaturën mësimore dhe ekstrakurrikulare.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka në total 8.354 kopje fizike, të cilat janë kryesisht në tre kopje të ndara sipas përdoruesve, një për stafin akademin, një kopje për studentët dhe një tjetër për shërbimin e bibliotekës. Fondi i alokuar nga UNYT cdo vit në funksion të blerjeve të reja është 20.000 euro. Për nevojat e njësisë bazë për vitin akademik 2021-2022 janë blerë 22 kopje fizike ⁴⁹⁷ . Biblioteka e UNYT ka një sistem të menaxhimit të librit online, që mundëson organizimin e librave dhe kërkimin e tyre sipas kategorive ⁴⁹⁸ . Platforma lehtëson procesin e kërkesave për të tërhequr libra nga anëtarët. Në platformë gjenden edhe link-et për aksesim në bibliotekat online ndërkombëtare JSTOR, Ebsco, Porquest, Gale ⁴⁹⁹ si dhe Emerald, e-biblioteka McGrill Hill ⁵⁰⁰ . Të gjitha këto platforma janë në funksion të mësimdhënies e mësimnxënies dhe mund të aksesohen lirisht

⁴⁹⁶ Evidenca 139. UNYT space and facilities

⁴⁹⁷ Evidenca 117. UNYT Books report psychology 2021-2022

⁴⁹⁸ Evidenca 139. UNYT space and facilities

⁴⁹⁹ Evidenca 140. UNYT Library facilities.

⁵⁰⁰ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

	nga stafi akademik dhe studentët e UNYT. Gjithashtu ambientet janë në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Kapacitetet e bibliotekës garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit ⁵⁰¹ . Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e UNYT dhe stafin akademik. Për t'u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrin i thjeshtë me një kartë indentiteti dhe një fotografi dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara. Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line. Studentët e këtij program studimi kanë në dispozicion të tyre një sër platformash online, të cilat i aksesojnë pa pagesë.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e UNYT ka një hapsirë prej 215 m ² me 48 vende leximi ⁵⁰² , dhe 2 tavolina pune me 6 përdorues secila, si dhe zonën e kompjuterave me 12 kompjutera në dispozicion të përdoruesve të saj. Biblioteka mbulon një sër shërbimesh si arkivim të cdo kopje të libri të ri fizik që hyn, arkivim të punimit të diplomës, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen literaturën mësimore dhe ekstra kurrikulare. Të gjithë studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë aksesimi pa asnjë kufizim në to.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit duke alokuar një fond të përvitshëm që mund të shfrytëzohet nga stafi akademik dhe njësitë, i cili kap vlerën rreth 20.000euro sipas të dhënave nga zyra e bibliotekës. Literatura në gjuhën angleze, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi në mbështetje të procesit mësimor është e përshtatshme dhe e rinovuar cdo vit nga stukturat përgjegjëse ⁵⁰³ sipas kërkesave të ardhura nga njësia bazë ⁵⁰⁴ . Kjo literaturë është e përshtatshme për tu përdorur për nevojat akademike. Përsa i përket literaturës në formë fizike apo

⁵⁰¹ Evidenca 117. UNYT Books report psychology 2021-2022

⁵⁰² Evidenca 139. UNYT space and facilities

⁵⁰³ Evidenca 117. UNYT Books report psychology 2021-2022

⁵⁰⁴ Evidenca 118. Request for books.

	elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se praktika e ndjekur nga institucioni është tepër pozitive si në drejtim të blerjes së librave fizik në 3 kopje (Amazon Global Store) që depozitohen në bibliotekën e UNYT, por edhe përmes abonimit në bibliotekat online.								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka qëndron e hapur cdo ditë nga ora 09.00 – 20.00, dhe dita e shtunë me orar pak më të kufizuar. Zakonisht këto orare janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, duke krijuar në këtë mënyrë kushte optimale për akses tek fondi i saj në cdo kohë që iu nevojitet. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Në përmbushje</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon disa platforma për menaxhimin e informacionit të universitetit ⁵⁰⁵ . UNYT ka një sistem dixhital (online), Gnomon Software, Platforma (ProProfs) e UNYT e-scholarship Exam ⁵⁰⁶ (ofron opsionin e testimit, vlerësimin online) që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, syllabuset e lëndëve, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, njoftimetë ndryshme etj. Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve e-Gnomon mbulon aspektin akademik, administrative dhe financiare të studentëve. Gjithashtu, për komunikimin e brendshëm përdoret Outlook-

⁵⁰⁵ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

⁵⁰⁶ Evidenca 125. UNYT e-exam platform 2020.



	Office 365, që sigurohet përmes emailit të personalizuar sipas domain-it të universitetit. (emër.mbiemër@unyt.edu.al).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	I gjithë komunikimi në UNYT mundësohet përmes rrjetit privat të brendshëm të tij ⁵⁰⁷ . Përmes këtij sistemi ndahen në mënyrë të sigurt informacionet e univeristetit dhe burimet kompjuterike prej nga nisen këto informacione. Platformat Outlook- Office 365, Gnomon Software, Platforma (ProProfs), Turnitin mundësojnë lehtësimin e punës në grupe e bashkërendimin e saj, telekonferencat, aksesimi lehtësisht i informacioneve të rëndësishme, link-et, aplikacionet, të dhëna nga rekordet e databases së UNYT.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Platformat Outlook- Office 365, Gnomon Software, Platforma (ProProfs), Turnitin janë sisteme të menaxhimit të brendshëm që përdoren nga stafi dhe studentët por edhe struktura të tjera që lehtësojnë komunikimin dhe funksionimin e procesit mësimor dhe administrative lidhur me programet e studimit që ofron. Këto shërbime ruajnë anonimatit e përdoruesve dhe krijojnë mundësi për marrjen e informacionit në kohë reale.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformat elektronike ⁵⁰⁸ të cilat sigurojnë akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, aksesit i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin, por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta. Çdo pedagog mund të shoh vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë materialet e lëndëve përkatëse.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për	Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po

⁵⁰⁷ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

⁵⁰⁸ Evidenca 146. UNYT It support services, Alb.

organet drejtuese dhe titullarët.	ashtu, institucioni ruan komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen zyrtare të UNYT www.unyt.edu.al paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organikogramën; guidat për studentët e ardhshëm të universitetit si dhe mbi programet, së bashku me bio të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, UNYT promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	University of Neë York Tirana sh.p.k. është regjistruar si shoqëri me kapital të zotëruar 100% nga Turkiye Maarif Vakfi (Fondacioni Turk Maarif). University of New York Tirana sh.p.k. zhvillon veprimtarinë e saj në fushën e mësimdhënies për nivelet, universitare dhe pasuniversitare. Pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri, janë përgatitur në Lekë (monedha Shqiptare) ^{509, 510} . GVJ konstatoi që plani i financimit të UNYT hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore dhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimet që do përdoren. UNYT harton pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit ^{511, 512} .

⁵⁰⁹ Evidenca 159. UNYT Raporti i Auditimit UNYT 2020.

⁵¹⁰ Evidenca 157. UNYT Raporti i Auditimit University of Neë York Tirana shpk.

⁵¹¹ Evidenca 161. UNYT Pasqyra financiare 2020.

⁵¹² Evidenca 160. UNYT Pasqyra financiare + shënime 31.12.2020- UNYT.

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programeve të studimit⁵¹³ përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financimi i UNYT është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre. Në këtë plan financiar përfshihen shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të veprimtarive dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren⁵¹⁴.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm⁵¹⁵, bazuar në informacionin e paraqitur në ASCAL dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm si dhe auditim të jashtëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare^{516, 517}. Zyra e Auditit të brendshëm është njësi administrative e ngritur dhe funksionale brenda institucionit e cila ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm.</p>

⁵¹³ Evidenca 159. UNYT Raporti i Auditimit UNYT 2020.

⁵¹⁴ Evidenca 157. UNYT Raporti i Auditimit University of Neë York Tirana shpk.

⁵¹⁵ Evidenca 159. UNYT Raporti i Auditimit UNYT 2020.

⁵¹⁶ Evidenca 161. UNYT Pasqyra financiare 2020.

⁵¹⁷ Evidenca 160. UNYT Pasqyra financiare + shënime 31.12.2020- UNYT.



ndarjen e burimeve financiare.									
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në lidhje me raportin financiar për veprimtarinë akademike ⁵¹⁸ , ⁵¹⁹ evidencat tregojnë që institucioni ka burime në dispozicion për financimin e programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Gjatë vizitës në institucion na u paraqit procedura që ndjek institucioni. Ai përmes departamentit studion tregun e punës, nëse ka pritshmëri për të ardhmen dhe bën një plan biznes. Nëse pritshmëritë janë të larta atëherë programi i studimit mbështetet financiarisht. Pritshmëritë ishin pozitive dhe ishte marrë vendimi për ta mbështetur këtë program studimi.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Sipas raportit të planit financiar të veprimtarive të UNYT dëshmohet një qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të përmirësimit në të gjitha aspektet, veprimtarinë e institucionit me qëllim rritjen e cilësisë akademike. Hartimi i një raporti në lidhje me transparencën financiare i jep mundësi institucionit të ketë një opinion ligjor të pavarur mbi pasqyrat financiare në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe investimit të parësë.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

⁵¹⁸ Evidenca 159. UNYT Raporti i Auditimit UNYT 2020.

⁵¹⁹ Evidenca 157. UNYT Raporti i Auditimit University of Neë York Tirana shpk.




Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik ⁵²⁰ të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve ⁵²¹ fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqet në faqen e webit të UNYT.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe vizitës në institucion GVJ konstaton se institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurat nga hyrja në dalje ⁵²² , për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me rregulloren e programit të studimit duke siguruar të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim ^{523, 524, 525} janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme të këtij institucioni. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të	Në faqen zyrtare të institucionit janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që

⁵²⁰ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

⁵²¹ Evidenca 162. UNYT SAO Rules & Regulations

⁵²² Evidenca 162. UNYT SAO Rules & Regulations

⁵²³ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

⁵²⁴ Evidenca 164. UNYT Admissions Application form

⁵²⁵ Evidenca 168. UNYT Admissions Office Action Plan 2020-2021.



mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	lidhen me transferimin ⁵²⁶ njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e UNYT mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	UNYT në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit bën miratimin e kriterëve të pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë ⁵²⁷ , dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit ^{528, 529} duke përdorur faqen zyrtare të webit dhe faqen zyrtare në facebook etj. Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UNYT. Format me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin e studimit janë të shumta si këshillimi në ambjentet e UNYT gjatë periudhës së regjistrimeve, dërgimi i ftesave në emaillet, rrjete sociale, faqen zyrtare, broshurat informuese etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të	Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik

⁵²⁶ Evidenca 42. UNYT Politika e transferimit të studimeve, Alb.

⁵²⁷ Evidenca 165. UNYT Senate Decisions on Admission Criteria and Quotes 2019.

⁵²⁸ Evidenca 168. UNYT Admissions Office Action Plan 2020-2021.

⁵²⁹ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit ⁵³⁰ dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik ⁵³¹ , ⁵³² lehtësojnë njohjen e studentit me kriteret e procedurat e përparimit akademik të tyre nga një vit akademik në tjetrin ⁵³³ ; ⁵³⁴ .
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet procesi i pritjes dhe orientimit të kandidatëve, i cili është i përvitshëm në UNYT ⁵³⁵ . Gjatë kësaj jave në hollin e institucionit vendosen vende pritje realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve ⁵³⁶ dhe procedurave administrative. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit ⁵³⁷ .
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UNYT ka procedura të unifikuara për të gjithë njësitë e tij, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të sylabusit të lëndës dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Pedagogu i lëndës por edhe njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit të studimit përgjatë fazës së parë të regjistrimit, fillimit të semestrit, në javën orientues në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve ⁵³⁸ . Udhëzimi në lidhje me strukturën e temës së diplomës u vihen në dispozicion studentëve në fillim të semestrit të dytë.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Njësia bazë që ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” bazuar në rregulloret ⁵³⁹ , ⁵⁴⁰ dhe udhëzimin për punimin e temës së diplomës, ka hartuar procedurë të posaçme ⁵⁴¹ për studentët, të cilët mbrojnë diplomën. Kriteret për mbrojtje diplome me temë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes njësisë bazë që zhvillon programin. Njësia bazë ka një

⁵³⁰ Evidenca 20. Rregullore e programit.

⁵³¹ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

⁵³² Evidenca 168. UNYT Admissions Office Action Plan 2020-2021.

⁵³³ Evidenca 109. Instructors handbook- Alb.

⁵³⁴ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

⁵³⁵ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

⁵³⁶ Evidenca 169. UNYT Foreign Students Guidelines.

⁵³⁷ Evidenca 164. UNYT Admissions Application form

⁵³⁸ Evidenca 171. UNYT Student Access to e-Gnomon.

⁵³⁹ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁵⁴⁰ Evidenca 20. Rregullore e programit.


⁵⁴¹ Evidenca 109. UNYT Msc in Psychology master Thesies Guidline and App Form Sylabi.



	format të posaçëm për realizimin vlerësimit sipas ndarjes në disa komponentë. Gjithashtu, përmes sistemit Turnitin bëhet edhe kontrolli i autenticitetit të materialit të paraqitur nga studenti. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësi bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e seancave të konsultimit individuale përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit, si dhe të nënshkrimit nga pedagogu udhëheqës të punimit final para se të dorëzohet te komisioni i mbrojtjes.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi. Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo fillim viti akademik UNYT organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje ⁵⁴² . Format si; njoftimet në faqen zyrtare të web, rrjetet sociale, stendat e Universitetit dhe guidës së studentit ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar. Gjithashtu, UNYT merr pjesë në panairët e karrierës. Zyra e pranimit dhe regjistrimit organizon çdo fillim viti ditët e orientimit, gjatë të cilave studentët njihen mbi programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes një morie formash. Duke nisur me informacionin në faqen online të UNYT, përmes kontratës që nënshkruajnë, informacionit që merr nga zyra e pranimit dhe regjistrimit, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullores mësimore të

⁵⁴² Evidenca 162. UNYT SAO Rules & Regulations



	programit të studimit. Këto janë të gjitha forma të cilat ndihmojnë studentët të kenë akses në informacionin e nevojshëm lidhur me këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së rregjistrimit, gjatë ditëve të orientimit, njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Rekrutimit, Pranimin dhe Rregjistrimit, Zyrën e Dekanit të Studentëve, Zyrën e Karrierës etj. Gjithashtu duke përdorur platformat digjitale studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semestrit dhe vitit akademik. Syllabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Staf akademik ⁵⁴³ i caktuar në rolin e këshilluesit përgjatë semestrit dhe udhëzuesit e mësimdhënies ⁵⁴⁴ , përbushin nevojat për informacion të detajuar lidhur me programin e studimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka në dispozicion të nevojave profesionale të studentëve një sër zyrash që bashkërendojnë punën me njëra tjetrën si Zyrën e Rekrutimit, Pranimin dhe Rregjistrimit ⁵⁴⁵ , Zyrën e Dekanit të Studentëve, Zyrën e Karrierës ⁵⁴⁶ , zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjithashtu, në UNYT realizohen trajnime të ndryshme mbi aftësimin me shprehi për kërkimin e punës. Një sër mundësish u ofrohen studentëve për mobilitete, inteshipe, tajnime dhe konferenca ^{547, 548, 549, 550, 551} synojnë të mbështesin studentët drejt përvojave të ndryshme profesionale.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i	Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor si

⁵⁴³ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

⁵⁴⁴ Evidenca 109. Instructors handbook- Alb.

⁵⁴⁵ Evidenca 162. UNYT SAO Rules & Regulations

⁵⁴⁶ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

⁵⁴⁷ Evidenca 71. UNYT. Internship Placement of internship students first cohort.

⁵⁴⁸ Evidenca 36. UNYT International Student-Congress 2020.

⁵⁴⁹ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁵⁵⁰ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolapship- Poster.

⁵⁵¹ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.



<p>gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>udhëzuesi i mësimdhënies⁵⁵², këshilluesi akademik⁵⁵³, udhëzuesi për punimin e diplomës⁵⁵⁴,⁵⁵⁵ udhëheqësi shkencorë etj. Logjistika infrastrukturore dhe shërbimet në funksion të realizimit të mësimdhënies përfshijnë sistemit të informacionit online (eGnomon) sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogët e lëndës. Ky software mbështet punën e një sër strukturash si zyrën e rekrutuesve duke vijuar me zyrën e regjistrimit dhe financave deri në diplomim. Posta elektronike e UNYT përmes Outlook-office 365.edu, ku të gjithë anëtarët e stafit dhe studentëve kanë llogarinë e tyre postare, shërbimi Turnitin është një shërbim për studentët dhe stafin për t'u shfrytëzuar për nevojat e tyre akademik</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit⁵⁵⁶ mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit të UNYT. Institucioni përdor disa platforma për nevojat e procesit mësimorë të stafit dhe studentëve si e-Gnomon, Outlook-office 365.edu, Turnitin, ProProof e-exam. Këto platforma përdoren për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, syllabuset e lëndëve materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, njoftimetë ndryshme etj. Sistemi i i menaxhimit të të dhënave të studentëve e-Gnomon mbulon aspektin akademik, administrative dhe financiare të studentëve.</p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>UNYT siguron informacion të arritshëm edhe në distancë për studentët me anë të: faqes zyrtare të webit, komunikimi në vijimësi në nivel departamenti, njoftimi përmes platformës e-Gnomon, Outlook-office 365.edu, Turnitin, ProProof e-exam si dhe njoftimeve në rrjetet sociale. Përmes platformës on-line, institucioni ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale.</p>

⁵⁵² Evidenca 109. UNYT Instructor's Handbook -Alb.

⁵⁵³ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

⁵⁵⁴ Evidenca 122. UNYT Final Exam Communication.

⁵⁵⁵ Evidenca 125. UNYT e-exam platform 2020.

⁵⁵⁶ Ev 42. Relacioni për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit.	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të regjistruar dhe cilësinë në dalje. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program të ri studimi, aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2020-2021, konstatojmë se numri i studentëve të regjistruar është i ulët, dhe përgjatë vitit pasardhës situata ka një rritje të vogël por sërisht e pamjafueshmë për të justifikuar hapjen e një grupi mësimor.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për dy vitet akademike është:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 - 3 studentë</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 - 6 studentë; (1 student ka pezulluar studimet)⁵⁵⁷</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Ajo çfarë vihet re duke u bazuar tek stasiskat është se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë është 3 studentë të regjistruar për vitin akademik 2020-2021 dhe 6 studentë për vitin akademik 2021-2022. Ndërsa numri i studentëve që kanë pezulluar studimet përkohësisht rezulton 1 student për vitin akademik 2021-2022.</p>

⁵⁵⁷ Evidenca 53. Tabelat Përmbledhëse për aneks- RVB.

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë 2 viteve akademike në të cilat programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” ka zhvilluar veprimtarinë. Të dhënat fokusohen në numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, student të transferuar sipas viteve në fashën e 2 viteve. Referuar statistikës kemi një rritje të notës mesatare në dalje për studentët e këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Zyra që merret me regjistrimin e studentëve, sekretaria mësimore janë strukturat e posaçme që merren me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre e kryejnë edhe përmes e-Gnomon që përdoret për menaxhimin e rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik të rregjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e UNYT. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Referuar raportit të departamentit⁵⁵⁸ mbi punën e tij për vitin akademik 2020-2021 ka një qëndrim pozitiv mbi vijimësinë e këtij programi dhe gjithashtu shihet si tregues pozitiv interesimi i studentëve që ndikon në prurje me cilësi. Edhe pse hapja e këtij programi në kushtet e pandemisë kanë ndikuar në reduktimin e numrin të studentëve⁵⁵⁹. Duke qenë se ky është një program i ri, departamenti nuk disponon evidenca fillestare mbi shkallën e punësimit të tyre. Referuar këtyre të fundit, akoma nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

⁵⁵⁸ Evidenca 191. UNYT Annual Monitoring Report.
⁵⁵⁹ Evidenca 53. Tabelat Përmbledhëse për aneks- RVB.



Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse⁵⁶⁰; ⁵⁶¹ si Senatin Akademik, Komisioni e Sigurimit të Cilësisë⁵⁶², Grupin e Vlersimit të Brendshëm, Këshillin e Etikës si dhe në Këshillin e Studetëve, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UNYT. Përfshirja e studentëve në një sër strukturash⁵⁶³, vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren⁵⁶⁴ dhe statutin⁵⁶⁵ e vetë IAL-it.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari⁵⁶⁶. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik, studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve⁵⁶⁷ dhe përmes takimeve në grup.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi⁵⁶⁸ është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Ka rregulloren⁵⁶⁹ dhe procedura që</p>

⁵⁶⁰ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

⁵⁶¹ Evidenca 15. Rregullore e Universitetit.

⁵⁶² Evidenca 182. UNYT Action Plan, Senate Decision, Minutes of QAC.

⁵⁶³ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁵⁶⁴ Evidenca 15. Rregullore e Universitetit.

⁵⁶⁵ Evidenca 5. UNYT Statuti 2020.

⁵⁶⁶ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁵⁶⁷ Evidenca 194. Student evaluation form.

⁵⁶⁸ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁵⁶⁹ Evidenca 20. Rregullore e programit.



<p>parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme të realizuara më parë ose më pas nga studenti. Grupi i Vlerësimit të jashtëm konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve, Statutin e UNYT dhe rregulloret përkatëse, parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre. Duke iu referuar përvojës së UNYT, një sër procedurash synojnë të mbështesin këtë proces si takime me studentët mbi kurrikulën mësimore, përmes formularëve që plotësojnë përgjatë semestrave por edhe përmes takimeve me to nga njësisia bazë dhe përmes rolit të këshilluesit akademik. Gjithsesi, duke qenë se ky program studimi nuk ka shumë vite që është hapur gjykohet se është herët për të vlersuar këtë aspekt. Një tjetër aspekt që lidhet me përfshirjen e tyre është edhe takimi i njësisë bazë me student e pedagogë mbi cilësinë në mësimdhënie.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Studentëve të UNYT u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve⁵⁷⁰, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit⁵⁷¹. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6

⁵⁷⁰ Evidenca 19. Department Rules and Regulations, Alb.

⁵⁷¹ Evidenca 20. Rregullore e programit.



Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Pjesmarrja e personelit akademik në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor dhe mobiliteteve shihen me ndikim pozitiv. Këto të dhëna dokumentohen dhe përfshihen në evidence që mund të përdoren për nevoja të ndryshme nga ana e institucionit. Personeli akademik i Departamentit të Psikologjisë është i angazhuar në implementimin e një sërë aktiviteteve kërkimore - shkencore. Kjo klimë ka ndikim pozitiv jo vetëm në drejtim të rritjes së kapaciteteve njerëzore të institucionit por edhe të cilësisë në mësimdhënie</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>UNYT disponon një numër të konsiderueshëm evidencash lidhur me bashkëpunimet me institucionet homologe ndërkombëtare⁵⁷² lidhur me bashkëpunimin për projekte të përbashkëta universitare^{573,574,575} përmes Erasmus + dhe Mevlana⁵⁷⁶, si dhe për mobilitetin e stafit dhe të studentëve të tij^{577, 578}. Lektorë të ftuar dhe student kanë qenë pjesë e leksioneve të hapura me profesor të ftuar vendas dhe të huaj, ëorkshop-e⁵⁷⁹, konferenca, projekte të zbatuara në shkallë departamenti, aktivitete shkencore të organizuara nga departamenti që janë me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Një sërë projektesh janë ndërmarrë dhe vijojnë të zbatohen në fushën e shkencave shoqërore ku janë të përfshirë anëtarë të stafit akademik, duke kontribuar në drejtim të rritjes profesionale dhe eksperiencave të mira nga bashkëpunimet me profesionistët ndërkombëtarë Gjithashtu, në drejtimin e trajnimeve profesionale të ofruara për stafin e studentët alumnit (ish student) e UNYT kanë</p>

⁵⁷² Evidenca 26. UNYT List of International Universities – MoU.

⁵⁷³ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

⁵⁷⁴ Evidenca 34. IBU- Albania – Erasmus Agreement.

⁵⁷⁵ Evidenca 28. UNYT Erasmus Day-University of Nër York Tirana,

⁵⁷⁶ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁵⁷⁷ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁵⁷⁸ Evidenca 33. UNYT EUA Membership Activation.

⁵⁷⁹ Evidenca 39. UNYT Training and Ëorkshop 2020.



	marrë pjesë në mobilitete të ndryshme si trajnime, mësimdhënie etj. të financuar nga Erasmus + ^{580,581,582} .			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Personeli akademik i programit të studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” motivon studentët të angazhohen në hulumtime dhe projekte kërkimore, konferenca ^{583,584} , të shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore për të cilat bashkëpunojnë në kuadër të temës së diplomës apo projekte të lëndëve të vecanta. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme që synojnë fitimin e kompetencave për të realizuar kërkim shkencor duke bashkëpunuar me udhëheqësit e tyre shkencor. Motivohen dhe mbështeten për të marrë pjesë në konferencat e aktivitetet promovuese, të cilat janë të përvitshme në UNYT.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Personeli akademik dhe studentët angazhohen në një sërë projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare sipas dokumentacionit të shqyrtuar. Kemi evidence të dukshme lidhur me mbështetjen e stafit akademik në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, në të cilat krijohen kushte për përfshirjen e studentëve në procese të caktuara pune përgjatë fazës së implementimit të tyre. Megjithatë kemi pak evidence për të gjykuar në terma realë lidhur me përfitimin e tyre në këtë aspekt.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Personeli akademik ka një rol aktiv përgjatë gjithë këtij procesi duke mbështetur studentët në gjenerimin e ideve dhe përzgjedhjen e fushës së tyre kërkimore, ofron asistencën e nevojshme për përcaktimin e metodologjisë së punës dhe kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës. Ky rol diktohet edhe nga rregullorja e diplomimit ⁵⁸⁵ dhe monitorohet nga strukturat e njësisë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁵⁸⁰ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁵⁸¹ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolaprrship- Poster.

⁵⁸² Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁵⁸³ Evidenca 36. UNYT International Student-Congress 2020.

⁵⁸⁴ Evidenca 103. UNYT Program of the event ëith international university and organization.

⁵⁸⁵ Evidenca 109. UNYT Msc in Psychology master Thesies Guidlime and App Form Sylabi.



Standardi V.7**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare ⁵⁸⁶ dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe regulloren e institucionit, në UNYT ka njësi kërkimore dhe projektsh sic është “European and Balkan Research Institute Center”, i cili ka nën varësi 3 qendra me fokus në përthithjen dhe implementimin e projeteve kombëtare e ndërkombëtare sipas fushave të kërkimit shkencor “Research, Project and Innovation Center”, “Balkan Research Center”, dhe “European Research Center” ⁵⁸⁷ . Ky institut ka implementuar 6 projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ⁵⁸⁸ . Në realizimin e këtyre projekteve janë përfshirë pedagogë të njësisë kryesore dhe bazë, gjithashtu edhe studentët. Instituti shërben si një strukturë ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme të cilët aplikojnë për projekte, Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në bashkëpunimet me institucionet kombëtare e ndërkombëtare përmes të cilave ka arritur të krijoj mundësi për mobilitetin e stafit akademik ^{589,590,591} zhvillimin e leksioneve të hapura ^{592, 593} dhe u kanë dhënë mundësi studentëve të jenë pjesmarrës në një sër aktiviteteve ndërkombëtare ku UNYT ka qenë partner/ pjesmarrës.
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri	UNYT disponon një numër të konsiderueshëm evidencash lidhur me bashkëpunimet me institucionet homologe ndërkombëtare ⁵⁹⁴ lidhur me bashkëpunimin për projekte të përbashkëta universitare ^{595,596,597} përmes Erasmus + dhe Mevlana ⁵⁹⁸ , si dhe për

⁵⁸⁶ Evidenca 26. UNYT List of International Universities – MoU.

⁵⁸⁷ Academic Staff. <https://unyt.edu.al/index.php/faculty/> (Aksesuar më 04.09.2022)

⁵⁸⁸ Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

⁵⁸⁹ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

⁵⁹⁰ Evidenca 34. IBU- Albania – Erasmus Agreement.

⁵⁹¹ Evidenca 28. UNYT Erasmus Day-University of Nër York Tirana,

⁵⁹² Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁵⁹³ Evidenca 33. UNYT EUA Memebership Activation.

⁵⁹⁴ Evidenca 26. UNYT List of International Universities – MoU.

⁵⁹⁵ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

⁵⁹⁶ Evidenca 34. IBU- Albania – Erasmus Agreement.

⁵⁹⁷ Evidenca 28. UNYT Erasmus Day-University of Nër York Tirana,

⁵⁹⁸ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.



dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	mobilitetin e stafit dhe të studentëve të tij ⁵⁹⁹ ; ⁶⁰⁰ . Lektorë të ftuar dhe student kanë qenë pjesë e leksione të hapura me profesor të ftuar vendas dhe të huaj, workshop-e ⁶⁰¹ , konferenca, projekte të zbatuara në shkallë departamenti, aktivitete shkencore të organizuara nga departamenti që janë me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit Msc. në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”. Kjo përvojë profesionale shënon një moment të rëndësishëm të rritjes së kompetencave personale në drejtim të përdorimit të metodave të kërkimit nga studentët që u siguron vijueshmëri dhe përgatitje për ciklin e tretë të studimeve.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Një sër projektesh janë ndërmarrë dhe vijojnë të zbatohen në fushën e shkencave shoqërore ku janë të përfshirë anëtarë të stafit akademik, duke kontribuar në drejtim të rritjes profesionale dhe eksperiencave të mira nga bashkëpunimet me profesionistët ndërkombëtarë. Gjithashtu, në drejtimin e trajnimeve profesionale të ofruara për stafin e studentët alumnit (ish student) e UNYT, si trajnime, mësimdhënie të financuar nga Erasmus + ⁶⁰² , ⁶⁰³ , ⁶⁰⁴ .
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Fryma e bashkëpunimit me institucionet e huaja shihet në aktivitetet e ndërmarrë në kuadër të lehtësimit të mobilitetit të personelit akademik ⁶⁰⁵ , ⁶⁰⁶ , ⁶⁰⁷ për të krijuar eksperiencia profesionale jashtë ⁶⁰⁸ , ⁶⁰⁹ , ⁶¹⁰ , por gjithashtu kemi edhe akses për stafin akademik të huaj në UNYT përmes organizimit të orëve të hapura, organizimit të konferencave të përbashkëta shkencore, trajnimeve, mësimdhënies ⁶¹¹ , ⁶¹² , ⁶¹³ , ⁶¹⁴ lehtësuar edhe nga ofrimi i programeve në gjuhën angleze. Gjithashtu, tregues të matshëm në këtë drejtim duhen konsideruar bashkëpunimet në projekte të

⁵⁹⁹ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁶⁰⁰ Evidenca 33. UNYT EUA Membership Activation.

⁶⁰¹ Evidenca 39. UNYT Training and Workshop 2020.

⁶⁰² Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁶⁰³ Evidenca 49. UNYT YTB- Schoolarship- Poster.

⁶⁰⁴ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁶⁰⁵ Evidenca 93. UNYT; Masterclass training in Lithuania,

⁶⁰⁶ Evidenca 207. UNYT Staff Training

⁶⁰⁷ Evidenca 95. UNYT Notification from member of the department

⁶⁰⁸ Evidenca 34. IUB-Albania Erasmus -Agreement.

⁶⁰⁹ Evidenca 126. UNYT Erasmus teaching eek – internationalization of teaching

⁶¹⁰ Evidenca 127 UNYT Erasmus A. Halimi.

⁶¹¹ Evidenca 96. UNYT Training EU for Innovation.

⁶¹² Evidenca 83. UNYT Chief Panelists – invitation B. L.

⁶¹³ Evidenca 85. UNYT Panelists Cenko A. & Lahi B.

⁶¹⁴ Evidenca 69. UNYT Invitation of a company from EPPC

	përbashkëta ⁶¹⁵ që realisht krijon një mundësi reale për kërkuesit e huaj, ku UNYT ka zhvilluar të tilla.			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Institucioni ka ndjekur një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve ⁶¹⁶ që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare të zhvilluar në ambjentet e UNYT dhe jashtë si pjesëmarrja ⁶¹⁷ në trajnime dhe leksion të hapur, workshop e konferenca ^{618, 619} , vizita ^{620, 621} , etj. Të gjitha këto aktivitete janë në mbështetje të nevojave të studentëve për t'u njohur dhe për të krahasuar cilësinë e mësimdhënësit dhe të kërkuesit shkencor.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Institucioni e ka nisur rrugëtimin e tij mbështetur në bashkëpunim me State University of New York/ Empire State College (SUNY)/ESC në SHBA, me qëllim zhvillimin e programeve të përbashkëta, marrjen e diplomës së dyfishtë. Por pas ndyshimeve të fundit të aksionerëve duhet parë sesi do të vijojë ky bashkëpunimin për të rritur profilin ndërkombëtar. Një sër veprimtarish kërkimore-shkencorë janë zhvilluar si mësimdhënie, personel akademik të huaj kryesisht në kuadër të projekteve Erasmus +, por përsa i përket studentëve të huaj, në përgjithësi infrastruktura në universitetet të lejon mundësinë e shfrytëzimit të këtyre politikave të Bashkimit Evropian që promovon ndërkulturalitetin dhe motivon studentët dhe stafin të shkëmbejnë përvoja dhe eksperiencia midis tyre, kjo edhe e ndikuar nga fakti që universiteti i ofron kurset në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

⁶¹⁵ Evidenca 81. UNYT EU Helath Issue -University of Neë York Tirana

⁶¹⁶ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁶¹⁷ Evidenca 202. UNYT EQAF – Student engagement Contribution QA Training.

⁶¹⁸ Evidenca 52. Spring 2022. Erasmus Income Students- Psychology.

⁶¹⁹ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁶²⁰ Evidenca 24. UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.

⁶²¹ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UNYT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve sic është Njësia Bazë, Zyra e Dekanit të Studentëve⁶²², Zyra e Karrierës⁶²³, Zyra e Marrëdhënieve me Studentët etj. Këto struktura ofrojnë një sër shërbimesh për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në UNYT dhe vijnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj. Strukturat në shërbim të studentëve nga hyrja në dalje, të informimit, trajnimit dhe mbështetjes në punësim janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Njësia Bazë, Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Rregjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Karrierës janë zyra të posaçme që mbulojnë shërbimet e ndryshme që u nevojiten studentëve nga hyrja deri në dalje. Megjithatë Zyra e Karrierës i vijnë bashkëpunimet më tej përmes mbështetjes së Alumnit në lidhje me trajnime, intershipe dhe ofertat e punës. Informimi i studentëve, këshillimi i tyre në faza të ndryshme të ndjekjes së studimeve në UNYT, ndjekjen dhe përparimin e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, stafi akademik e realizon përmes rolit të këshilluesit akademik⁶²⁴ dhe duke u mbështetur në udhëzuesin e mësimdhënies⁶²⁵.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën</p>	<p>UNYT u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Karrierës specifikisht njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Këto aktivitete orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes</p>

⁶²² Evidenca 154. UNYT Rukes and Regulations of Dean of students.

⁶²³ Evidenca 152. UNYT Rules and Regulations Academic Support center and counseling

⁶²⁴ Evidenca 173. UNYT Detyrat e pedagogut udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.

⁶²⁵ Evidenca 109. Instructors handbook- Alb.



profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura ^{626, 627} , lektorë të ftuar ⁶²⁸ janë pjesë e promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e saj ^{629, 630, 631} .								
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Karrierës është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të UNYT që ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektiv të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë me qëllim që të lehtësojë intinerarin e kalimit nga shkolla në punë përpiqet të shfrytëzojë asetet e saj si mundësitë për mobilitete, intershipe, trajnime, institutin e projekteve dhe panaiet e punës. Ky program studimi duke qenë i ri, monitorimi i etapave të kalimit nga shkolla në punë duhet parë në vijimësi.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1

⁶²⁶ Evidenca 23. List of Agreements and MoU.

⁶²⁷ Evidenca 29. UNYT Open Call Mobility Program.

⁶²⁸ Events. <https://unyt.edu.al/index.php/category/events/> (Aksesuar më 09.09.2022)

⁶²⁹ Evidenca 61. UNYT Study visit Autism center.

⁶³⁰ Evidenca 62. UNYT Study visit on psychological testing at Municipality of Tirana (Zyra e karrierës).

⁶³¹ Project & Research. <https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/> (Aksesuar më 04.09.2022)

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë^{632, 633} si strukturë mbështetëse të UNYT. Institucioni ka miratur “Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë të Institucionit”, i cili është një komision i përhershëm që do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme⁶³⁴. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë⁶³⁵.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Struktura e Njësisë së Kurrikulave⁶³⁶ dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë⁶³⁷ janë njësi të pavarura në nivel institucional që ka si qëllim monitorimin, vlerësimin, dhe zhvillimin e përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së UNYT. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka nxitur punën që kurrikula të harmonizohet me ligjet e reja për arsimin e lartë. Kjo veprimtari është realizuar përmes vlerësimit të programeve të studimit me qëllim që të harmonizohen sipas ligjeve të reja. ⁶³⁸ Departamentet kanë pasur rolin kryesor në përcaktimin e përmbajtjes së programeve të studimit, punë e cila monitorohet në vijimësi nga zyra e kurrikulës dhe zyra e zhvillimit të cilësisë. Nuk kemi evidencë për përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në këtë proces.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet</p>	<p>Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi. Bazuar në</p>

⁶³² Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶³³ Evidenca 162. UNYT SAO Rules & Regulations

⁶³⁴ Evidenca 182. UNYT Action plan, senate decision, minutes of QAC

⁶³⁵ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶³⁶ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

⁶³⁷ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶³⁸ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.

<p>përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UNYT i kushton një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët⁶³⁹, stafin akademik⁶⁴⁰, takimet në grup⁶⁴¹, ⁶⁴² për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit⁶⁴³ synon të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndër - kombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, koordinatoret dhe senati akademik. Departamenti harton në mënyrë periodike një raport për ecurinë e vlerësimit të programit⁶⁴⁴, ku paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësimet në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj. Njësia e sigurimit të cilësisë duke bashkëpunuar me njësinë bazë realizojnë një sër veprimtarish në drejtim të inkurajimit në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie si vlersimin nga studentët⁶⁴⁵, vlerësimin e performancës⁶⁴⁶ vetvlerësimin⁶⁴⁷ dhe vlerësimin nga eprori i njësisë bazë/kryesore⁶⁴⁸ që synojnë të monitorojnë procesin e mësimdhënies.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁶³⁹ Evidenca 194. Student evaluation form.

⁶⁴⁰ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁶⁴¹ Evidenca 196. Individual Performace Assesment form 2021.

⁶⁴² Evidenca 71. UNYT Internship placement of intership students first cohort.

⁶⁴³ Evidenca 182. UNYT Action plan, senate decision, minutes of QAC

⁶⁴⁴ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁶⁴⁵ Evidenca 194. Student evaluation form.

⁶⁴⁶ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁶⁴⁷ Evidenca 196. Individual Performace Assesment form 2021.

⁶⁴⁸ Evidenca 71. UNYT Internship placement of intership students first cohort.

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Institucioni përmes disa njësive si Zyrës së Sigurimit të Cilësisë ⁶⁴⁹ , Zyrës së Kurrikulës ⁶⁵⁰ dhe njësisë bazë ⁶⁵¹ synojnë promovimin e vazhdueshëm të mësimdhënies duke hartuar plane veprimi ⁶⁵² dhe koordinuar punën midis tyre.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, në funksion të kësaj çështje është hartuar edhe një udhëzues për metodat në mësimdhënie ⁶⁵³ . Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Përmes raportit të vlerësimit të studentëve ⁶⁵⁴ , i cili lejon mbledhjen e një informacioni të detajuar mbi një sërë aspektesh të lidhura me procesin mësimorë dhe mësimdhënësit, vlerësimin e performancës ⁶⁵⁵ vetvlerësimin ⁶⁵⁶ dhe vlerësimin nga eprori i njësisë bazë ⁶⁵⁷ .
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVI dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, të përcaktuar në planin e punës që përfshin monitorimin në disa fusha si Procesin mësimor; Kurrikulën, Licensimet, Akreditimet dhe Vlerësimet e departamenteve; Kërkimin shkencor, Vlerësimin e studentëve, etj. Gjithashtu, edhe përmes

⁶⁴⁹ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶⁵⁰ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

⁶⁵¹ Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.

⁶⁵² Evidenca 182. UNYT Action plan, senate decision, minutes of QAC

⁶⁵³ Evidenca 208. UNYT Teaching and Learning strategy, Eng.

⁶⁵⁴ Evidenca 194. Student evaluation form.

⁶⁵⁵ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁶⁵⁶ Evidenca 196. Individual Performance Assessment form 2021.

⁶⁵⁷ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

	<p>metodave të tërthorta si Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit). Takime në grup (në fund të vitit), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës. Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet e cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pas realizimit të procesit monitorues, harton një draft-raport, i cili u përcillet departamenteve për reflektim. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve. Procedura që ndiqet është e tillë që pas përfundimit dhe mbledhjes së të dhënave informacioni/raporti i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësie bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Këto diskutohen dhe në mbledhje të Senatit Akademik.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në planin e punës së kësaj njësie dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Na</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” kryhet në përfundim të çdo viti akademik dhe ky proces përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë. Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me KSBC⁶⁵⁸. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Në nivel departamenti është ngritur Grupi i vlerësimit të brendshëm me qëllim hartimin e një raport vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion ⁶⁵⁹ në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, UNYT përdor metoda të drejtpërdrejta, rishikim të raporteve të akreditimit të programeve të mëparshme, shkrimi i raporteve të programeve të reja, ngritjen dhe trajnimin e grupeve të punës. Grupi i punës në kryerjen e vlerësimit bazohet në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies⁶⁶⁰ përmes monitorimit të syllabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit⁶⁶¹, përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: vlerësimit të studentëve⁶⁶², vlerësimin e performancës⁶⁶³ vetvlerësimin⁶⁶⁴ dhe vlerësimin nga eprori i njësive bazë⁶⁶⁵.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të syllabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të syllabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me</p>

⁶⁵⁸ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶⁵⁹ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶⁶⁰ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

⁶⁶¹ Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.

⁶⁶² Evidenca 194. Student evaluation form.

⁶⁶³ Evidenca 198. INYT Performance report -Spring 2021.

⁶⁶⁴ Evidenca 196. Individual Performance Assessment form 2021.

⁶⁶⁵ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.



<p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>tituj⁶⁶⁶, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar⁶⁶⁷ konstatohet se ndër metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshihen vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë, provimeve, rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁶⁶⁶ Evidenca 71. UNYT Internship placement of internship students first cohort.

⁶⁶⁷ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.



Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përpiket të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm (njësia kryesore, bazë, stafi akademik etj) dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit (ASCAL, Urdhri i Psikologut, student dhe institucione bashkëpunuese për nevojat e praktikë dhe tregut te punës, grupe interesi). Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ sugjeron që institucioni duhet të garantojë dhe të shtoj bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e NJZHKC dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton së detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC. KSBC përmes aktiviteteve që ndërmer synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve, kordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni me anëtarë të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, njësia për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve dhe të studentëve sipas rastit në realizimin e detyrave të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë⁶⁶⁸ së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes</p>

⁶⁶⁸ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.




<p>bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmës akademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin. Gjithashtu edhe roli i studentëve në këtë proces ka qenë i dukshëm si përmes vlersimeve që japim çdo semester mbi cilësinë e programit por edhe duke qenë pjesë e grupit të punës në nivel njësie.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk duhet të përfshijë anëtarë që ushtrojnë detyra në pozicione drejtuese në institucion. Grupi i vlerësimit të brendshëm duhet të përfshijë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve të nivelit master në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë për i programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore” janë punonjës të UNYT. Në përbërjen e GVB janë vetëm anëtar të brendshëm të departamentit.</p> <p><i>Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon mund të ishte një mundësi e mirë për marrjen e opinioneve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi dhe do të siguronin pa anësinë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm⁶⁶⁹ të Cilësisë për programin e studimit janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente, por duhet të bëhen publike duke u hedhur në faqen e UNYT. Nuk kemi evidence lidhur me diskutimin e gjetjeve të raportit të brendshëm të vlerësimit të programit të studimit me studentët.</p> <p><i>Rekomandohet nga GVJ që në funksion të transparencës do të ishin të nevojshme nisja e një praktike lidhur me diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin transparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UNYT është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike për njësitë e saj por sugjerohet që kjo transparencë të ndiqet edhe për studentët dhe palë të treta të interesuar, duke u hedhur në faqen e UNYT. Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmanjien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë, nuk kemi evidence që na japin mundësi të gjykojmë mbi çënimin e lirisë për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>UNYT bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si RVB dhe gjatë vizitës në institucion, sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit përfshijën edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar⁶⁷⁰. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit</p>

⁶⁶⁹ Evidenca 183. UNYT Minutes of QAC Action plan.

⁶⁷⁰ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

	e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përsa i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësi bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë ⁶⁷¹ , krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësive, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vetë institucioni ⁶⁷² për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e UNYT dhe statuti, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB). Të gjitha këto struktura që monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre, i ndajnë me strukturat e tjera me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit ^{673, 674, 675, 676, 677} duke kordinuar punën midis tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁶⁷¹ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

⁶⁷² Ev 83. Plan i punës NJZHKC 2020-2021.

⁶⁷³ Evidenca 183. UNYT Minutes of QAC Action plan.

⁶⁷⁴ Evidenca 180. UNYT Quality Assurance Manual Eng.

⁶⁷⁵ Evidenca 41. UNYT Curricula Development policy and procedures Eng.

⁶⁷⁶ Evidence 192. UNYT Quality Assurance Report on Grading Fairness Form.

⁶⁷⁷ Evidenca 182. UNYT Action plan, senate decision, minutes of QAC

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/Arteve në “Psikologji” me profile në “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Abonimi në bibliotekat online dhe platformat elektronike në funksion të procesit të mësimdhënies;
3. Biblioteka fizike e pasur me tituj të rinj për fushën e psikologjisë, sipas kërkesës së njësishë bazë, cdo vit akademik;
4. Klima pozitive në komunikimin midis stafik akademik dhe studentëve të këtij programi studimi;
5. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik dhe studentët, përmes Erasmus +, ndihmuar edhe nga realizimi i programit të studimit në gjuhën angleze;
6. Veprimtaritë ekstrakurrikulare të realizuara nga institucioni ndihmojnë në avancimin në kërkimin shkencor për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi;
7. Prezenca e shërbimit “Turnitin” për monitorimin e pandershmërisë akademike dhe plagjiaturës;
8. Prezenca e këshilluesit akademik që ndjek studentin përgjatë gjithë rrugëtimit të tij formativ në semestrat akademik;

b. Pika të dobta:

1. Profilizimi në 3 drejtime të ndryshme të këtij programi studimi, vendos stafin në vështirësi lidhur me ndërthurjen e njohurive që mbulojnë të tre disiplinat njëherësh dhe dominimi i stafit në profilin klinik;
2. Emërtimi dhe organizimi i tipologjive të lëndëve mësimore të programit master shkencor me profile shumë të ndryshme nga njëri-tjetri, vështirë të ofrohet në një program të ciklit të dytë, në IAL-et në arenën ndërkombëtare, temat mësimore në disa lëndëve me nivel bazik njohurish, dhe njohuri që përsëriten në lëndë të tjera;
3. Mungesa e disa komponentëve mësimorë si orë në auditor/ punë e pavarur e studentit në kurrikulën e programit për lëndën e praktikës profesionale, temës së diplomës, dhe mungesa e emërtimit të lëndëve me zgjedhje që ofrohen sipas profileve përkatëse;

4. Mosrespektimi i detyrimit ligjor, lidhur me hartimin e syllabuseve nga anëtarë të stafit akademik që i përkasin kategorisë “Profesor”;
5. Marrëveshjet e nënshkruara nga UNYT në funksion të realizimit të praktikës profesionale, të pamjaftueshme dhe jo me impakt në cilësinë e programit të studimit;

Rekomandimet e paraqitura më poshtë nga grupi i vlerësimit të jashtëm mbështeten te pikat e forta dhe mundësitë e institucionit, për të ndërhyrë dhe përmirësuar pikat e dobëta dhe pengesat në drejtim të konsolidimit dhe zhvillimit në linjë me standartet europiane të programit të studimit “Master Shkencor” në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”;

Rekomandime

1. Institucioni të ndërmarrë hapa në drejtim të orientimit të stafit të angazhuar në mësimdhënie, që të implementojë syllabusin sipas profilit të tyre të kompetencës, pa synuar ndërthurje njohurish për profilet e tjera;
2. Përmirësimi i programit të studimit në emërtimin dhe tipologjinë e lëndëve mësimore për t’i përafuar me programe të ngjashme studimi të ciklit të dytë në nivel ndërkombëtar, duke u mbështetur në direktivat e APA dhe Europsy për përmirësimin e planit mësimorë me tipologji lëndësh sipas profilit të specializimit që masteri synon të zhvillojë;
3. Syllabuset e lëndëve ndërtohen duke synuar njohuri të thelluara sipas tipologjisë së lëndës dhe stafi sugjerohet të njihet paraprakisht me planin mësimorë të ciklit të parë të studimit me qëllim që të mos dubloj njohuri të mëparshme apo të lëndëve të tjera;
4. Njësia bazë të marrë masa për hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore, sipas secilit profil që është pjesë e ofertës formative;
5. Pasqyrimi në planin mësimorë të këtij programi studimi të komponentëve që lidhen me orët në auditor dhe të studimit individual për lëndën e praktikës profesionale, diplomës, dhe të emërtojë lëndët me zgjedhje që realizohen sipas secilit profil;
6. Syllavuset e lëndëve mësimore për secilin profil të hartohen nga titullarë që i përkasin kategorisë “Profesor” dhe me kualifikimin në linjë me profilin përkatës;
7. Institucioni të shoh mundësinë e rekrutimit të stafit akademik me tituj/grada dhe kualifikimin në linjë me 3 profilet e ofertës së tij formative;
8. Institucioni të angazhohet në nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën profesionale dhe të disponojë një kopjë të marrëveshjes zyrtare. Gjithashtu këto marrëveshje duhet të përfshijnë institucione në të cilat roli i psikologut klinik, shkollor dhe ligjor është i konsoliduar;

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science/Arts in "Psychology" with profiles "Clinical Psychology", "School Psychology" and "Legal Psychology"

a. Strengths and affirmations:

1. Good practices were undertaken by the institution in terms of the involvement of academic staff and students in national and international projects;
2. Subscription to online libraries and electronic platforms in the function of the teaching process;
3. Physical library rich with new titles for the field of psychology, according to the request of the basic unit, every academic year;
4. Positive climate in communication between academic staff and students of this study program;
5. Promotion of exchanges in higher education for academic staff and students, through Erasmus +, also helped by the realization of the study program in English;
6. The extracurricular activities carried out by the institution help to advance scientific research for the academic staff and students of this study program;
7. The presence of the "Turnitin" service for monitoring academic dishonesty and plagiarism.
8. The presence of the academic advisor who follows the student throughout his educational journey in the academic semesters;

b. Weaknesses:

1. Profiling in 3 different directions of this study program puts the staff in difficulties regarding the combination of knowledge that covers the three disciplines at once and the dominance of the staff in the clinical profile;
2. The naming and organization of the typologies of the teaching subjects of the scientific master program with very different profiles from each other, difficult to offer in a second cycle program, in the HEIs in the international arena, the teaching topics in some subjects with the level knowledge base, and knowledge that is repeated in other subjects;
3. Lack of some teaching components such as hours in the auditorium/independent work of the student in the curriculum of the program for the subject of professional practice, the subject of the diploma, and the lack of designation of optional subjects that are offered according to the respective profiles;
4. Failure to comply with the legal obligation, related to the drafting of syllabuses by members of the academic staff who belong to the "Professor" category;



5. Agreements signed by UNYT in the function of the realization of the professional practice, are insufficient and without impact on the quality of the study program;

The recommendations presented below by the external evaluation group rely on the strengths and opportunities of the institution, to intervene and improve the weak points and obstacles in the direction of consolidation and development in line with the European standards of the "Master of Science" study program in "Psychology" with "Clinical Psychology", "School Psychology" and "Legal Psychology" profiles.

Recommendation

1. The institution should take steps in the direction of the orientation of the staff engaged in teaching, to implement the syllabus according to their competence profile, without aiming to combine knowledge for other profiles;
2. Improving the study program in the naming and typology of teaching subjects to align them with similar study programs of the second cycle at the international level, relying on the directives of APA and Europsy for the improvement of the teaching plan with the typology of subjects according to specialization profile that the master aims to develop;
3. Course syllabi are built aiming for in-depth knowledge according to the typology of the subject and the staff is suggested to familiarize themselves with the curriculum of the first study cycle in order not to duplicate previous knowledge or other subjects;
4. The basic unit should take measures to design the syllabuses of the teaching subjects, according to each profile that is part of the training offer;
5. The reflection in the curriculum of this study program of the components related to the hours in the auditorium and individual study for the subject of professional practice, diploma, and to name the optional subjects that are realized according to each profile;
6. The syllabi of the teaching subjects for each profile should be drawn up by holders belonging to the "Professor" category and with the qualification in line with the relevant profile;
7. The institution sees the possibility of recruiting academic staff with titles/ranks and qualifications in line with the 3 profiles of its training offer;
8. The institution should engage in signing cooperation agreements for professional practice and have a copy of the official agreement. Also, these agreements should include institutions in which the role of the clinical, school and legal psychologist is consolidated;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	